# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7566 E enjte 21 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







Intervista e Ditës

Nga GERALD TATZGERN

## Emigrantët në Shqipëri? Austria po ju ndihmon



Mediet e huaja e sidomos ato gjermane po i mëshojnë mun-dësisë së ngritjes së qendrave të refugjatëve në Shqipëri e vende të tjera të Ballka-nit. Në një ...

Vijon në faqen 2

Dje në "Deutsche Welle"

Nga BERND RIEGERT

## Harta politike e ndryshuar e Europës



Në Bruksel, Zyra belge për Azilin në Stacionin Verior të trenit është vetëm pak kilometra larg për-faqësisë kryesore të BE. Herë pas here atje sheh ...

Vijon në faqen 21

ZBARDHET DRAFTI I VENDIMIT TE BRUKSELIT: DIALOG QEVERI-OPOZITE

# BE: HAPEN NEGOCIATAT ME SHQIPERINE, POR S'KA DATE

Këshilli Europian, rezolutë me nota pozitive: Vetingu të japë rezultate të prekshme. Meta takon homologun në Hungari: Të arrihet konsensus në BE



*(Në foto)* Selia e Bashkimit Europian

Në faqen 3



Kreu i Hipotekës: Japim 400 dëshmi në muaj

## Ndërtimet pa leje, zbardhet udhëzimi si merret tapia, ndryshon procedura

Tarifa 5 mijë lekë për regjistrimin e shtëpisë së legalizuar, ju ku e paguani

ORNELA MANJANI

Hipoteka e Tiranës ka katërfishuar numrin e certifikatave të pronësisë për objektet e legalizuara. Lajmin e ka bërë të ditur kryeregjistruesi Vla-drin Pjetri, gjatë takimit të zhvilluar në Kamëz, në kua-dër të turit ...

Në faqen 8

"KAMPI I BE"

## Sherr për refugjatët, opozita: S'do flitet më shqip. PS: Mos përhapni panik

Në faqen 4

AKUZA

## PD: 4 deputetët e Ramës që përfituan 78 milionë euro nga tenderat publikë

Në faqen 7

RREFIMI NE GJYQ

## Vrau burrin në Pazar, nëna e dy fëmijëve: Me rrihte dhe më kërcënonte

Në faqen 10

FLET MJEKU

## Ylli Merja: Çajrat bimorë që qetësojnë lëkurën, ja si të kuroni djegiet

Në faqen 20

ZGJIDHJET KORREKTE



## Matura Shtetërore, përgjigjet e sakta të provimeve me zgjedhje

Në faqet 13-16

Durrës/ Bashkëshortët e plagosur, rëndë në spital. Nusja në polici: Faji i vjehrrës

# "Çmendet" i riu, masakron prindërit me thikë

*Arrestohet 25-vjeçari, goditi 6 herë nënën në bark dhe babain në fyt*

Nga KLODIANA HAXHIAJ

DURRËS - Krimi në familje trondit Durrësin. Një 25-vjeçar me origjinë nga Dibra ka masakruar me thikë prindërit e tij të mo-shuar. Bëhet fjalë për 75-vjeçarin Destan Neziri dhe 64-vjeçaren Hasije Neziri, të cilët kanë



përfunduar në gjendje të rëndë në spitalin e qytet-it bregdetar. Mësohet se bashkëshortët Neziri kanë marrë plagë të shumta dhe ndodhen në reanimacion nën kujdesin e kujdesin e mjekëve. Vetëm një orë më pas, autori i ...

Në faqen 11

# KAMPET E REFUGJATEVE

## REAGIMET

Drejtor i Zyrës Kundër Trafikimit në Austri: Do çojmë personel në kufirin greko-shqiptar

# Tatzgern për Shqipërinë: Nëse ngrihen qendra për azil, duhet forcuar policia

## "Ka grupe trafikantësh me 20-60 kriminelë"

*Mediet e huaja e sido mos ato gjermane po i mëshojnë mundësisë së ngritjes së qendrave të refugjatëve në Shqipëri e vende të tjera të Ballkanit. Në një intervistë për "Deutche Welle"-n, Gerald Tatzgern, drejtor i Zyrës Kundër Trafikimit të Njerëzve në Zyrën Federale të Kriminalistikës në Austri deklaroi dje se Vjena do ta mbështesë konkretisht Shqipërinë. Tatzgern pohon se një numër i madh njerëzish po marrin rrugën drejt Austrisë e Gjermanisë. Bëhet fjalë për 50-60 mijë persona, ndërsa mbi 17 mijë vetë të tjerë që ndodhen në ishujt grekë kanë për pak kohë të drejtën të lëvizin të lirë në të gjithë Greqinë.*

**Vala e refugjatëve drejt Europës nuk ka të ndalur. Së fundmi, ju e keni cilësuar gjendjen si "shumë të rrezikshme". Çfarë e bën atë kaq të rrezikshme?**

Gjendja është gjithmonë e rrezikshme, kur ne dallojmë se si grupimet e ndryshme të trafikantëve i kushtohen gjithnjë e më shumë trafikimit, sepse shumë njerëz nga këto rajone marrin rrugën në drejtim të Austrisë dhe Gjermanisë. Në bëjmë fjalë këtu për një masë prej 50.000-60.000 persona, më shumë se 17.000 vetë të tjerë që ndodhen në ishujt grekë, marrin për pak kohë të drejtën të lëvizin të lirë në të gjithë Greqinë.

**Austria duket se e ka një plan, mediat flasin shumë për kampet e refugjatëve që do të ngrihen në Shqipëri. Asnjëra palë nuk i ka hedhur poshtë këto plane, sa konkret është ky plan?**

Ne jemi të gatshëm që jashtë Bashkimit Europian të ngremë qendra të tilla të Bashkimit Europian, ku të verifikohet, nëse ekziston apo jo një e drejtë për të vazhduar udhëtimin drejt Europës. Pra, ne duam të dërgojmë sinjalin e qartë se nuk duam t'ua lëmë trafikantëve në dorë se kush ia del të hyjë në Europë dhe kush jo.

**Shqipëria përmendet si një nga këto vende. A mundet ky vend ta përballojë një barrë të tillë?**

Nuk mund t'i përgjigjem kësaj nga këndvështrimi i policisë dhe kriminalistikës, sepse ky është proces politik. Por mund të them nga këndvështrimi i policisë, se nëse do të ngrihen këto qendra, pavarësisht se ku, atëherë ne duhet t'i mbështesim shumë policitë e këtyre vendeve, me qëllim që të mos hapen fusha të reja kriminaliteti, ku vajzat e gratë të shfrytëzohen apo ku trafikantët të zbulojnë fusha të reja veprimi.

**A ka plane për këtë?**

Ne kemi aktualisht një plan që nga sektori ynë të dërgohen nëpunës (Zyra Federale e Austrisë për Kriminalistikën shën. red.) në Shqipëri. Ne do të zhvillojmë aksione të përbashkëta në kufirin greko-shqiptar, do të shohim për mundësitë e mbështetjes me asistencë teknike, këtë do ta komunikojmë më tej në Bashkimin Europian që kolegët tanë të policisë në Ballkan t'i forcojmë si duhet. Mbështetja jonë do të jetë edhe me personel.

**Nëse ngrihen qendra të tilla a nuk përbën kjo rrezik edhe për sigurinë e këtyre vendeve, BE ka një problem më pak, këto vende një problem më shumë?**

E kemi parë disa herë se në mesin e emigrantëve gjenden edhe simpatizantë të ISIS-it. Ne punojmë me të gjitha autoritetet në Ballkan në mënyrë që të pengojmë që të krijohet një problem i tillë sigurie në të gjithë rajonin. Aktualisht mund të llogarisim se luftëtarë të caktuar kërkojnë të zbarkojnë këtu dhe përdorin për këtë trafikantët për t'i çuar në vende të tjera. Por për momentin nuk ka të dhëna se ndonjë shtet i caktuar në Ballkan po rrezikohet.

**Nëse qendrat e refugjatëve zhvendosen në Shqipëri apo Ballkan, a nuk do të krijojë kjo hapësira të reja për grupet e trafikimit? Si e shihni gjendjen aktualisht në Ballkan?**

E vështirë të japësh një përgjigje, sepse kur shumë njerëz i kushtohen kësaj pune, trafikimit, atëherë krijohen grupime gjithnjë e më të vogla. Pra nuk është se kemi një "kapo" që e ka në dorë të gjithë trafikimin në Ballkan. Por megjithatë, kemi të dhëna se në disa vende, Serbi, Maqedoni dhe Shqipëri ka njerëz aktivë që kanë rol drejtues në këto grupe trafikimi. Ka grupe trafikantësh me 20 vetë, por edhe deri në 60 kriminelë.

**Grupime që janë aktivë dhe që mund të forcohen në Shqipëri, nëse vijnë qendrat e reja...**

Nuk e besoj, sepse gjithçka do të ishte e kufizuar në një vend. Kemi pasur një përvojë në Austri, ku në qendrën më të madhe të azilit në Austri zhvilluam masivisht hetime dhe arritëm që të identifikonim shumë trafikantë dhe t'i arrestonim.



Gerald Tatzgern, drejtor i Zyrës Kundër Trafikimit të Njerëzve në Zyrën Federale të Kriminalistikës në Austri



Komisioni Europian gjatë një prej sesioneve të tij

### GREQIA

Partia më e madhe opozitare në Greqi, Demokracia e Re, kërkon që teksti i marrëveshjes së pritshme midis Athinës dhe Tiranës t'i jepet parlamentit para se të nënshkruhet. Shefi i Departamentit të Jashtëm të kësaj partie, Jorgos Koumoutsakos, ka kërkuar interpelancë me ministrin e Jashtëm, Nikos Kotzias. Koumoutskos komenton se nga pala shqiptare nuk përjashtohet që negociatat të finalizohen deri në samitin e radhës të BE-së, më 28-29 qershor.

## Ruçi në Asamblenë e PABSEC: Asnjë vend i rajonit s'mund të ecë përpara i veçuar

Kryetari i parlamentit shqiptar, Gramoz Ruçi bëri thirrje dje për bashkëpunim të vendeve të rajonit për zhvillim të përbashkët. Në cilësinë e presidentit të Asamblesë së Përgjithshme të Bashkëpunimit Ekonomik të vendeve të Detit të Zi, Ruçi tha dje në Tiranë se asnjë vend i vetëm nuk mund të ecë përpara i veçuar nga të tjerët. "Bashkëpunimi ynë na ka bërë të vetëdijshëm se nuk mund të ketë zhvillim dhe mirëqenie të popullit, të cilit ne i përkasim, veçmas mirëqenies së popujve të tjerë të rajonit tonë. Ekonomi të fortë, zhvillim të qëndrueshëm, sisteme solidare janë shtyllat ku mbështet mozaiku i kulturave dhe vlerave që sjellin në këtë organizatë", u shpreh kreu i Kuvendit. Zëvendësministri i Jashtëm, Etjen Xhafaj tha se Shqipëria pret një vendim pozitiv për hapjen e negociatave, në mënyrë që të ecet përpara.

### Ministrja e Mbrojtjes pritet nga zyrtarët e lartë britanikë

## Olta Xhaçka: Çelja e negociatave rrit përgjegjësinë e institucioneve në Shqipëri



Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka deklaroi dje në Londër gjatë takimeve me zyrtarë të lartë britanikë se Shqipëria meriton hapjen e negociatave. Gjatë qëndrimit dyditor atje, Xhaçka u prit nga homologu i saj britanik Gavin Williamson si dhe nga ministri për Evropën dhe Amerikën, sir Alan Duncan; drejtori i Përgjithshëm të Politikës së Jashtme, Richard Moore; ministri i Shtetit për Mbroj-tjen, lordi Frederick Curzon, i cili është njëherësh zëvendësekryetar i Dhomës së Lordëve. Në takimet me zyrtarët britanikë, ministrja Xhaçka vlerësoi kontributin dhe mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar për reformat kyçe në Shqipëri për forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor, të cilat ajo i konsideroi si vendimtare në rrugën drejt procesit të integrimit euroatlantik. Xhaçka konsideroi se hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian rrit përgjegjësinë e institucioneve tona për transformimin e mëtejshëm të vendit. Ajo u shpreh se Shqipëria e meriton hapjen e negociatave për anëtarësimin, çka sipas saj do të ishte një hap pozitiv dhe stabilizues për politikën e brendshme, atë rajonale si dhe perspektivën e sigurisë. Nga ana e tij, sekretari për Mbrojtjen i Mbretërisë së Bashkuar, Gavin Williamson u shpreh se Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në forcimin e institucioneve demokratike dhe e konsideroi vendin tonë si një faktor shumë të rëndësishëm në Ballkan.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



"Vetingu të japë rezultate të prekshme para konferencës ndërqeveritare"

# Zbardhet draftrekomandimi i Këshillit të BE: Hapim negociatat me Shqipërinë

## "Dialog konstruktiv qeveri-opozitë për integrimin"

Bashkimi Europian pritet të hapë negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, por pa një datë. Në draftrekomandimin e Këshillit të BE-së, publikuar nga Vizion Plus, thuhet se ka nevojë kritike që Shqipëria të vijojë progresin në reformën në drejtësi. Ky draft tashmë është duke u shqyrtuar nga të gjithë vendet anëtare, përpara takimit të 28-29 qershorit. Në këtë dokument, propozohet nisja e bisedimeve, ndërsa nuk jepet koha për uljen në tryezë. "Këshilli vendos për të hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë. Me qëllim mbajtjen e Konferencës së parë Ndërqeveritare, Këshilli nënvizon nevojën kritike që Shqipëria të konsolidojë më tej progresin e bërë në reformën gjyqësore në veçanti përmes vetingut dhe të japë rezultate të tjera të prekshme në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet dhe në luftën kundër krimit të organizuar, në veçanti për kultivimin dhe trafikimin e drogës. Këshilli i bën thirrje Komisionit që të vëzhgojë nga afër përpjekjet e reformave së lartpërmendur nga Shqipëria dhe do të vlerësojë progresin në bazë të një raporti të Komisionit përpara Konferencës së parë Ndërqeveritare",-thuhet në draft rekomandimin e Këshillit të Bashkimit Evropian. Ndërkaq vlerësohen arritjet e Shqipërisë, veçanërisht në 5 prioritetet e vendosura më parë nga Komisioni. "Këshilli përshëndet progresin e qëndrueshëm të Shqipërisë në ndjekjen e reformave që lidhen me pesë prioritetet kyçe. Ristrukturimi institucional i gjyqësorit është në vazhdim, si një gur themeli i një reforme gjithëpërfshirëse të drejtësisë. Procesi i rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët ka filluar të japë rezultatet e para të prekshme, duke përfshirë edhe anëtarët e lartë të gjyqësorit, nën mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Këshilli inkurajon Shqipërinë që të vazhdojë bashkëpunimin e saj të mirë me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit. Këshilli inkurajon Shqipërinë që të zhvillojë progresin e konsiderueshëm deri tani dhe të ndjekë intensivisht reformën e drejtësisë, që synon rritjen e pavarësisë, llogaridhënies, profesionalizmit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor, sidomos nëpërmjet avancimit të mëtejshëm të procesit të verifikimit, i cili është vendimtar",-vijon më tej, rekomandimi. Po kështu Këshilli thekson se dialogu i qëndrueshëm dhe konstruktiv mes qeverisë dhe opozitës për reformat e kërkuara nga BE mbetet kyç për të avancuar me axhendën e reformave në përfitim të qytetarëve dhe afrimit të vendit drejt Bashkimit Evropian. Në një nga pikat e tij ky rekomandim përmban sugjerimin se Këshilli mirëpret rolin konstruktiv të Shqipërisë në bashkëpunimin rajonal. Këshilli mirëpret intensifikimin e dialogut me vendet fqinje për të adresuar çështjet e rëndësishme dypalëshe si dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mire, të cilat mbeten esenciale. Por dokumenti mbetet ende në diskutim nga të gjithë vendet dhe duket se oponenca më e fortë po bëhet nga Franca dhe Presidenti Macron, i cili ende vijon të jetë skeptik për pranimin e vendeve të reja në Bashkimin Europian. Gjithsesi, pritet që më datë 26 drafti të diskutohet mes ministrave të Jashtëm, të cilët më pas do t'ia adresojnë atë krerëve të shteteve të Unionit.



**AZILKËRKUESIT**

Në draft propozimin e formuluar para pak ditësh thuhet se Këshilli i kushton një rëndësi të veçantë çështjes së azilkërkuesve ku i kërkon Komisionit Europian të sigurohet që Shqipëria të vazhdojë angazhimin në uljen e numri të kërkesave për azil. Kërkohet zgjidhja e mosmarrëveshjeve dypalëshe dhe shmangia e deklaratave që ndikojnë negativisht në marrëdhëniet fqinjësore.

Çelja e negociatave për Shqipërinë, presidenti takon homologun hungarez

## Meta i kërkon Hungarisë të ndikojë në arritjen e konsensusit brenda BE




Presidenti i Republikës, Ilir Meta u prit dje, në Hungari nga Presidenti i Republikës së Hungarisë, János Áder, në Sheshin Szent György. Pas ceremonisë së lartë zyrtare, Meta diskutoi me homologun e tij. Presidenti Meta shprehu, gjithashtu, mirënjohjen për mbështetjen e qartë dhe konsistente të Hungarisë për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Presidenti kërkoi mbështetjen e Hungarisë për arritjen e konsensusit brenda Këshillit të BE-së dhe mbështetjen e rekomandimit të Komisionit për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Duke u ndalur në bashkëpunimin dypalësh, Presidenti Meta nënvizoi faktin se bashkëpunimi ekonomik e tregtar duhet t'i përgjigjet marrëdhënieve të shkëlqyera politike dhe potencialeve që dy vendet kanë, si në pasuri natyrore ashtu dhe në ato njerëzore. Rivendosja e linjës direkte ajrore midis kryeqyteteve të të dy vendeve dhe hapja e Dhomës së Tregtisë së Hungarisë në Tiranë do të bëjnë që ky bashkëpunim të rritet ndjeshëm dhe që pas katër viteve ta festojmë 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me rezultate shumë pozitive edhe në këtë drejtim, - nënvizoi Presidenti Meta. Më tej ata u ndalën edhe në zhvillimet më të fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si dhe sfidat e kërcënimet me të cilat vendet e këtij rajoni po përballen. Presidenti hungarez Áder e siguroi Presidentin Meta për mbështetjen e Hungarisë, si në drejtim të integrimit europian, ashtu edhe për nxiten e mëtejshme të bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve. Gjatë kësaj vizite zyrtare Meta pati takime edhe me kryeministrin dhe kryetarin e parlamentit hungarez.

## Merkel i dërgon letër Bundestagut: Negociata me kusht për Shqipërinë

Qeveria gjermane i ka dërguar paraditen e të mërkurës një letër Bunbdestagut për të marrë mendimin për votën gjermane në Këshillin e BE që mblidhet me 28 dhe 29 qershor. "Qeveria gjermane në këtë letër është pro çeljes së negociatave me Shqipërinë, por ka vendosur disa kushte" deklaroi burimi diplomatik, për Report Tv. Në Bundestagun gjerman ekziston një rrymë e fortë deputetësh që nuk e duan zgjerimin e BE dhe në tilla kushte pritshmëritë e rekomandimit janë negative. Kjo do të thotë një jo çeljes negociatash me kusht për Shqipërinë madje duke mos e caktuar një datë deri në përfundimin e kushteve. Ndërkohë edhe qeveria holandeze ka kërkuar mendimin e parlamentit. Paraditen e të enjtes 21 qershor, komisioni parlamentar holandez që merret me çështjet e zgjerimit të BE do të japë rekomandimin se cila duhet të jetë vota holandeze. Mësohet se të martën janë takuar presidenti Francez Macron me Kancelaren Mercel ku në fokus të bisedës ka qenë edhe vota e Këshillit Europian për çeljen e negociatave për anëtarësim. Edhe në rast se Gjermania dhe Holanda mund ta zbusin qëndrimin e tyre ndaj Shqipërisë, vendimi i Francës deri këto momente mbetet stoik. Presidenti Macron disa herë javët e fundit ka bërë deklarata kundra zgjerimit të BE duke paralajmëruar në një farë mënyrë votën franceze në Këshillin Europian. Gjithsesi njohës të çështjeve të integrimit pohojnë se jemi përpara një situate kur këtë vendim të rëndësishëm Këshillin Europian do ta marrë minutën e fundit.

## Senatorët italianë letër Contes: Votoni 'pro' Shqipërisë në BE

Senatori italian i Partisë Demokratike Gianni Pittella i ka dërguar një letër kryeministrit të Italisë Giuseppe Conte që të konfirmojë qëndrimin pozitiv të Italisë në favor të përshpejtimit të hapjes së negociatave për anëtarësim në BE të Shqipërisë dhe Maqedonisë. "I nderuar President, në Këshillin Europian të radhës të 28-29 qershorit ne ju kërkojmë për të konfirmuar pozicionin e Italisë në favor të përshpejtimit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë", nis letrën Gianni Pittella. "Në dritën e miqësisë midis popujve italiane, shqiptare dhe maqedonase, marrëdhëniet tregtare midis vendeve tona, si dhe përpjekjet që qeveritë maqedonase dhe shqiptare kanë bërë për të forcuar demokracinë dhe shtetin e së drejtës, ne besojmë se një pozicion i favorshme për përshpejtimin e negociatave korrespondon me interesat italiane, maqedonase, shqiptare, dhe të gjithë Evropës",-përfundon letra. Po ashtu letra është nënshkruar edhe nga senatorët Joseph Cucca, Laura Garavini, Francis Jakobit, Nadia Ginetti, Salvatore Margiotta, Antonio Misiana, Thomas Nannicini, Edoardo Patriarca, Roberto Rampi, Tatjana Rojc, Valeria Valente dhe Luigi Zanda.

# REFUGJATET
## DEBATET

Opozita: Populli i Skënderbeut po zëvendësohet me popullin e Sulltan Mehmetit

# Debat për refugjatët, PD: Nuk do të flitet më shqip

## PS, Gjebrea: Opozita mos të përhapë panik



Gjatë një seance parlamentare

Valentina Madani

Çështja e ngritjes apo jo të një kampi refugjatësh në Shqipëri u debatua dje në Komisionin e Sigurisë ku opozita pretendon se ky ka qenë kushti i BE-së për hapjen e negociatave. Një deklaratë e zv/ministrit të Brendshëm, Julian Hodaj, për televizionin gjerman ZDF, në lidhje me kapacitetet e Shqipërisë për të pritur emigrantët, u kthye në temë debati në Komisionin parlamentar të Sigurisë Kombëtare, ku opozita akuzoi qeverinë se do të sjellë në Shqipëri 600 mijë refugjatë sirianë. Demokrati Flamur Noka foli për një skenar që sipas tij synon ta kthejë Shqipërinë në strehën e mafias për trafikun e qenieve njerëzore. Noka bëri të qartë se Europa do të japë një përgjigje negative në 28 qershor, duke akuzuar për këtë kryeministrin Rama. Ai u shpreh se pas kësaj date, marrëdhënia e opozitës me qeverinë do të ndryshojë dhe ata nuk do lejojnë që Rama të mbajë peng të ardhmen e vendit. "Shqipëria do të kthehet në një vend ku do të mblidhen terroristë pikë së pari. Është trafik qeniesh njerëzore që po përgatit Edi Rama. Do të kesh mall që të shohësh shumicë shqiptare. Shumica do të jenë pakistaneze, irakianë, iranianë dhe sirianë. Shqiptarët do të kthehen në pakicë. Nuk do të ketë vend më për shqiptarët. Po të vijnë 600 mijë refugjatë këtu s'do flitet më shqip", tha deputeti i PD-së. Ndërsa socialistja Elona Gjebrea deklaroi: "Në mënyrë absolute nuk duhet të krijojmë panik për situata që nuk ekzistojnë dhe për situata për të cilat Këshilli i Ministrave është shprehur qartë. Bëhet fjalë që të përgatitemi për kapacitetet që kemi. Nuk do të presim 600 mijë". Mohimi i deputetëve të mazhorancës nuk ndali akuzat e demokratëve. Klevis Balliu tha: "Po largohen 500 mijë shqiptarë dhe po vijnë 600 mijë sirianë. Po zëvendësohet populli i Skënderbeut me popullin e Sulltan Mehmetit". Vullnet Sinaj u përgjigj: "Sa shpejt e harruam Shqipërinë pas viteve '90, kampet që na hapi Italia". Pas debateve mes mazhorancës dhe opozitës, kjo e fundit braktisi mbledhjen në Komisionin e Sigurisë. Mazhoranca vijoi e vetme mbledhjen, duke diskutuar për rendin e ditës që lidhet me disa ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Pas këtij debati reagoi Ministria e Brendshme, e cila sqaroi se ndërtimi i kampeve për emigrantë nuk është çështje në shqyrtim apo diskutim, pasi askush nuk e ka kërkuar apo ofruar një gjë të tillë. Sipas Ministrisë së Brendshme, zv/ministri Hodaj i është përgjigjur pyetjes së ZDF-së mbi një situatë hipotetike se çfarë mund të bënte Shqipëria në kushtet e një emergjence emigrantësh? Përgjigjja e zv/ministrit Hodaj, thekson sqarimi, ka qenë se "Shqipëria e ka treguar gjatë luftës së Kosovës se është në gjendje të përballojë këto emergjenca".



Mbledhja e djeshme e Komisionit Parlamentar të Sigurisë

**AKUZA**

Opozita akuzoi qeverinë se ka pranuar të presë 600 mijë refugjatë sirianë me kusht hapjen e negociatave. Por këto akuza janë kundërshtuar nga socialistët, të cilët theksuan se zv/ministri i Brendshëm ka folur për kapacitetet që ka vendi ynë dhe jo për ardhjen e refugjatëve.

### Ish-kryeministri: O sot, o kurrë të përmbysim Ramën

## Berisha: Antishqiptari gati të pranojë ish- terroristët e ISIS

Kryeministri Edi Rama ka mohuar lajmet dhe zërat se në Shqipëri do të ngrihet një kamp që do të presë qindra mijëra refugjatë, ndërkohë që Presidenti i Këshillit Europian Donald Tusk, ka propozuar që krerët e BE-së të krijojnë "platforma rajonale të zbarkimit" jashtë Bashkimit Evropian. Mes vendeve të mundshme partnere janë Tunizia dhe Shqipëria, por zyrtarët thonë se është shumë shpejt që të spekulohet për këtë"- thuhet në artikullin e Politico.eu. Pas kësaj reaguar dje ish- kryeministri Sali Berisha, i cili në një postim në rrjetet sociale, bën thirrje për të rrëzuar kryeministrin Rama dhe qeverinë e tij. Berisha akuzon pasardhësin e tij si antishqiptar, kriminel pa atdhe për karrigen e tij është gati të bëjë gjithçka kundër vendit të tij. "O sot o kurrë duhet të përmbysim Edvin Kristaq Ramën, Jorgo Zografin e dytë! Ky antishqiptar, kriminel pa atdhe për karrigen e tij është gati të bëjë gjithçka: Të shesë detin! Të shesë tokën! Të pranojë qindra mijëra ish-terroristë të ISIS në Shqipëri! Të përzë nga Shqipëria rininë, të ardhmen e saj! O sot o kurrë duhet të ngrihemi dhe të shporrim këtë kalbësirë, Jorgo Zograf të dytë nga sundimi shitja e Shqipërisë, interesave jetike, vetjake dhe kombëtare të shqiptarëve!",-shkruan ish-kryeministri Sali Berisha.



**THIRRJA**

"O sot o kurrë duhet të përmbysim Edvin Kristaq Ramën, Jorgo Zografin e dytë! Ky antishqiptar, kriminel pa atdhe për karrigen e tij është gati të bëjë gjithçka: Të shesë detin! Të shesë tokën! Të pranojë qindra mijëra ish-terroristë të ISIS në Shqipëri!",-tha z.Berisha.

### SHKURTE

## "Kampi", Mediu: Çmenduri, do rrezikohemi nga terrorizmi

Kreu i PR-së, Fatmir Mediu iu është bashkuar reagimeve pas deklaratës së zv.ministrit të Brendshëm Julian Hodaj, se Shqipëria mund të pranonte një kapacitet prej 600 mijë refugjatësh sirianë. Mediu e cilësoi këtë lajm të dhënë për median gjermane ZDF, një çmenduri të madhe. Sipas kreut të PR-së Shqipëria nuk ka mundësi që të riatdhesojë dhe riintegrojë shqiptarët e kthyer nga Siria, ndërsa shtoi se ndërtimi i këtij kampi është kërcënim serioz për sigurinë e vendit. "Deklarimi i zv/ministrit të Brendshëm dhe njoftimet e medias ndërkombëtare nxjerrin zbuluar Ramën si gënjeshtar. Nuk ka çmenduri me të madhe sesa të deklarosh se mund të pranojmë një numër të madh refugjatësh nga Siria. Së pari, ne nuk kemi mundësi të riatdhesojmë dhe riintegrojmë shqiptarët që shkuan në Siri dhe familjet e tyre. Së dyti, ky është kërcënim serioz afatgjatë për sigurinë e vendit tonë Së treti, do të thotë prezencë aktive e terrorizmit në Shqipëri Së katërti, fuqizim i krimit të organizuar trafikut të qenieve njerëzore njësoj si trafiku i kanabisit dhe kokainës me mbështetje politike dhe qeveritare", shkruan Mediu në 'Facebook'. Sipas tij "Kjo është çmenduri dhe maskarallëk".

## "Refugjatët", Mustafaj: E rëndë nëse bëhen negociata të fshehta

Në një kohë kur e gjithë vëmendja është përqendruar tek lajmet e mediave gjermane, që flasin për faktin se Shqipëria ka kapacitet për të pranuar 600 mijë refugjatë sirianë, duke iu referuar edhe deklaratës së zv.ministrit të Brendshëm Julian Hodaj, vjen edhe reagimi nga ish-ministri Besnik Mustafaj. I ftuar në 'Neës24' publicisti Mustafaj parashtroi dy teza; ose Europa po vendos pa pyetur Shqipërinë, ose po mbahen negociata të fshehta me qeverinë. "Ose Europa po e merr përsipër këtë projekt pa pyetur qeverinë shqiptare, dhe kjo është e rëndë. Ose po bëhen negociata të fshehta, dhe kjo është shumë e rëndë. Pashë një deklaratë të zv.ministrit të Brendshëm se kemi kapacitet për të marrë 600 mijë refugjatë. Kjo është e papranueshme. Shqipëria nuk ka kapacitete logjistike për këtë gjë. Unë besoj se është e palejueshme që të pranohet një gjë e tillë. Kjo tregon se Europa është më e dobët se kurrë",-tha Mustafaj.

**SHPALLJE ANKANDI**
**Datë 28.06.2018, Ora 16:00**

Shoqëria Përmbarimore **"Besnik Bajraktari" sh.p.k** me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Muharrem Hysen Greca:
-Banesë dykatëshe, me sipërfaqe totale 333.16 m2, e ndodhur në zonën kadastrale 8190, Vetëdeklaruar pranë ALUIZNI-t Tirana Jug me nr. 428 datë 28.08.2006, adresa: Rr. "3 Vëllezërit Kondi", Tiranë.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 4 790 083 (katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë.
**Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.**



Ministri i Shtetit: Shqiptarët nuk janë naivë, vihet në diskutim siguria

# Kamp për refugjatët për negociatat me BE? Majko: Më mirë të mos ketë ftesë

## "Do të krijojë situatë shpërthyese, duhen bërë mirë llogaritë"

Darina Tanushi

Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko deklaroi dje, se duhen bërë mirë llogaritë nëse Shqipëria pret 600 mijë refugjatë. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ai u shpreh se nëse vendet e BE-së nuk e bëjnë një gjë të tillë, pse duhet t'i kërkohet Shqipërisë të presë refugjatë. Sipas ministrit kjo vë në diskutim sigurinë e vendit. "Lajmet se në Shqipëri do të hapen kampe për 600 mijë refugjatë sirianë janë përtej çdo gatishmërie e imagjinate për një prej kombeve më të vjetër të Europës, siç janë shqiptarët" e nis komentin e tij, ministri Majko. "Shtëpia e shqiptarit është e zotit dhe e mikut. Kështu shkruhet në rregullat e lashta të trajtimit të të huajve që trokasin në derën e shtëpisë së shqiptarit. Shqiptarët janë populli më miqësor me të huajt dhe që i mbron ata me vullnet e pa kërkesë nga të tjerët. Askush, dhe për asnjë arsye nuk mund të fyejë kombin shqiptar duke luajtur me këtë ndjenjë kaq pozitive karshi të huajve. Shqipëria është një rast i rrallë në një botë refuzuese për të huajt. Çdo familje shqiptare ka migrantë jashtë vendit, në Perëndim, dhe kjo është një arsye më shumë për të qenë dashamirës me ata që janë larguar nga vendi i tyre për arsye të mbijetesës",-thuhet në komentin e ministrit Majko. "Si njohës modest i krizave të tilla humanitare e vlerësoj të pavend përhapjen e lajmeve të tilla të cilat mund të shkaktojnë panik në vendin më miqësor me të huajt siç është Shqipëria. Ajo nuk është një "epruvetë" ku interesat politike dhe paaftësitë menaxhuese të të tjerëve të gjejnë justifikim me "eksperimente" të tilla",-u shpreh Majko më tej. Sipas tij, "grumbullimet e refugjatëve në sasi sfiduese për vendasit do të krijojë situatë shpërthyese për të cilën duhet të bëhen mirë llogaritë". "Shqipëria ka gatishmëri për të huajt, por askush nuk mund të bëjë "humor" nisur nga nevojat e saj. Në se ka ndonjë politikan europian, i cili diskuton "ftesën" për të hapur negociatat e integrimit europian për Shqipërinë me pranimin e ndërtimit të kampeve të refugjatëve atëherë kjo "ftesë" më mirë të mos vijë... Pasi ajo nuk do të ishte ftesë, e aq më pak ftesë europiane. Jam i bindur, që Brukseli nuk mund t'i kërkojë një vendi dhe populli, ndryshimin e strukturës së vet sociale duke vënë në diskutim sigurinë e tij kombëtare dhe më gjerë",-thekosoi Majko. "Të huajt që të vinë në derën e shtëpisë për ndihmë, janë miq! Ata që t'i sjellin... janë miq të refuzuar të dikujt tjetër. Ky është përkthimi që shqiptarët do t'i bëjnë një ftese për kampe refugjatësh në Shqipëri. Shqipëria do të ishte e gatshme të ndajë peshën e çdo krize me familjen e vet europiane, por shqiptarët nuk janë njerëz naivë. Ata dyshimin e tyre do ta fillonin me pyetje të thjeshta... "Pse diçka që nuk është e mirë për Europën është e mirë për Shqipërinë?" Dhe më ironikja vjen më pas "Nëse na kërkoni diçka që nuk e bëni vet, a na bën kjo më europianë apo e kundërta?"... Janë 600 mijë pyetje për një të vërtetë. Natyrisht!", e mbyll komentin e tij, ministri.



Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko

MINISTRI I SHTETIT

"Shtëpia e shqiptarit është e zotit dhe e mikut. Kështu shkruhet në rregullat e lashta të trajtimit të të huajve që trokasin në derën e shtëpisë së shqiptarit. Shqiptarët janë populli më miqësor me të huajt dhe që i mbron ata me vullnet e pa kërkesë nga të tjerët" - tha ministri Majko.



## Edi Rama paralajmëron kryebashkiakët: Shurdhë e indiferentë, do publikoj emrat

Kryeministri Edi Rama kritikoi dje, bashkitë gjatë një takimi me qytetarë dhe bashkëpunëtorët e platformës së bashkëqeverisjes. Gjatë diskutimit të rasteve që kanë gjetur zgjidhje përmes platformës, Rama tha: "fatkeqësisht nuk jemi dot në lartësinë e duhur, kur vjen puna tek njësitë vendore. Bashkitë nuk përgjigjen shpesh në kohë dhe kjo është për të ardhur keq, sepse faktikisht janë institucionet që për natyrë, përveçse për ligj, janë më pranë njerëzve e komuniteteve dhe e vetmja zonë konflikti që kemi me qytetarët, herë pas here, jo për faj të tyre, është kur ata shkruajnë për çështje vendore që janë përgjegjësi e bashkive". Sipas Kryeministrit, "pjesa e Zyrës së Bashkëqeverisjes që mbulon pushtetin vendor bën të njëjtën punë që bën për çdo rast me pushtetin qendror, por has shpesh në shurdhëri dhe në indiferencë. Nuk kam dashur që t'i bëj publike rastet dhe nuk kam dashur që të publikoj drejtpërdrejtë emrat konkretë të bashkive dhe të kryetarëve të bashkive, por dua të them që do të jem i detyruar ta bëj këtë gjë, meqë zotërinjtë, - kryesisht janë zotërinjtë ata që nuk përgjigjen, zonjat kryetare bashkie janë më reaguese në përgjegjësi, - kanë edhe ambicien që të zgjidhen përsëri. Kështu që do të duhet ta llogarisin nga sot se do duhet të ballafaqohen publikisht me rastet që qytetarët referojnë në platformë dhe këta nuk duan të dinë fare dhe nuk përgjigjen". Kryeministri tha më tej, se "është e vetmja gjë që na ka mbetur, pasi koordinatorët që merren me bashkitë janë kthyer në lutësa. Luten më shumë sesa besimtarët që shkojnë në kishë apo në xhami dhe, nëse ata kanë një lutje drejtuar Zotit dhe e vlerësojnë ata sesi e marrin përgjigjen, lutjet e koordinatorëve të bashkëqeverisjes për bashkitë janë lutje drejtuar të zgjedhurve, që nuk përgjigjen". Kjo duhet të mbarojë, së paku si përgjegjësi e jona, si përgjegjësi e platformës. Po cenojnë reputacionin e platformës, që ne duam të jetë një reputacion pa asnjë cen dhe për këtë punohet ditë e natë".

## Xhafaj i kërkon Avramopoulos vëmendjen e Brukselit për flukset migratore nga Greqia

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj gjatë vizitës dy ditore në Bruksel, u takua me Komisionerin për Migracionin, Punët e Brendshme dhe Shtetësinë të Bashkimit Evropian, z.Dimitris Avramopoulos. Në fillim të takimit z. Avramopoulos vlerësoi shumë pozitivisht rezultatet mbresëlënëse të arritura gjatë këtij viti nga MB dhe policia shqiptare në luftën kundër krimit të organizuar. Komisioneri rikonfirmoi mbështetjen për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke theksuar se me anë të pozicionit të tij si Komisioner, do të mbështesë deri në fund aspiratat e Shqipërisë drejt familjes evropiane. Ministri Xhafaj çmoi punën e deritanishme që Komisioneri ka bërë në lidhje me adresimin e sfidave të Ballkanit Perëndimor, por veçanërisht për mbështetjen e pakursyer që ai ka dhënë për vendin tonë. Shqipëria ka pasur sukses me masat për uljen e azilkërkimit dhe emëruesi i tyre i përbashkët, është ulja e numrit të azil kërkuesve me rreth 30%, fakt ky që u vlerësua edhe nga Komisioneri. "Në lidhje me migracionin e parregullt, autoritetet shqiptare kanë një marrëdhënie shumë bashkëpunuese me homologët grekë, si vendi me prurjet më të mëdha të flukseve migratore gjatë muajve të fundit, por në këtë fushë nevojitet një vëmendje më e madhe e Brukselit për rritjen e kapaciteteve të strukturave tona kufitare", theksoi Ministri Xhafaj.



## Fleckenstein: Shqipëria meriton negociatat, edhe pse s'është e sigurt

Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Europian, Knut Flekenshtejn tha dje, se për të e rëndësishme është që Këshilli të hapë negociatat me Shqipërinë, edhe pse mund të ketë disa kushte. "Nëse Komisioni duhet të raportojë sërish në Këshillin e Ministrave, atëherë kjo do të thotë që negociatat nuk do të mund të konsiderohen ende të hapura", tha ai. "Dje fola edhe me disa kolegë të partisë popullore europiane. Ata mendojnë, se Shqipëria e meriton hapjen e negociatave, por nga ana tjetër, asgjë s'është e sigurt deri sa të merret vendimi përfundimtar. Kjo pasi shtetet anëtare tentojnë të gjejnë kompromise, nëse disa prej tyre kanë rezerva në këtë drejtim. Nuk jam naiv. Jam i informuar se ç'ndodh në prapaskenë dhe shoh që ka shtete anëtare që nuk e kanë shumë për zemër që të japin dritën jeshile tani",-tha Fleckenstein. Sipas tij, "ka probleme me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Edhe reforma në drejtësi është në zbatim e sipër, por nuk është zbatuar gjithçka. Pra, ka kaq shumë punë përpara. Duhet të përqendrohemi te çështja e pronës, tek rritja ekonomike, punësimi dhe shumë kritere të tjera. Por parakushtet për hapjen e negociatave janë përmbushur dhe ky është qëndrimi i pothuajse të gjitha grupimeve politike në Parlamentin Europian dhe Komisionit Europian".

# REFUGJATET

## DEBATET

Raporti: Që nga viti 2013, rreth 157 mijë qytetarë kanë kërkuar të largohen nga vendi

# Shqipëria, me numrin më të lartë të kërkesave në botë për azil në BE

## Në janar-mars 2018, rreth 4000 aplikime



Foto ilustruese

**RAPORTI**

Eurostat publikoi të dhënat e tremujorit të parë 2018 për azilkërkuesit që aplikuan për herë të parë në vendet e BE. Në 28 vendet e BE numërohen rreth 131 mijë azilkërkues të rinj për tremujorin e parë prej të cilëve 3%, ose rreth 4000 prej tyre, ishin shqiptarë. Fluksi i shqiptarëve që kërkojnë azil ka rënë në krahasim me vitet e kaluara, por Shqipëria kryeson shtetet europiane jashtë BE-së, por që kërkojnë azil në BE.

Shqiptarët, që jetojnë në një vend që aspiron të hyjë në Bashkimin Europian, duan të largohen nga shteti amë, më shumë sesa banorët e vendeve që janë në luftë, si Siria apo Iraku, në raport me popullsinë e tyre. Monitor ka përpunuar të dhënat e Raportit Vjetor të Situatës së Azilantëve, të publikuar nga Bashkimi Europian për kërkesat për azil nga e gjithë bota, në raport me popullsinë përkatëse për vitin 2017. Nga këto të dhëna, rezulton se Shqipëria vitin e kaluar renditej e shtata për numrin e azilkërkuesve në vlerë absolute, me 26,060 kërkesa për azil. Por, shifrat janë më alarmante kur bëjmë krahasimin në raport me popullsinë e secilit vend. Sipas llogarive të 'Monitor' për numrin e azilkërkuesve për herë të parë për 1000 banorë për secilin nga 20 shtetet që kryesojnë listën në vlerë absolute, Shqipëria renditet e para në botë, duke tejkaluar edhe azilkërkuesit që po ikin nga lufta dhe konfliktet, për shkak të popullsisë relativisht të vogël që ajo ka, prej 2.87 milionë banorësh. Për çdo 1000 banorë në Shqipëri, numri i azilkërkuesve në vendet e Bashkimit Europian ishte 9, duke kryesuar top-listën. Të dytët renditen shtetasit nga Gambia, me 6.5 kërkesa për azil në çdo 1000 banorë, duke u ndjekur nga sirianët, të cilët po i ikin njërit nga konfliktet më të përgjakshëm që ka njohur bota, me 5.9 kërkesa për 1000 banorë, të renditur të tretët. (shiko tabelën në fund). Afganistani, i cili për sa u përket numrit të azilkërkuesve, së bashku me Irakun, përbëjnë tre shtetet kryesore të origjinës së azilkërkuesve, sipas llogarive për 1000 banorë, renditen përkatësisht në vendin e 7 dhe 8. Në dhjetë vendet e para për numrin më të lartë për 1000 banorë kryesojnë kryesisht shtete nga lindja e mesme (ku ka konflikte) dhe Afrika. Edhe pse numri i aplikimeve nga Shqipëria ka rënë, përsëri renditemi ndër vendet me numër të lartë të tyre. Raporti vjetor mbi azilantët, gjithashtu, thekson se përqindjen më të ulët të pranimeve të këtyre kërkesave e kanë vendet nga Ballkani Perëndimor, si Shqipëria, Kosova dhe Serbia.

Edhe të dhënat për tremujorin e parë të 2018-s tregojnë se Shqipëria renditet ndër vendet me numrin më të lartë. Rreth 3% e azilkërkuesve për herë të parë në BE ishin me origjinë nga Shqipëria, apo afërsisht 4000 aplikime. Sipas Raportit vjetor të situatës së azilantëve, të publikuar nga Bashkimi Europian, Shqipëria renditet e shtata në botë për numrin e azilkërkuesve në Bashkimin Europian në vitin 2017, pas shteteve që i ikin luftës, si Siria, Iraku, Afganistani, Pakistani dhe Eritrea, me 26 mijë aplikime. Që nga viti 2013, rreth 157 mijë qytetarë shqiptarë kanë bërë kërkesë për azil, ku numri më i lartë ishte në 2015-n, me rreth 69 mijë persona, për të zbritur më pas në 33 mijë persona në 2016-n.

### KËRKESAT PËR AZIL

Shqiptarët vijuan të kryesojnë kërkesat për azil në BE ndër shtetet europiane edhe në tremujorin e parë të këtij viti. Eurostat publikoi të dhënat e tremujorit të parë 2018 për azilkërkuesit që aplikuan për herë të parë në vendet e BE. Në 28 vendet e BE numërohen rreth 131 mijë azilkërkues të rinj për tremujorin e parë prej të cilëve 3%, ose rreth 4000 prej tyre, ishin shqiptarë. Fluksi i shqiptarëve që kërkojnë azil ka rënë në krahasim me vitet e kaluara, por Shqipëria kryeson shtetet europiane jashtë BE-së, por që kërkojnë azil në BE.

Eurostat raportoi se gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, 131 000 azilkërkues për herë të parë kanë aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian (BE). Numri i azilkërkuesve u ul me 15% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2017, kur u regjistruan 154 000 aplikantë për herë të parë. Shumica e aplikimeve ishin nga sirianët, irakianët, afganët dhe nigerianët. Sirianët mbetën grupi më i madh i personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në vendet anëtare të BE. Sirianët ishin përpara irakianëve (9 200), afganëve (7 700 aplikantë për herë të parë) dhe nigerianëve (6 400).

Aplikantët nga këto shtete përbënin 30% të të totalit të azilantëve rishtarë në BE. Shumica e kërkesave për azil në Gjermani, Francë dhe Itali. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, numri më i madh i aplikantëve u regjistrua në Gjermani (me 34 400 aplikantë ose 26% të aplikantëve, në Francë (25 300 ose 19%), ndjekur nga Italia (17 800, ose 14%) dhe Greqia (13 000, ose 10%). Numri i azilkërkuesve për herë të parë u ul në krahasim me tremujorin e mëparshëm në Austri (-30%), Gjermani (-25% 24%) dhe Itali (-22%). Në të kundërt, rritjet u regjistruan në Belgjikë dhe Spanjë (si + 9%) dhe Holandë (+ 7%). Krahasuar me popullsinë në Qipro u regjistrua shkalla më e lartë e aplikantëve të regjistruar për herë të parë gjatë tremujorit të parë 2018 (1 551 aplikantë për 1 milion banorë), ndjekur nga Greqia (me 1 204 azilantë për 1 milion banorë, Malta (856 aplikantë për 1 milion banorë) dhe Luksemburgu. Në tremujorin e parë 2018, në total ishin 257 aplikantë për 1 milion banorë në BE në tërësi. Në fund të marsit 2018, mbi 892 000 kërkesa për azil në shtetet anëtare të BE ishin në shqyrtim nga autoritetet kombëtare, një rënie prej 10% krahasuar me marsin 2017 dhe 4% krahasuar me dhjetor 2017

| | | Nr azilanteve (2017) | Popullsia | Azilante per 1000 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Shqiperia | 26,060 | 2,876,000 | 9.1 |
| 2 | Gambia | 13,290 | 2,039,000 | 6.5 |
| 3 | Siria | 108,020 | 18,430,000 | 5.9 |
| 4 | Eritrea | 29,350 | 5,184,013 | 5.7 |
| 5 | Gjeorgjia | 12,000 | 3,179,000 | 3.8 |
| 6 | Guinea | 19,060 | 12,400,000 | 1.5 |
| 7 | Afganistan | 49,135 | 34,660,000 | 1.4 |
| 8 | Iraku | 52,590 | 37,200,000 | 1.4 |
| 9 | Somalia | 14,995 | 14,320,000 | 1.0 |
| 10 | Senegal | 10,705 | 15,410,000 | 0.7 |
| 11 | Bregu I Fildishte | 14,615 | 23,700,000 | 0.6 |
| 12 | Mali | 10,750 | 17,990,000 | 0.6 |
| 13 | Venezuela | 12,020 | 31,570,000 | 0.4 |
| 14 | Algjeria | 10,800 | 40,610,000 | 0.3 |
| 15 | Iran | 18,870 | 80,280,000 | 0.2 |
| 16 | Nigeria | 41,475 | 186,000,000 | 0.2 |
| 17 | Turqia | 16,640 | 79,510,000 | 0.2 |
| 18 | Paksitan | 31,995 | 193,200,000 | 0.2 |
| 19 | Bangladesh | 20,840 | 163,000,000 | 0.1 |
| 20 | Rusia | 17,065 | 143,300,000 | 0.1 |




### "Kamp për refugjatët", situatë hipotetike

## MB sqaron deklaratën e Hodajt në "ZDF": S'është çështje në shqyrtim



Pas publikimit të një kronike televizive të rrjetit gjerman "ZDF", për situatën me refugjatët ka reaguar Ministria e Brendshme e Shqipërisë. Përmes një reagimi për mediat, institucioni sqaron deklaratat e zv. ministrit të Brendshëm Julian Hodaj. Në reagim thuhet se përgjigjja e Hodajt lidhet me një situatë hipotetike emergjente. Kjo pasi ndërtimi i kampeve për imigrantë nuk është një çështje në shqyrtim apo në diskutim. "Nisur nga jehona mediatike e një kronike televizive të rrjetit gjerman ZDF, në datë 19.06.2018, me qëllim evitimin e spekulimeve dhe keqpërdorimeve të përmbajtjes së kësaj kronike, Ministria e Brendshme sqaron se: - Ndërtimi i kampeve për imigrantë nuk është një çështje në shqyrtim apo në diskutim. Askush nuk e ka kërkuar deri më sot dhe askush nuk e ka ofruar një gjë të tillë. - Thëniet e zv.ministrit Julian Hodaj, të cituara në kronikë janë përgjigjja e një pyetje konkrete: "Çfarë mund të bënte Shqipëria në kushtet e një emergjence imigrantësh?" Përgjigjja e kësaj pyetjeje është ajo që citohet: "Shqipëria e ka treguar gjatë luftës së Kosovës se është në gjendje të përballojë këto emergjenca". Pra, përgjigjja lidhet me një situatë hipotetike emergjence, si ajo gjatë luftës së Kosovës ku pati një angazhim shtetëror e popullor, dhe jo mbi një diskutim nëse një kamp mund të ndërtohet ose jo në Shqipëri",-thuhet në njoftimin e Ministrisë së Brendshme.



Demokratët akuzojnë për aferë korruptive, Beqajn, Ndreun, Qefalian dhe Abazin

# PD: 4 deputetët e Ramës përfituan tendera prej 78 milionë eurosh

## "Rama i babëzitur, po vjedh pasuritë publike"

Valentina Madani

Partia Demokratike denoncoi dje përfshirjen e 4 deputetëve të PS-së në afera korruptive, duke përfituar tendara prej 78 milionë eurosh. Drejtuesja e Departamentit Antikorrupsion në PD, Lealba Pelinku deklaroi se ish-ministri Ilir Beqaj dhe 3 deputetë të PS-së kanë përfituar tendera me kompanitë e tyre prej 78 milionë eurosh. "Që kur ka ardhur në pushtet, Edi Rama e ka përqendruar shpërndarjen e taksave të rritura të shqiptarëve në pak duar, që janë ose miq të tij, ose klientë, ose deputetë, me të cilët blen dhe mban pushtetin. Janë të paktën 4 deputetë të tij që përfitojnë para publike nëpërmjet kompanive të tyre, në shumicën dërrmuese të rasteve pa garë. Ilir Beqaj është njeriu më i afërt i Edi Ramës, i cili edhe pse nuk është më ministër, vazhdon të marrë me qindra miliona lekë nga taksat e shqiptarëve. Rasti më i fundit është ai i shpalljes fituese të kompanisë "Intech+", e zotëruar de facto prej Beqajt. Në një tender pa asnjë konkurrent, shoqëria e ish-ministrit që rrënoi shëndetësinë, u shpall fituese për 1 mld e 362 mln lekë ose 1,1 mln euro, duke pasur ofertë gati të njëjtë me fondin limit, pa i kursyer buxhetit gati asnjë qindarkë", tha zyrtarja e PD. Sipas Pelinkut, 1.1 milionë euro të fituara së fundmi nga taksat e rritura të shqiptarëve i shtohen pasurisë së Ilir Beqjas, i cili që kur Rama është bërë kryeministër, ka përfituar tendera me vlerë 29 milionë euro. PD deklaron se Ilir Beqja nuk është i vetëm në listën e deputetëve të Edi Ramës që pasurohen me paratë e shqiptarëve. "Prej kohës kur Edi Rama është kryeministër, Sadri Abazi ka fituar tendera me vlerë 34 milionë euro nga paratë publike. Media raportoi pak kohë më parë se në shumë prej tenderave, kompania ka paraqitur dokumentacion fals, por nga prokuroria, nën kontrollin e Edi Ramës, nuk ka asnjë reagim", u shpreh Pelinku. Ajo publikoi edhe emrat e 2 deputetëve e tjerë të Partisë Socialiste, Xhemal Qefalia dhe Pjerin Ndreu, që sipas saj kanë përfituar secili nga tenderat publikë prej 8.1 dhe 7 milionë euro. "Këta të 4 deputetë të Edi Ramës, Ilir Beqja, Sadri Abazi, Xhemal Qefalia dhe Pjerin Ndreu kanë përfituar së bashku 78 milionë euro nga paratë publike të shqiptarëve, të cilëve ata u kanë rritur çdo vit taksat në parlament. 78 milionë euro nga pasuria publike për 4 deputetë është rekord i babëzisë së pushtetit të Edi Ramës, i cili si qëllim të vetëm ka pasurimin e tij dhe të njerëzve të afërt të tij për të blerë pushtetin dhe për të sunduar shqiptarët", deklaron zyrtarja e PD. Zj.Pelinku shprehu shqetësimin se: "Të tilla rekorde korruptive janë një nga pengesat madhore të hapjes së negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian".



Drejtuesja e Departamentit Antikorrupsion në PD, Lealba Pelinku

**REAGIMI**

Deputeti i PS-së Pjerin Ndreu iu kundërpërgjigj PD-së teksa tha se ai nuk ka as firma dhe as ka përfituar tendera dhe para publike. Ai i cilësoi Berishën dhe Bashën gënjeshtarë, duke shtuar se ka familje më vete dhe jo me vëllezërit e tij. "S'kam asnjë biznes e asnjë llogari askund përveç rrogës së shtetit", - tha Ndreu.

**AKUZA**

"78 milionë euro nga pasuria publike për 4 deputetë është rekord i babëzisë së pushtetit të Edi Ramës, i cili si qëllim të vetëm ka pasurimin e tij dhe të njerëzve të afërt të tij për të blerë pushtetin dhe për të sunduar shqiptarët", deklaron PD.

## Debati tek "Ekonomia", Braçe mbyll mbledhjen i tensionuar. Spaho: S'është serioze

Komisioni parlamentar i Ekonomisë u përfshi dje nga debat mes kreut Erion Braçe dhe deputetit të PD-së, Klevis Balliu që në nisje të mbledhjes. Balliu akuzoi qeverinë si të korruptuar dhe për këtë arsye sipas tij, çelja e negociatave është e pamundur. Gjithashtu, Balliu hodhi akuza edhe në adresë të kompanisë që do ndërtojë Teatrin e ri Kombëtar, akuza të cilat sipas Braçes janë gjobëvënie. Insistimit të Balliut për t'i ndërprerë fjalën, Braçe iu përgjigj duke mbyllur mbledhjen ende pa nisur mirë. Për këtë reagoi kreu i deputetëve të PD-së, Edmond Spaho, duke e quajtur joserioze mbylljen dy herë radhazi të mbledhjes së komisionit. "Brenda këtij komisioni ka edhe kolegë socialistë, që e kuptojnë këtë gjë që është e pamundur të ketë hapje negociatash në një moment kur kemi një korrupsion galopant. Dhe këtu po marr shembullin e kompanisë "Fusha", e cila në mënyrë të paprecedentë ka marrë 129 tendera, 90 milionë euro. Në një vend kaq të vogël, 90 milionë euro. Janë vjedhur 865 milionë euro, shumë marramendëse për një vend si Shqipëria"- tha Balliu

**DEBATI TE KOMISIONI PARLAMENTAR I EKONOMISË**

**KLEVIS BALLIU:** Brenda këtij komisioni ka edhe kolegë socialistë, që e kuptojnë këtë gjë që është e pamundur të ketë hapje negociatash në një moment kur kemi një korrupsion galopant. Dhe këtu po marr shembullin e kompanisë "Fusha", e cila në mënyrë të paprecedentë ka marrë 129 tendera, 90 milionë euro. Në një vend kaq të vogël, 90 milionë euro. Janë vjedhur 865 milionë euro, shumë marramendëse për një vend si Shqipëria. Tani z.Rama kërkon të marrë 600 mijë sirianë dhe kërkon të zëvendësojë popullin e Skënderbeut me popullin e Sulltanit. Sa shqiptarë janë larguar vitet e fundit? 600 mijë shqiptarë. I thoni atij zotërisë si ka mundësi që ikën këta?

**ERION BRAÇE:** Këtë komision nuk e përdor dot as ti, as unë dhe askush për t'u vendosur gjobë kompanive që operojnë në tregun e shqiptar. Po të kishte lexuar raportin e KLSH-së, do kishe kuptuar që vlera prej 826 mln euro përbëhet nga mungesa e vendosjes së gjobave për makinat e sekuestruara, që operonin në mënyrë të paligjshme si lojëra fati. O djalë, nga dhjetori...

**KLEVIS BALLIU:** E para njëherë, djalë shko thuaji ndonjë tjetri...

**ERION BRAÇE:** OO, ndjesë... deputet i nderuar. Dëgjo pak, nga dhjetori kur erdhi kjo prokurorja që e identifikoni si tonën e deri tani KLSH ka kallëzuar vetëm 5 çështje, dy të tjera...

**KLEVIS BALLIU:** Zoti kryetar, çfarë justifikimi ke për këtë?

**ERION BRAÇE:** Kur s'di gjë, mbylle tani dhe mos e vazhdo më. Do rrish tani që ta mbaroj unë?

**KLEVIS BALLIU:** Mbylle ti.

**ERION BRAÇE:** Atëherë mbledhja e komisionit mbyllet.

**KLEVIS BALLIU:** Të fala mbylljes dhe kujt të duash... Përgjigju këtyre letrave njëherë.

**ERION BRAÇE:** S'do ketë mbledhje këtu sa kohë do jesh i pranishëm ti. Nuk do ketë mbledhje...

**KLEVIS BALLIU:** Erjon, më shumë shanse kam të hyjë unë këtu brenda se ti, vazhdo rrugën tani...

**EDMOND SPAHO:** Edhe dje e mbylle mbledhjen kështu, nuk është serioze...

---

"Taksat brenda një viti janë 2 dhe 4-fishuar"

## PD, Tabaku: Biznesi të kundërshtojë rritjen e taksave

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku akuzoi dje qeverinë për rritje abuzive të taksave të biznesit nga 2 deri 4-fish më shumë se një vit më parë. Sipas Tabakut, mbi 100 mijë biznese janë mbyllur, ndërsa 500 mijë shqiptarë janë larguar, sepse nuk ka punë. Mes të tjerash, Tabaku ka publikuar dy fatura të viteve para taksës së re të pronës dhe pas saj tek i njëjti biznes. "Bizneset sot denoncojnë rritjen abuzive të taksave, e cila sivjet do t'u kushtojë xhepave të çdo biznesi 230 mijë lekë më shumë se sa tri vitet e marra së bashku. Vetëm taksa e pronës është rritur 2 deri 4-fish më shumë sesa një vit më parë. Sa herë që Edi Rama flet për ulje taksash, ndodh e kundërta! Kur thotë që ka ulur taksat, në fakt i ka rritur ato; kur thotë që punon për shqiptarët, në fakt do të thotë se punon për bizneset e qeverisë; kur thotë që ka shpenzuar për shqiptarët, në fakt ka shpenzuar për luksin e tij. Jo rastësisht mbi 100 mijë biznese janë mbyllur, 500 mijë shqiptarë largohen sepse nuk ka punë, 1 milion të tjerë aplikojnë për në SHBA sepse nuk ka shpresë. Taksat e rritura sot kapin vlerë e 5 miliardë USD në total, i paguajnë bizneset dhe shqiptarët për qejfet dhe luksin e rilindjes. Janë dy fatura të viteve para taksës së re të pronës dhe pas saj tek i njëjti biznes. Ftoj bizneset e tjera të denoncojnë rritjen e taksave", shprehet zj.Tabaku.



## Emërimi, PD: Drejtori i ri i hipotekës, në kundërshtim me ligjin

Partia Demokratike, dega Sarandë, reagoi dje pas emërimit të drejtorit të ri të Hipotekës në Sarandë, Gledi Duka, i cili zëvendëson në këtë post Jonida Abdulin, e shkarkuar nga Rama pak ditë më parë. Përmes një deklarate, PD e Sarandës shprehet se komandimi i Gledi Dukës në krye të ZVRPP Sarandë është në kundërshtim me ligjin, pasi nuk ka përvojën e punës. "PD bën thirrje për t'i thënë 'Stop' kësaj paligjshmërie. Sapo në drejtim të qeverisë dhe institucioneve të vijnë drejtuesit që e meritojnë, ne do të hetojmë çdo firmë të hedhur në dokumentet e ZVRPP Sarandë prej dt.20.06.2018", thuhet në njoftimin e PD.

Lejet e legalizimit regjistrohen përmes portalit "e-Albania" brenda 10 ditëve

# Kreu i Hipotekës: Pajisim me tapi 400 shtëpi në muaj

## Tapia për ndërtimet pa leje, ndryshon procedura, kostoja 5 mijë lekë

Ornela Manjani

Hipoteka e Tiranës ka katërfishuar numrin e certifikatave të pronësisë për objektet e legalizuara. Lajmin e ka bërë të ditur kryeregjistruesi Vladrin Pjetri, gjatë takimit të zhvilluar në Kamëz, kuadër të turit të llogaridhënies publike. Sipas tij, procesi i titujve të pronësisë po ecën me ritme të shpejta. "Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë prej katër muajsh, nga 400 certifikata në muaj, tani përgatit 1600 certifikata në muaj vetëm nga lejet e legalizimeve", deklaroi Pjetri. Ndërkohë, kryeregjistruesi u bëri thirrje qytetarëve që të bëhen pjesë e platformës së bashkëqeverisjes, "shqipëriaqë-duam.al" për të marrë zgjidhje për çdo problematikë që lidhet me zyrat e shërbimeve.


kryeregjistruesi Vladrin Pjetri

### REGJISTRIMI NË "e-ALBANIA"

Lejet e legalizimeve mund të regjistrohen në hipotekë brenda 10 ditëve me një kosto prej 5 mijë lekësh, pa qenë nevoja të prisni ALUIZNI-n të dorëzojë dosjen në hipotekë. Personat që kanë ndërtuar pa leje dhe janë pajisur me lejen e legalizimit, mund të marrin tapinë për shërbimit që ofrohet në "e-Albania". Pronari i objektit duhet të identifikohet në faqen zyrtare në internet me numrin e kartës së identitetit ose pasaportë biometrike (të nevojshme për t'u loguar në portalin "e-Albania") dhe të dërgojë një shkresë përcjellëse nga institucioni që ka lëshuar lejen e legalizimit.

### APLIKIMI

Shërbimi elektronik në faqen "e-Albania" u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për regjistrimin e objekteve të legalizuara. Bëhet regjistrimi i objektit të legalizuar menjëherë pas përcjelljes për regjistrim nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizmit, Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, të lejes së legalizimit dhe dokumentacionit. Regjistrimi kryhet në favor të subjektit, të cilit i është lëshuar leja e legalizimit. Pas dërgimit të aplikimit drejt ZRPP-së, ai do të procesohet nga specialisti i ZRPP-së dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet informimit me email, dërgimit të përgjigjes elektronike te "Dokumentet e mia" në profilin e qytetarit në "e-Albania", si dhe me shërbim postar nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), në zbatim të ligjit nr. 33/2012, bëhet nga kërkuesi vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noteri apo asistenti i noterit. Pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme funksionon Regjistri Elektronik i Përpunimit të Kërkesave, i cili garanton trajtimin e praktikave sipas radhës së paraqitjes së kërkesave. Minimalisht, në regjistër regjistrohen numri i kërkesës, data e paraqitjes dhe data e përfundimit të afatit për trajtim, sipas rendit kronologjik. Kërkuesi, që paraqet një kërkesë për kryerjen e një shërbimi nga ZRPP-ja pajiset me një numër identifikimi të kërkesës dhe Kodin e Sigurisë, me anë të të cilëve mund të verifikojë gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij.

### PËRGJIGJJA

Kthimi i përgjigjes elektronike dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet dërgimit te "Dokumentet e mia" në "e-Albania" dhe informimit me email për shkarkimin e përgjigjes elektronike. Gjithashtu, nëse qytetari dëshiron përgjigjen në format letër, e merr nëpërmjet shërbimit postar. Çdo tarifë për shërbimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit.

### LEGALIZIMET

Sipas ligjit në fuqi, ka edhe një alternativë tjetër për aplikimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pajisjen me certifikatë pronësie të ndërtimeve të pajisura me leje legalizimi. Vetë Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimore Informale aplikon për llogari të personit që ka marrë lejen e legalizimit duke dorëzuar në hipotekë edhe të gjithë praktikën ligjore të nevojshme për regjistrimin e pasurisë, shtëpisë apo biznesit.

**TARIFA E SHËRBIMIT**

Tarifa është 5 mijë lekë për shërbimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit. Aplikuesi duhet të presë 10 ditë për të marrë tapinë për shtëpinë ose njësinë e biznesit të që ka të legalizuar.

**DOKUMENTET DHE PROCEDURA**

**DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM**

**1.** Dokument identifikimi i përdoruesit: kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin 'e-Albania').
**2.** Shkresë përcjellëse nga institucioni që ka lëshuar aktin.

Hapat e procedurës

**1.** Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portal.
**2.** Zgjidhni shërbimin "Regjistrimi i objekteve të legalizuara".
**3.** Klikoni butonin "Përdor".
**4.** Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, mbi pronën, mbi shërbimin/shërbimet e kërkuara dhe taksat e nevojshme.
**5.** Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit.
**6.** Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën e nevojshme.
**7.** Punonjësi i ZRPP-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit, me URL-në e shkarkimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek "Dokumentet e mia" në "e-Albania", ose me njoftimin e arsyes së refuzimit.

# Ahmetaj: Euro nuk dëmtoi eksportet, në 5 muaj u rritën me 12%

Ministri i Financave, Arben Ahmetaj hedh poshtë pretendimet se zhvlerësimi i euros po dëmton eksportet shqiptare. Duke folur në një aktivitet për buxhetin afatmesëm, kreu i Financave tha se një euro e dobët ka ndikuar tek fitimet e eksportuesve, por përsëri në 5 muaj ato janë rritur me 12.4% si dhe janë bërë më konkurruese. Aktualisht një euro po shkëmbehet në nivelin e 129.93 lekë, pavarësisht ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë për të blerë euro në treg. Pavarësisht ankesave të eksportuesve shqiptarë se zhvlerësimi i euros po i shkakton humbje të mëdha, kreu i Financave, Arben Ahmetaj, tha se të dhënat tregojnë të kundërtën. Ministri Ahmetaj pranoi se zhvlerësimi i euros ka pasur një efekt modest tek të ardhurat, por në tërësi sipas tij, eksportet tona janë bërë më konkurruese dhe janë rritur me 12.4% në 5 muaj. "Eksportet për shkak të mbivlerësimit të lekut kanë atë dëmin e vet, që është kollaj i përllogaritshëm, megjithatë po ta shikoni, rritja e eksporteve në volume dhe në zgjerim tregjesh tregon dy elementë: pikësëpari, volumet kanë rikuperuar goditjen që mund t'i ketë dhënë kursi i këmbimit", -deklaroi Ahmetaj. Duke folur në një konsultë për buxhetin afatmesëm 2019-2021, Ahmetaj tha se fokus do të jetë rritja e mirëqenies dhe e të punësuarve, ndërsa pranoi se papunësia te të rinjtë mbetet problem. "Ulja e papunësisë tek të rinjtë? Shumë kemi për të bërë, shumë është bërë, megjithëse praktikisht papunësia tek të rinjtë në Shqipëri është më e ulëta në rajon, asnjë nga ne nuk mund të krenohet më të sepse vazhdon të jetë përsëri shumë e lartë, larg asaj që kemi pritshmëri brenda këtij mandati", - tha ministri i Financave dhe Ekonomisë.



# Sejko pret ambasadoren franceze

## Diskutohet roli i BSH në parandalimin e pastrimit të parave

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko priti sot në një takim me ambasadoren e Republikës Franceze në Tiranë, Christina Vasak dhe shefin e Sektorit Ekonomik Rajonal rezident në Sofje, Jean-Marie Demange. Guvernatori i njohu bashkëbiseduesit me zhvillimet ekonomike në vend, ku theksoi se rritja ekonomike është në trajektore pozitive zhvillimi dhe balancat kryesore ekonomike pritet të forcohen në vitet e ardhshme. Lidhur me sistemin financiar, guvernatori Sejko u shpreh se ai karakterizohet nga nivele të kënaqshme kapitalizimi dhe likuiditeti. Guvernatori u ndal në panoramën e sektorit bankar, ku veçoi dy elemente kyçe, rritjen e kreditimit dhe përmirësimin e treguesit të kredive me probleme. Ai u shpreh se nxitja e mëtejshme e kredisë për ekonominë dhe zbatimi i planit për trajtimin e kredive me probleme mbeten në fokusin e BSH. Guvernatori Sejko shtoi se sistemi bankar, si subjekt i ligjit të pastrimit të parave, ndodhet në proces zhvillimi dhe konsolidimi. "Parandalimi i pastrimit të parave ka qenë gjithashtu objekt monitorimi e vlerësimi, jo vetëm nga autoritetet mbikëqyrëse brenda vendit, por edhe nga institucionet ndërkombëtare të specializuara, të cilat kanë dhënë vlerësime mjaft pozitive, ndër të cilat mund të përmenden vlerësimet e Komitetit Moneyval", - tha Sejko. Ambasadorja Franceze, Christina Vasak dhe Jean-Marie Demange falënderuan guvernatorin Sejko për takimin dhe shprehën vlerësimet e tyre për kontributin e vazhdueshëm që BSH jep në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit.



Suedi Sverige

INSTAT Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave

**INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA**
**TENDER NOTIFICATION**

Institute of Statistics of Albania intends to award a contract for **Bid 1: Equipment for data centre and network, and installation**" in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training centre, with Sida contribution nr: 55020289.
The tender dossier is available at http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ : from **June 18, 2018.**
The deadline for submission of tenders is: **July 18, 2018,** time **10:00** hrs, at Institute of Statistics of Albania, Blv. "Zhan D'Ark", No. 3, Tirana, Albania.
Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/.
Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to 14 days before the date of submission of offers.

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**
**NJOFTIM TENDERI**

Në kuadër të projektit: "Financim direkt për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e qendrës së trajnimit, "Sida contribution nr: 55020289"", financuar nga qeveria Suedeze, e përfaqsuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: *Bid 1: "Pajisje për server dhe rrjetin, dhe instalim".*

Dokumentat e tenderit mund ti gjeni në adresën: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/, nga data **18.06.2018**.
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është: **18.07.2018, ora 10:00**, në adresën: Instituti i Statistikave, Blv. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë.
Informacionet shtesë ose sqarime/pyetje, do të publikohen në: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ .
Kërkesa për sqarime mund të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, deri në 14 ditë para ditës së fundit për dorëzimin e ofertave.

### Si u inskenua ngjarja dhe video 37 minutash që publikoi deputeti i Shkodrës

# Atentati i supozuar për vrasje, prokuroria: 8 muaj burg për Doshin, Frrokun dhe Bamin

## *Zbardhet dosja e plotë, ja çfarë i tha Durim Bami ish-ministrit Tahiri*


Durim Bami


Tom Doshi


Mark Frroku

Ina Allkanjari

Prokuroria e Tiranës ka dhënë ditën e djeshme pretencën për Tom Doshin, Mark Frrokun dhe Durim Bamin, të cilët akuzohen për 'kallëzim të rremë' kryer në bashkëpunim, për një atentat të pretenduar nga ana e deputetit Doshi për eliminimin fizik të tij. Organi i akuzës ka kërkuar dënimin me nga 8 muaj burg për të tre personat. "Gazeta Shqiptare" ka siguruar dosjen e plotë të prokurorisë ku theksohet se të pandehurit në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë krijuar prova të rreme me qëllim për të ushtruar ndjekje penale ndaj Ilir Metës, në atë kohë Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë. Konkretisht sipas organit të akuzës rezulton e provuar se Tom Doshi, Mark Frroku dhe Durim Bami, kanë krijuar prova të rreme për një krim që do të kryhej nëpërmjet krijimit të një regjistrimi me përmbajtje të rreme si dhe krijimit të rrethanave të rreme lidhur me ngjarje dhe persona, për ta bërë të besueshëm ekzistencën e një krimi të paqenë. Më tej në dosje sqarohet deklarata e të pandehurit Durim Bami përpara grupit hetimor. Sipas organit të akuzës ngjarja mësohet të jetë sajuar pas gushtit të vitit 2014, pas një telefonate që ka marrë Tom Doshi nga i pandehuri Mark Frroku, i cili i ka kërkuar një bisedë urgjente. Gjithashtu, në mbështetje të pretendimeve të tij, Tom Doshi ka dorëzuar në prokurorisë një USB, e cila përmban një regjistrim audio dhe video prej 37 minutash, ku Bami pohon se është paguar për ekzekutimin e Doshit. "Në deklaratën e dhënë Bami u shpreh se ka qenë Doshi që e ka telefonuar dhe i ka kërkuar ta takojë. Gjatë bisedës Toma i ka thënë që "kam qejf me të ndihmu, por dua edhe ti të më ndihmosh për diçka që unë do të kërkoj", dhe ai i është përgjigjur se "nëse është diçka që bëhet, do mundohem që të ndihmoj". Aty i pandehuri Doshi i ka kërkuar që donte prej tij të bënte të besueshëm faktin sikur Tomën kanë dashur ta vrasin dhe personi që paguante për vrasjen e tij, ishte Ilir Meta. Më tej në dosjen e prokurorisë thuhet se gjatë deklaratës Bami është shprehur se ka rënë dakord me Tomën se sajesën e orvatjes së vrasjes së tij, do t'ia shpjegonte dhe ministrit të Brendshëm Saimir Tahirit, me të cilin rezultoi se është takuar disa herë e një rast dhe në prani të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Artan Didi.

**DOSJA E PLOTË**

Sipas organit të akuzës në muajin gusht të vitit 2014, i pandehuri Tom Doshi, ka qenë jashtë Shqipërisë, me pushime ndërsa ka marrë një telefonatë nga i pandehuri Mark Frroku, i cili i ka kërkuar një bisedë urgjente. Tom Doshi i ka shpjeguar se nuk ndodhej në Shqipëri dhe për këtë arsye ata e kanë lënë takimin pasi ai është kthyer nga pushimet. Nga aktet e administruara ka rezultuar se ky takim është zhvilluar nga fundi i muajit gusht 2014, në ambientet e Hotel "Sheraton", Tiranë. Sipas hetimeve paraprake në këtë takim i pandehuri Mark Frroku e ka bërë me dije Tom Doshin se ndaj tij po përgatitej të kryhej një atentat për vrasjen e tij dhe se vrasjen do ta kryente një shtetas me emrin Durim Bami. Sipas Markut, Durim Bamit i ishte ofruar shuma prej 500.00 eurosh për të kryer vrasjen. Mark Frroku ka marrë përsipër, gjithashtu, që ta prezantonte Tom Doshin me personin që do të kryente vrasjen me qëllim që ai të merrte vesh më në detaje, rrethanat e kryerjes së këtij atentati. Me ndërmjetësinë e Frrokut, takimi mes Doshit dhe Bamit, është zhvilluar disa ditë më pas. Lidhur me këtë takim Tom Doshi ka shpjeguar se Durimi i ka thënë se porosia për të realizuar vrasjen ndaj tij ishte dhënë nga Ilir Meta, në atë kohë Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet një personi të quajtur Fatjon Skënderi. Ky i fundit administronte një lokal që ndodhej në zonën e ish-Bllokut, Tiranë. "Pretendohet, gjithashtu, që personi tjetër i përfshirë në këtë ngjarje është shtetasi Rezart Skënderi, i cili për periudhën në fjalë ka pasur si detyrë të vazhdonte lëvizjet e Doshit, nëpër ambientet, të cilat ai i frekuentonte. Sipas Tom Doshit, gjatë takimeve të mëpasshme që ka realizuar me Bamin me ose pa praninë e Mark Frrokut, Bami ndër të tjera i ka thënë se në muajin qershor të vitit 2014, në afërsi të makinës së tij të parkuar pranë gjykatës kushtetuese në tiranë, këta persona kishin vendosur një motoçikletë, brenda së cilës gjendej një sasi eksplozivi që ishte paracaktuar të shpërthehej në kohën që Doshi do të hipte në makinën e tij"-thuhet në dosje. Më tej theksohet se Bami i kishte thënë, gjithashtu, se ai nuk kishte pranuar që të realizonte shpërthimin, pasi kishte pasur frikë se nga shpërthimi mund të dëmtoheshin edhe persona të tjerë. Në mbështetje të pretendimeve të tij, Tom Doshi ka dorëzuar para prokurorisë një USB, e cila përmban një regjistrim audio dhe video prej 37 minutash, ku Bami pohon para tij planin si më sipër. Doshi ka deklaruar, gjithashtu, se e ka parë sasinë e eksplozivit të pretenduar se ishte vënë në motorin pranë makinës së tij, të cilën e ka fotografuar me aparat celular tek ambientet e banesës së Durim Bamit, e cila ndodhej në zonën e plazhit në Durrës. I pyetur nga grupi hetimor Frroku ka shpjeguar dhe insistuar se nuk ka asnjë njohje me Durim Bamin. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk ka qenë ai që ia ka dhënë këtë informacion deputetit Tom Doshi, për më tepër që ta këtë prezantuar këtë të fundit me ndonjë shtetas me emrin Durim Bami. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur lidhur me këtë rrethanë edhe Bami, i cili është ndaluar më datë 03.03.2015, në tentativë për t'u larguar nga Shqipëria. I pyetur fillimisht si deklarues e mandej nën hetim, i pandehuri Durim Bami ka deklaruar se arsyeja e largimit të tij ishte si rrjedhojë e situatës së krijuar në media ku deputeti Doshi kishte thënë se personi që është paguar nga Ilir Meta për të vrarë atë është filmuar dhe larguar me ministrin e Brendshëm. Për këto fakte atë e ka njoftuar bashkëshortja e tij Benarda në telefon që ngа jashtë shtetit. Bami më tej ka deklaruar se Tom Doshin e ka njohur nëpërmjet shtetasit Alfons Shpati, që është nipi i Tomës dhe njëkohësisht edhe njohje e tij e vjetër. Në deklaratën e dhënë Bami u shpreh se ka qenë Doshi që e ka telefonuar dhe i kërkuar ta takojë. Gjatë bisedës Toma i ka thënë që "kam qejf me të ndihmu, por dua edhe ti të më ndihmosh për diçka që unë do të kërkoj", dhe ai i është përgjigjur se "nëse është diçka që bëhet, do mundohem që të ndihmoj". Aty i pandehuri Doshi i ka kërkuar që donte prej tij të bënte të besueshëm faktin sikur Tomën kanë dashur ta vrasin dhe personi që paguante për vrasjen e tij, ishte Ilir Meta. Më tej Bami shpjegon se i është kërkuar që të bëhej dëshmitar dhe të thoshte në polici që ai ishte personi i paguar që do të kryente vrasjen e Tom Doshit. Gjithë kjo situatë deklaron ai, do të ishte një gjë e sajuar midis Tom Doshit dhe atij. Pasi ra dakord për ta bërë këtë veprim, Toma i kishte premtuar se di t'i jepte një shumë lekësh, shifrën konkrete nuk ia ka thënë, por Durimi ka kuptuar se bëhej fjalë për një shifër të madhe. Sipas tij, ka qenë Toma që i ka kërkuar të gjente një person të tretë që do të bënte porositësin e vrasjes, pra lidhjen mes atij dhe Ilir Metës, pasi vetë Durimi nuk njihej me Ilir Metën. Durimi ka menduar se personi më i përshtatshëm do të ishte Fatjon Skënderi. Më tej sqaroi përpara grupit hetimor se ka qenë Doshi që i ka ofruar që të sajojnë një video sikur ndaj tij ishin bërë përpjekje për ta vrarë. Më tej në dosjen e prokurorisë thuhet se gjatë deklaratës Bami është shprehur se ka rënë dakord me Tomën se sajesën e orvatjes së vrasjes së tij, do t'ia shpjegonte dhe ministrit të Brendshëm Saimir Tahirit, me të cilin rezultoi se është takuar disa herë e një rast dhe në prani të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Artan Didi. Para ministrit Bami ka pohuar të njëjtat rrethana që ka deklaruar edhe deputeti Tom Doshi, të cilat janë edhe në filmimin e bërë por, edhe pse i është ofruar mbrojtje konform gjithë rregullave në fuqi, nuk ka pranuar të iniciojë procedim hetimor, pra të bëjë deklarime para shërbimeve të Policisë Gjyqësore sepse sikundër shpjegon ai, ajo çfarë ishte regjistruar mes tij dhe Tomës ishte thjesht një sajesë.

"I pandehuri Durim Bami deklaron, gjithashtu, se personat që ka implikuar në thënien e tij si Fatjon Skënderi apo Rezarti, nuk kanë asnjë dijeni për këto rrethana",-thuhet në dosjen e prokurorisë. Gjithashtu, Bami ka konfirmuar se plani i vrasjes së Tom Doshit ishte i gjithi një sajesë e kryer për qëllime të këtij të fundit, dhe hedh poshtë çdo dyshim të ngritur se ai apo familja e tij janë kërcënuar dhe kanë ndikuar në qëndrimin e mbajtur prej tij në këtë proces. Më tej theksohet se rezulton, gjithashtu, që qëndrimi i të pandehurve Mark Frroku dhe Durim Bami në raport me njohjet mes njëri-tjetrit dhe me të pandehurin Tom Doshi, nuk është në përputhje me atë çfarë ka rezultuar e provuar në gjykim të kësaj çështjeje. Një analizë tërësore e provave të marra në këtë gjykim, provon qartë edhe bashkautorësinë e të pandehurit Mark Frroku në këtë sajesë provash të rreme. Fakti që shtetasi Mark Frroku ka njohje me Durim Bamin mbështetet edhe në ballafaqimin e bërë midis shtetasit Tom Doshi dhe të dyshuarit Bami. Ky i fundit që prej fillimit të procedimit, ka këmbëngulur se nuk e njihte shtetasin Mark Frroku dhe se nuk e ka takuar asnjëherë atë, por e ka parë vetëm në televizor. Ndërkohë gjatë ballafaqimit, pasi iu vu në dispozicion një foto e printuar nga sistemi Tims e shtetasit Mark Frroku, ai e pranoi se e ka takuar personin e paraqitur në foto në prani të shtetasit Tom Doshi disa herë. Sakaq në dosjen e prokurorisë thuhet se një provë e rëndësishme është edhe prova materiale "USB", e vënë në dispozicion të hetimit nga i pandehuri Tom Doshi, nga ekspertimi i së cilës duken pamjet filmike të lokal "Viva" në Tiranë, me praninë e personave Fatjon Skënderaj, Ylli Xhaxhollari dhe Eugen Bec, të servirur këta si organizatorë të vrasjes së Tomës. Këto pamje filmike, të pandehurit Tom Doshi ia ka dhënë të kopjuara Mark Frroku, ku në përmbajtjen e tij gjenden edhe disa të dhëna të aktivitetit të biznesit të tij. Kjo provë vërteton faktin se është pikërisht Mark Frroku personi që ka iniciuar alibinë e planit për eliminimin fizik të Tom Doshit.

**INSKENIMI**

Në dosjen e prokurorisë thuhet se gjatë deklaratës Durim Bani është shprehur se ka rënë dakord me Tomën se sajesën e orvatjes së vrasjes së tij, do t'ia shpjegonte dhe ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri me të cilin rezultoi se është takuar disa herë e një rast dhe në prani të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Artan Didi.

**MARK FRROKU**

I pyetur nga grupi hetimor Mark Frroku ka shpjeguar dhe insistuar se nuk ka asnjë njohje me Durim Bamin. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk ka qenë ai që ka njoftuar deputetin Tom Doshi për organizimin e vrasjes së supozuar ndaj tij, për më tepër që ta kete prezantuar këtë të fundit me ndonjë shtetas me emrin Durim Bami.

### Nëna e 2 fëmijëve: Më dhunonte dhe kërcënonte

# Vrau burrin në pazarin e Milotit, gjykata vendos "Arrest me burg" për 35-vjeçaren Violeta Donaj



Violeta Donaj në gjykatë

**KURBIN** - Gjykata e Kurbinit ka vendosur masën e sigurisë "burg pa afat" për Violeta Donajn, e cila mëngjesin e së dielës qëlloi me 4 plumba bashkëshortin, Kujtim Donaj pas konflikteve që kishin me njeri-tjetrin. 35-vjeçarja e përlotur dhe në gjendje të rëndë emocionale ka shprehur pendesë në sallën e gjyqit. Ajo u shpreh në sallën e gjyqit se "nuk doja ta vrisja burrin, nuk e di si e kam bërë". Sipas saj, i shoqi i kërkonte gjithmonë para pasi luante bixhoz dhe e keqtrajtonte. "Më çonte tek puna, merrte çelësin e makinës dhe rrinte duke u sjellë me shoqërinë. Më dhunonte fizikisht në sy të fëmijëve dhe të gjitha paratë që ne fitonim i linte në bixhoz, po na shkatërronte. Për më tepër ai më kishte kërcënuar se po ta denoncoja për dhunë do të dënohej vetëm 3 apo 6 muaj. Por kur të dal, çfarë mund të ndodhë ty më thoshte..." Ndërkaq, 35-vjeçarja deklaroi se armën me të cilën vrau bashkëshortin 42-vjeçar e gjeti në makinën që e përdornin të dy. Pas dëshmisë së saj, trupi gjykues vendosi lënien në qeli të Violeta Donajt për akuzat "Vrasje e kryer në rrethana familjare" dhe "Armëmbajtje pa leje". Çifti kishte dy fëmijë dhe çdo të diel dilnin tek tregu i Milotit për të punuar. Të dielën e 17 qershorit Violeta Donaj, banuese në Rrëshen, hyri në tregun e Milotit me pistoletë në dorë dhe pas disa fjalëve që ka shkëmbyer me bashkëshortin Kujtim Donaj qëlloi 4 herë në drejtim të tij, duke e lënë të vdekur në vend. Sipas dëshmisë së vëllait të Violetës, ajo kishte disa ditë që ishte larguar nga shtëpia bashkëshortore, ndërsa mëngjesin e së dielës, kur edhe ndërmori aktin e rëndë ajo iu ka thënë familjarëve se do shkonte në shtëpinë e saj në Rrëshen për të marrë rrobat.



Viktima Kujtim Donaj

### "Kërkojmë zhvarrosjen e trupit. Nëse nuk zbardhet e vërteta, do bëjmë vetëgjyqësi"

# I riu vdiq në komisariat, ekspertiza: Enea Ftoj nuk u dhunua nga policia

## *Reagojnë familjarët: Djali u rrah barbarisht*



27-vjeçari Enea Ftoj



Prindrit e 27-vjeçarit

**KORÇË**

Enea Ftoj, i cili një muaj më parë u gjet i vdekur në ambientet e paraburgimit të Korçës nuk ka humbur jetën për shkak të dhunës së policisë, siç pretendojnë familjarët e tij. Ekspertiza mjekoligjore ka dalë në konkluzionin se ndaj tij nuk është ushtruar dhunë. Ky konkluzion është bërë dje me dije për median nga zv. ministrja e Brendshme, Romina Kuko; zv. drejtorja e Policisë së Shtetit Aida Hajnaj dhe Drejtorja e Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA) Anila Trimi, të cilat ishin në familjen e të ndjerit për të ofruar mbështetje dhe ndihmë në bashkëpunim me pushtetin lokal. "Do t'u qëndrojmë pranë familjarëve me sa të mundemi," është shprehur Kuko. Ndërsa, Anila Trimi deklaroi se sipas ekspertizës, i riu nuk ka humbur jetën nga dhuna e policisë. "Sot (dje) është e provuar shkencërisht nga Instituti i Mjekësisë Ligjore që ndaj shtetasit Enea Ftoji nuk është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Ne do të vazhdojmë hetimet e mëtejshme në lidhje me këtë rast",-është shprehur drejtoresha e SHÇBA. Ndërkaq, familjarët e 27-vjeçarit (baba i dy fëmijëve) është e bindur se Enea humbi jetën për shkak se është dhunuar nga policët që në momentin e ndalimit (dyshohej për vjedhje) dhe më pas në komisariat. Lajmi për rezultatin e ekspertizës ka tronditur familjarët, të cilët deklaruan se e mësuan nga media.

**REAGIMI I FAMILJARËVE**

"Nuk kemi dijeni për rezultatet e ekspertizës. Nga mediat mësuam që policia thotë se vdekja e Eneas ishte natyrore dhe nuk është ushtruar dhunë nga policët. Djali vdiq në komisariat nga dhuna e policisë. E rrahën edhe kur e shoqëruan edhe në ambientet e komisariatit. Policia fshehu dhunën",-thanë prindërit e viktimës. Ndërkaq, i ati i 27-vjeçarit pohoi se "im bir është dhunuar barbarisht. Isha vetë në morg dhe i pashë shenjat në trup dhe fytyrë. Unë i bëra foto djalit dhe në fytyrë kishte të ënjtura dhe shenja. Jemi të bindur që është dhunuar. Do të bëjmë zhvarrosjen e trupit dhe të bëhet përsëri ekspertizë. Nëse nuk do zbardhet e vërteta do bëjmë vetëgjyqësi. Fëmijët e Eneas i mori nusja dhe ka ikur nga shtëpia. Nuk na ka ndihmuar askush. Gjakun e djalit nuk ma blen askush".

**NGJARJA**

27-vjeçari Enea Ftoj ndërroi jetë më 17 maj në ambientet e paraburgimit të Korçës, ku kishte 3 ditë që qëndronte pasi ishte ndaluar për vjedhje. Ditën kur ndodhi ngjarja, i riu duhej të dilte në sallën e gjyqit për akuzën që rëndonte ndaj tij. Ndonëse familjarët e prisnin atë në sallën e gjyqit, ata u njoftuan se ai kishte ndërruar jetë. Pas ngjarjes, familjarët e viktimës hodhën akuza të rënda për policinë. Ata akuzojnë efektivin Arqile Ropi, pasi pretendojnë se ai ka ushtruar dhunë ndaj Eneas dhe për pasojë ai ka humbur jetën.



### Dy të burgosurit për vrasjen e Vrenozit, akuzohen për një tjetër grabitje

**VLORË** - Policia e Vlorës ka dokumentuar me prova ligjore një vjedhje me armë zjarri, ndodhur në shtator të vitit 2017. Ngjarja ka ndodhur më datë 15.09.2017, në afërsi të fshatit Mazhar, ku dy persona i kanë dalë në rrugë me armë zjarri shtetasit D.H., banues në Samaticë, Berat, i cili ka qenë duke udhëtuar me automjetin "Benz". Nga kryerja e veprimeve hetimore janë siguruar prova ligjore, të cilat kanë identifikuar si autor të dyshuar shtetasit: L.D., 43 vjeç, banues në Vajzë, Vlorë dhe Z.F., 36 vjeç, banues në Sevaster, Vlorë. Aktualisht dy shtetasit e mësipërm ndodhen duke vuajtur dënimin "Arrest me burg", në IEVP Fier, për veprën penale "Vjedhje me armë, kryer në bashkëpunim". Ata janë autorë të grabitjes së ndodhur në mars të këtij viti në Fier, ku mbeti i vrarë Agur Vrenozi, i cili ndërhyri të ndihmojë pronarin e pikës së këmbimit valutor.



# Sekuestrohen 500 kg kanabis në Karaburun, do trafikohej në Itali me gomonen që u kap në Fier

**VLORË /FIER** - Policia e Vlorës ka sekuestruar dje 500 kg kanabis në Gjirin e Bristanit në Karaburun, e cila ishte gati për t'u transportuar në drejtim të Italisë. Në operacion kanë marrë pjesë policia Kufitare dhe Forca Detare, të cilat kanë bërë të mundur zbulimin dhe sekuestrimin e lëndës narkotike. Ndërsa po punohet për identifikimin dhe kapjen e trafikantëve. Dyshohet se droga do të ngarkohej në gomonen 12 metra të gjatë që u gjet në orët e vona të mbrëmjes të së martës e braktisur në plazhin e Darzezës në Fier. Skafistët braktisën gomonen me dy motorë nga 300 kuaj fuqi secili sapo panë policinë dhe u fshehën në pyll. Gomonia ka qëndruar deri në orët e para të mëngjesit të djeshëm në plazhin e Darzezës dhe më pas është marrë nga forcat e Guardia di Finanza dhe Policia Kufitare Shqiptare. Sipas hetimeve të para dyshohet se gomonia kishte ardhur nga Italia për t'u ngarkuar me drogë në bregdetin shqiptar dhe më pas për t'u kthyer sërish, por është pikasur nga policia, çka ka çuar në dështimin e trafikut.





Banesa e familjes Neziri në Durrës



Bashkëshortët e plagosur, rëndë në spital. Fqinjët: Pamë tmerr me sy, banesa e rruga plot gjak

# "Çmenduri" në Durrës, 25-vjeçari Neziri masakron prindërit me thikë

## I riu arrestohet 1 orë pas krimit në Tiranë. Goditi 6 herë nënën në bark dhe babain 75-vjeçar në fyt

Klodiana Haxhiaj

**DURRËS**

Krimi në familje tron dit Durrësin. Një 25-vjeçar me origjinë nga Dibra ka masakruar me thikë prindërit e tij të moshuar. Bëhet fjalë për 75-vjeçarin Destan Neziri dhe 64-vjeçaren Hasije Neziri, të cilët kanë përfunduar me gjendje të rëndë në spitalin e qytetit bregdetar. Mësohet se bashkëshortët Neziri kanë marrë plagë të shumta dhe ndodhen në reanimacion nën kujdesin e mjekëve. Vetëm një orë më pas, autori i krimit Hajri Neziri është arrestuar në Spitalin e Traumës në Tiranë. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Durrësit bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 14:45 të ditës së djeshme në lagjen nr. 17 (në zonën e ish-Kënetës) të këtij qyteti. Menjëherë pas sinjalizimit për plagosjen e dy personave, policia ka shkuar në banesën trekatëshe të familjes Neziri dhe ka nisur hetimin për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Ndërkohë, fqinjët e kësaj familjeje deklaruan për "Gazeta Shqiptare" se kanë parë tmerr me sy dhe se banesa e çiftit Neziri si dhe rrugica janë larë me gjak. Gjithashtu, fqinjët u shprehën se kanë dëgjuar ulërimat dhe thirrjet e dy të moshuarve, të cilët kishin dalë zvarrë nga banesa e tyre dhe kërkonin ndihmë.

**NGJARJA**

Nuk ka të ndalur dhuna në familje. Pas ngjarjes së ndodhur në tregun e Milotit, ku gruaja vrau burrin me 4 plumba pistolete dhe ngjarjes së ndodhur në Memaliaj ku burri goditi gruan e tij 57 vjeçe me sqepar, rasti më i fundit u shënua pasditen e djeshme në qytetin e Durrësit. Mësohet se 25-vjeçari Hajri Neziri fillimisht ka debatuar ashpër me prindërit dhe më pas sherri ka degjeneruar në sulm me thikë. Në sherr e sipër, djali i vogël i familjes Neziri ka goditur disa herë nënën dhe babain, duke u shkaktuar plagë të shumta. Burime nga vendngjarja flasin për një masakër të vërtetë. Mësohet se 64-vjeçarja Hasije Neziri është goditur 6 herë me thikë në bark. Ndërsa bashkëshorti 75-vjeçar, Destan Neziri ka marrë një goditje thike në qafë (plagë e rëndë) dhe një në fytyrë. Pas krimit, autori Hajri Neziri është larguar së bashku me vajzën me të cilën bashkëjetonte prej disa kohësh. I riu u kap një orë pas krimit në Tiranë. Burime për "GSH" thanë se 25-vjeçari është paraqitur i lënduar (shoqërohej nga bashkëjetuesja) në spitalin e Traumës në Tiranë, ndërsa është lajmëruar policia, e cila e ka arrestuar. Aktualisht ai po merr mjekim për lëndimet që ka në trup (dyshohet nga konflikti me prindërit), ndërsa më pas do të transferohet në Durrës nga policia për t'u marrë në pyetje. Nga të dhënat paraprake, ka dyshime se pjesë e konfliktit të këtë qenë edhe dashura e 25-vjeçarit. Ndonëse ngjarja është ende e paqartë, ka dyshime se prindërit nuk ishin dakord për lidhjen e dy të rinjve. Sakaq, policia po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

**DËSHMIA E FQINJËVE**

"Kemi parë tmerr me sy. Është larë i gjithë vendi me gjak. Një masakër e vërtetë ka ndodhur në familjen Neziri, të cilët janë me origjinë nga Dibra dhe prej afro 20 vitesh banojnë këtu. Dëgjuam ulërima, pastaj gjetëm bashkëshortët Neziri të mbytur në gjak. Është e tmerrshme kjo që ndodhi, djali të masakrojë nënën e babain me thikë. Destani dhe Hasija", tha një fqinje e familjes në fjalë. Ndërsa disa komshinj të tjerë u shprehën se bashkëshortët që mbetën të plagosur janë njerëz të qetë dhe intelektualë, ndërsa thanë se nuk kishin dijeni për ndonjë konflikt në këtë familje. "Unë isha në ballkon, kur pashë Hajriun që doli nga banesa bashkë me vajzën me të cilën bashkëjeton. Më bëri përshtypje se vajza e kishte njërin krah të bluzës gjithë gjak. Më pas pashë Hajriun që hodhi thikën, me të cilën kishte goditur prindërit. Fillimisht nuk dija se çfarë kishte ndodhur. Vetëm pak çaste më pas, dëgjova ulërimat e bashkëshortëve Neziri. Ata kishin dalë nga banesa të mbuluar në gjak dhe po kërkonin ndihmë. Gjithë rrugica ku ecën ata u mbulua me gjak. Dolëm menjëherë, gjetëm një makinë dhe i çuam në spitalin e Durrësit", pohoi një tjetër fqinje e familjes Neziri. Kjo e fundit tha se Hajriu është djali i vogël i familjes, ndërsa fëmijët e tjerë të bashkëshortëve Neziri janë emigrantë në Itali. "Hajriu ka qenë djalë i urtë, i sjellshëm. Nuk e di pse i masakroi prindërit e tij. Kohët e fundit ai bashkëjetonte me një vajzë. Mbase sherri ka marrë shkas nga ajo. Mbase prindërit e tij nuk donin që ai të lidhej me vajzën", thanë fqinjët e 25-vjeçarit. Ndërkaq, një tjetër fqinj u shpreh se: "Hajriu ishte i papunë. Gjithashtu edhe vajza me të cilën bashkëjetonte ishte e papunë. Mbase ata u hanin lekët e pensionit dy pleqve dhe këta të fundit i kanë thënë djalit që të dilte nga banesa dhe ta ndërtonte jetën e tij vetë".



Rruga e përgjakur

**ARRESTIMI I AUTORIT**

Pas krimit, autori Hajri Neziri është larguar nga banesa së bashku me vajzën me të cilën bashkëjetonte prej disa kohësh. I riu u kap një orë pas krimit në Tiranë. Burime për "GSH" thanë se 25-vjeçari është paraqitur i lënduar në spitalin e Traumës në Tiranë, ndërsa është lajmëruar policia, e cila e ka arrestuar. Aktualisht ai po merr mjekim për lëndimet që ka në trup (dyshohet nga konflikti me prindërit), ndërsa më pas do të transferohet në Durrës nga policia për t'u marrë në pyetje. Nga të dhënat paraprake, ka dyshime se pjesë e konfliktit të këtë qenë edhe dashura e 25-vjeçarit.

**75-vjeçari: Aman më shpëtoni gruan, e goditi im bir!**

### E fejuara e 25-vjeçarit në polici: Shkaktare e ngjarjes, vjehrra

Pas arrestimit në Tiranë, 25-vjeçari Hajri Neziri është dërguar në komisariatin e Durrësit ku është marrë në pyetje. Burime nga grupi hetimor thanë për "GSH" se i riu ka dhënë shumë pak të dhëna për ngjarjen e rëndë dhe ka shfaqur shenja depresioni. Ndërkaq, është marrë në pyetje dhe bashkëjetuesja e tij, e cila ka rrëfyer se si u plagosën vjehrra dhe vjehrri i saj. "Po shikonim të katërt ndeshjen e radhës së kampionatit botëror. Ishim të qetë, nuk kishim sherre dhe asgjë. Vjehrra ime që është një grua e sertë nisi të debatojë me të fejuarin tim, duke i thënë se nuk punon, se të dy ishim të papunë. Ishte sherr i çastit. Unë u dashurova me djalin e saj, por ajo nuk me donte pasi unë jam nga Puka. Në sherr e sipër, Hajriu u përlesh me të ëmën dhe e goditi disa herë me thikë. Pastaj ndërhyri vjehrri që t'i ndante, por i fejuari im e goditi dhe atë me thikë",- është shprehur e reja. Ndërkaq, ajo ka sqaruar se: "unë ndërhyra që t'i ndaja. Nuk mbaj mend më se çfarë ndodhi, por pashë se shtëpia u bë gjithë gjak. Dhe unë u bëra me gjak në krah dhe në fustan. Pastaj ikëm nga shtëpia se ishim terrorizuar. Të fejuarit tim i rridhte gjak nga dora, ndaj shkuam në Spitalin e Traumës në Tiranë. Shkaku i gjithë asaj që ndodhi ishte vjehrra ime". Ndërkaq, policia ka marrë në pyetje dhe 75-vjeçarin Destan Neziri. Ky i fundit ka deklaruar se: "Ndërhyra për të shpëtuar gruan nga djali". Nga ana tjetër, i moshuari u ka thënë mjekëve të spitalit të Durrësit: "Aman, më shpëtoni gruan që e goditi im bir"!

**RRËFIMI**

"Unë isha në ballkon kur pashë Hajriun që doli nga banesa bashkë me vajzën me të cilën bashkëjeton. Më bëri përshtypje se vajza e kishte njërin krah të bluzës gjithë gjak. Më pas pashë Hajriun që hodhi thikën, me të cilën kishte goditur prindërit. Fillimisht nuk dija se çfarë kishte ndodhur. Vetëm pak çaste më pas, dëgjova ulërimat e bashkëshortëve Neziri. Ata kishin dalë nga banesa të mbuluar në gjak dhe po kërkonin ndihmë".

### Kanos me armë zjarri kushëririn, bie në pranga 43-vjeçari

**FIER** - Një 43-vjeçar nga Roskoveci në Fier është arrestuar nga policia, pasi ka kanosur me armë zjarri kushëririn e tij. Mësohet se ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta. Sipas bluve, Ardit (Eduart) Ruko nga fshati Strum, në sherr e sipër ka kanosur me pistoletë të afërmin e tij G.R., 41 vjeç, banues po në këtë fshat. Menjëherë policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Mësohet se janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 2 gëzhoja pistolete. Materialet në ngarkim të 43-vjeçarit do t'i kalojnë Prokurorisë së Fierit për veprat penale "Kanosje" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak".

### Tokat e zënë nga ndërtimet pa leje

# Kompensimi i pronave, qeveria miraton fondin 732 milionë lekë



Miratohet fondi për kompensimin e pronarëve, që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi arrin në 732 milionë për sipërfaqe prej 43 965 m2. Përfituesit janë në Tiranë, Kamëz, Vorë, Elbasan, Durrës, fshatra turistikë dhe Shkodër. Vendimi është marrë në mbledhjen e djeshme të Këshillit të Ministrave dhe në pikën 2 të tij thuhet se "masa e kompensimit është 43 965,31 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 731 847 186,22 lekë". Qeveria urdhëron Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht në Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Shkodër të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Ndërkohë që ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyrat Vendore të Regjistrimit Të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi. Për të përfituar kompensimin për tokën e zënë nga ndërtimet pa leje duhet të paraqesin në ATP kërkesë për kompensim në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI). Pronari plotëson një kërkesë për kompensimin në vlerë sipas formatit-tip, që vihet në dispozicion nga ATP-ja. I interesuari duhet të paraqesë dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie. Një tjetër dokument është vërtetimi i lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar. ATP-ja kërkon fotokopjen e dokumentit të identifikimit dhe certifikatën familjare të kërkuesit dhe mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit.

### Ulet në 5% tatimi mbi fitimin për xhiron vjetore deri në 14 mln lekë

# Qeveria lehtëson barrën e taksave, ja kush përfiton

## *Marrja e së drejtës së pronësisë mbi tokën tatohet 15%*

Ornela Manjani

**BIZNESI**
Shkalla e tatimit mbi fitimin për bizneset është ulur, pasi është ngritur baza e tatueshme. Kështu, tatim-fitimi do të jetë 5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit dhe 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit. Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr.38/2012.

Qeveria ka miratuar ndryshimet në paketën fiskale, duke ndryshuar shkallën e tatimfitimit e të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Këshilli i Ministrave vendosi të lehtësojë barrën fiskale për një sërë kategorish si për bizneset, ashtu edhe për individët.

**TATIM-FITIMI**

Qeveria vendosi që fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore tatohet me normën 15 për qind. Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme. Shkalla e tatimit mbi fitimin për bizneset është ulur, pasi është ngritur baza e tatueshme. Kështu, tatim-fitimi do të jetë 5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit dhe 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit. Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr.38/2012, "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%. Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari agroturistike të certifikuar si "agroturizëm", bazuar në ligjin nr.93/2015, "Për turizmin" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton kriteret për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%. Norma e reduktuar e tatimit mbi fitimin 5%, e parashikuar sipas këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin "subjekt i certifikuar agroturizmi" deri në dhjetor 2021. Efektet e normës së reduktuar fillojnë në vitin pasardhës pas përfitimit të statusit "subjekt i certifikuar agroturizmi".



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

**LOJËRAT E FATIT**

Tatimi mbi lojërat e fatit sipas nenit 52/2, të ligjit nr.155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15% mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr.95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre. Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

**TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR**

Shkalla e reduktuar e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar 6 për qind aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit, restorantit, të ofruar brenda strukturave në të cilat zhvillohet veprimtari pritëse e certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, me përjashtim të furnizimit të pijeve, të ofruar në këto struktura. Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si "agroturizëm".

**NDRYSHIMET E SHKALLËS SË TATIMIT**

- **SHKALLA E TATIMIT MBI FITIMIN**
5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.

- **SHKALLA E TATIMIT PËR PRONAT E PALUAJTSHME**
Fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme është në normën 15 për qind.

- **PËR SHOQËRITË E BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR**
Shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%.
Për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit
Shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%.

- **TATIMI MBI LOJËRAT E FATIT**
Shkalla e tatimit 15% mbi të ardhurat bruto.
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit, restorantit.

**KRITERET**

# Zbardhet vendimi për pasuritë shtetërore, toka me qira, afatet dhe tarifat e reja



Përcaktohen kriteret e reja, afatet dhe tarifat për dhënien me qira të tokave bujqësore shtetërore. Me një vendim të posaçëm, Këshilli i Ministrave miratoi dje kontratën-tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit. Objekt i qiradhënies, sipas këtij vendimi, janë të gjitha sipërfaqet e lira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, të cilat me vendime të Këshillit të Ministrave i janë dhënë në përgjegjësi administrimi ministrisë dhe tokat bujqësore shtetërore, që janë dhënë me qira nga ish-drejtoritë e bujqësisë, afati i kontratave të qiradhënies të të cilave ka përfunduar ose përfundon pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Afati i paraqitjes së ofertave zgjat 45 ditë kalendarike, nga data e publikimit të njoftimit për procedurën konkurruese. Vlera vjetore e dhënies me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit fillon nga vlera minimale 17000-27000 lekë/ha në vit deri në 5000-10000 lekë/ha në vit. Tokat bujqësore në pronësi të shtetit jepen me qira për afate kohore 10 deri në 30 vjet dhe deri në 99 vjet kur destinohen për krijim ullishtash, për krijim pemëtoresh me drufrutorë si kulturat arrore dhe specie të tjera, mosha biologjike e të cilave përkon me këtë kohëzgjatje.

Njihuni me zgjidhjet korrekte edhe në Filozofi, Biologji e Gjuhë Angleze

# Matura Shtetërore, zbardhen përgjigjet e sakta të provimeve me zgjedhje

## Skemat e vlerësimit për Qytetarinë, Ekonominë e Sociologjinë



Voltiza Duro

Dje 37 mijë maturantë në mbarë vendin iu nënshtruan provimit të fundit të Maturës Shtetërore 2018-të, atij të lëndëve me zgjedhje. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje përmbante 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje ishin me përgjigje alternative dhe do të vlerësohen me 10 pikë, ndërsa 10 pyetje ishin me zgjidhje dhe do të vlerësohen me 30 pikë. Provimi i fundit, i cili zgjati 4 orë përgjithësisht u konsiderua mesatar nga maturantët, por shumë prej tyre u shprehën se nuk kishin kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për të dyja lëndët. "Gazeta Shqiptare" publikon sot përgjigjet e sakta të disa prej testimeve në lëndët që janë zgjedhur më së tepërmi nga nxënësit. Respektivisht bëhet fjalë për skemën e vlerësimit në lëndën e Qytetarisë, Sociologjisë, Ekonomisë Bërthamë, Biologjisë Bërthamë, Filozofisë dhe Gjuhës Angleze. Ndërkohë, pas 10 ditësh maturantët do të kenë mundësinë të njihen me rezultatet dhe pikët që kanë arritur të grumbullojnë nga testet e lëndëve me zgjedhje.



**PROCESI I TESTIMIT**

"Gazeta Shqiptare" ditën e djeshme ka qenë pranë ambienteve të gjimnazit "Qemal Stafa" në kryeqytet ku ka ndjekur nga afër mbarëvajtjen e procesit të provimit të fundit të Maturës Shtetërore. E pyetur nga 'GSH', një nga maturantet e këtij gjimnazi tregon se testet ishin mesatare, por koha për të mësuar e pamjaftueshme. "Pyetjet ishin të nivelit mesatar, por na kishin lënë shumë pak ditë për të mësuar. Ne i kemi kaluar të gjitha temat gjatë vitit, por përsëritja për dy lëndë kërkon më shumë hapësirë kohore"-thotë për 'GSH' nxënësja.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

**PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018**
**SESIONI I**

**SKEMA E VLERËSIMIT** **VARIANTI A**

**Lënda: Qytetari**

**Udhëzime të përgjithshme**

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

***Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

***Pyetjet me zgjedhje***

| Numri i Pyetjes | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përgjigja e saktë | B | B | A | B | A | B | D | C | B | C |

***Pyetjet me zhvillim***

**Pyetja 11** **2 pikë**

Model përgjigjeje:
- E drejta për arsimim.
- E drejta për të shprehur identitetin fetar.
- E drejta e prindit për të vendosur për arsimimin e fëmijës së tij.
- E drejta e fëmijës për t'u pyetur për çështjet që lidhen me interesat e tij.

**2 pikë** Nëse shkruan dy të drejta;
**OSE**
**1 pikë** Nëse shkruan një të drejtë;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12** **3 pikë**

Model përgjigjeje:
a) Standardeve shkollore/kushteve shkollore.
b) Mësuesve/edukatorëve.
c) Teksteve/ materialeve mësimore.

©QSHA 1 20 qershor, 2018
Skemë vlerësimi Qytetari Varianti A

**3 pikë** Nëse shkruan përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a, b dhe c.
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan përgjigjet për dy nga kërkesat.
**1 pikë** Nëse shkruan vetëm njërën nga kërkesat.
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13** **4 pikë**

Model përgjigjeje:
- Kultura e shëndetit;
- Praktikat e trashëguara;
- Mosnjohja/moskuptimi i pasojave të sjelljeve të dëmshme për vetë individin dhe shoqërinë;
- Indiferenca e institucioneve shtetërore që janë përgjegjës për informim dhe edukim shëndetësor (si p.sh., ministria e shëndetësisë/ mjedisit/arsimit ose shkolla, etj.
- Mungesa e ndëshkimeve ligjore;
- Indiferenca morale e grupit/shoqërisë;
- Shoqatat jofitimprurëse;
- Media;
- etj.

**4 pikë** Nëse shkruan katër faktorë;
**OSE**
**3 pikë** Nëse shkruan tre faktorë;
**2 pikë** Nëse shkruan dy faktorë;
**1 pikë** Nëse shkruan një faktor;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 14** **3 pikë**

Model përgjigjeje:
- shtyrja e moshës së martesës/mundësia e grave për të lindur fëmijë për shkak të moshës biologjike;
- kërkesa e të rinjve për kushte më të mira jetese dhe përkujdesje ndaj fëmijëve. Sigurimi i shkollimit, punësimit, të ardhurave, strehimit, karrierës, etj.
- shtimi i formës së bashkëjetesës së të rinjve;
- dëshira e të rinjve për të pasur sa më pak përgjegjësi dhe për të "shijuar jetën";
- emancipimi/zhvillimi i gruas, dëshira e saj për arsimim, karrierë, pavarësi ndaj bashkëshortit, etj.
- zgjatja e kohës së shkollimit dhe e studimeve pasuniversitare;
- konkurrenca në tregun e punës;
- emigrimi i të rinjve;
- planifikimi familjar;
- modernizimi i shkencës së mjekësisë;
- ndërgjegjësimi për rritjen e kulturës shëndetësore;
- kujdesi nga politikat shtetërore dhe organizata për moshën e tretë;
- etj.

**3 pikë** Nëse shkruan tre shkaqe;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy shkaqe;
**1 pikë** Nëse shkruan një shkak;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

©QSHA 2 20 qershor, 2018
Skemë vlerësimi Qytetari Varianti A

**Pyetja 15** **2 pikë**

Model përgjigjeje:
- pakësimi i përdorimit të metodave të ndëshkimit;
- trajtimi i dështimit të nxënësve;
- të mësuarit e aftësive të rëndësishme sociale;
- përcaktimi i rregullave të qarta për sjelljen e nxënësve;
- përforcimi i sjelljeve pozitive;
- respektimi i ndryshimeve kulturore /etnike;
- aktivitetet jashtëshkollore;
- zbatimi i rregullave disiplinore;
- të respektojë të drejtat e nxënësit/të krijojë respekt te nxënësit;
- t'i stimulojë nxënësit/ të japë vazhdimisht reagime pozitive, specifike, të vërteta, të shkurtra, ndaj çdo nxënësi;
- të shfaqë besim dhe pritshmëri;
- të krijojë një klimë pozitive në klasë dhe mjediset e tjera shkollore;
- të shpenzojë kohë të veçantë me nxënësit problematikë;
- angazhimi dhe inkurajimi i pjesëmarrjes në procesin mësimor/aktivizimi;
- theksimi i arritjeve;
- motivimi i nxënësve;
- mos etiketimi/krahasimi me të tjerët/shmangia e shfaqjes së mosbesimit në përmbushjen e detyrave;
- marrja në konsideratë e tipareve të moshës/veçorive personale të nxënësve/personalitetit të tyre/problemeve sociale, etj.
- shmangia e subjektivizmit, intolerancës, paragjykimeve/diferencimeve, etj.
- etj.

**2 pikë** Nëse shkruan dy mënyra;
**OSE**
**1 pikë** Nëse shkruan një mënyrë;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 16** **4 pikë**

Model përgjigjeje:
a)
- bazohen mbi vlerat morale që shprehin idenë e shoqërisë mbi atë se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar.
- mbështesin atë që është e drejtë për shoqërinë dhe përpiqen të ndalojnë ato sjellje dhe veprime të cilat janë të dëmshme për anëtarët e shoqërisë dhe shoqërinë në vetvete.
  - kuptimi relativ i sjelljeve deviante: vrasja e pushtuesit apo për vetëmbrojtje nuk është e paligjshme)

b) reflektojnë raportin e qeverisë me individin.
Ligjet:
- përcaktojnë dhe rregullojnë marrëdhëniet në një fushë të caktuar, në shkallë të ndryshme;
- mbështesin ose kundërshtojnë vlera të caktuara politike të individëve ose grupeve të ndryshme në shoqëri;
  -ligjet që nxisin luftën kundër korrupsionit, nxisin pjesëmarrjen e anëtarëve të shoqërisë në luftën kundër kësaj dukurie.

**4 pikë** Nëse përshkruan nga dy elemente për të dyja vlerat e kërkuara;
**OSE**

©QSHA 3 20 qershor, 2018

Skemë vlerësimi Qytetari Varianti A

**3 pikë** Nëse përshkruan dy elemente për njërën nga vlerat dhe një element për tjetrën;
**2 pikë** Nëse përshkruan nga një element për të dyja vlerat e kërkuara;
**1 pikë** Nëse përshkruan një element për njërën nga vlerat e kërkuara;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 17** **3 pikë**

- mbingarkesa,
- orari i zgjatur,
- kushtet e vështira,
- sëmundjet profesionale,
- profesionet e vështira dhe me përgjegjësi,
- mosrespektimi/diskriminimi në punë,
- etj.

**3 pikë** Nëse shkruan tre shkaqe;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy shkaqe;
**1 pikë** Nëse shkruan një shkak;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 18** **3 pikë**

Model përgjigjeje:
- garancia është marrje përsipër pa pagesë shtesë e detyrimeve nga shitësi ose prodhuesi te konsumatori.
- detyrimet lidhen me rimbursimin e çmimit të paguar, /zëvendësimin / riparimin e mallit, plotësisht ose pjesërisht, për ta sjellë në kushtet e vëna në deklaratën e garancisë ose në reklamën përkatëse,
- Konsumatori mund të ankohet individualisht, në grup, me anë të shoqatës së konsumatorëve, deri në rrugë gjyqësore, etj.
- çdo mospërputhje e mallit me kushtet e deklaruara në garanci ose në reklamë, dhe që konstatohet brenda një periudhe kohe të caktuar, bëjnë që shitësi të marrë përsipër përgjegjësinë.
- afati i kthimit të mallit, në bazë të garancisë, është i ndryshëm për mallra të ndryshëm/ koha e garancisë varet nga jetëgjatësia e mallit.
- etj.

***Shënim: Nxënësi merr pikë edhe nëse shprehet me nga një shembull për secilën kërkesë.***

**3 pikë** Nëse shkruan tre aspekte nga legjislacioni;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy aspekte nga legjislacioni;
**1 pikë** Nëse shkruan një aspekt nga legjislacioni;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

©QSHA 4 20 qershor, 2018
Skemë vlerësimi Qytetari Varianti A

**Pyetja 19** **3 pikë**

a)
- kanë formën e trekëndëshit barabrinjës me kulm nga lart,
- kanë kontur me ngjyrë të kuqe,
- kanë sfond të bardhë ose të verdhë /kur janë pranë kantiereve rrugore, që tregon se punohet) kanë simbol në ngjyrë të zezë.

b)
- shmangin aksidentet e mundshme.
- janë sinjale që paralajmërojnë mbajtjen e një distance të nevojshme ose një situatë rreziku;

**3 pikë** Nëse shkruan dy tipare dhe funksionin;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy tipare;
**2 pikë** Nëse shkruan një tipar dhe funksionin;
**1 pikë** Nëse shkruan një tipar;
**1 pikë** Nëse shkruan funksionin;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 20** **3 pikë**

Model përgjigjeje:
- emisionet dhe informacionet përpunohen nga një staf më i specializuar profesionistësh;
- lajmet kanë më pak mundësi modifikimi nga kushdo;
- ndiqen nga njerëz të çdo niveli grupmoshe ose kulture;
- niveli i kulturës dhe gjuha e përdorur është e kuptueshme për të gjithë;
- kamera televizive zbulon të vërtetën drejtpërsëdrejti nga vendi i ngjarjes, prandaj besueshmëria është më e lartë;
- informacioni është më serioz dhe i kontrolluar nga redaksia e televizionit;
- ka më pak mundësi të shfaqë programe të ndaluara për grupmosha të veçanta, (fëmijët), etj.
- kontrollohen më lehtë nga të rriturit (prindërit) programet që ndjekin fëmijët;
- rrit shoqërizimin pasi programet ndiqen në grup (familje/shoqëri);

- rrit shoqërizimin pasi programet ndiqen në grup (familje/shoqëri);
- është më i lehtë në përdorim;
- ka më pak shpenzime;
- ekrani i madh rrit cilësinë e shikimit dhe argëtimit;
- etj.

**3 pikë** Nëse shkruan tri përparësi;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy përparësi;
**1 pikë** Nëse shkruan një përparësi;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018
## SESIONI I

**SKEMA E VLERËSIMIT** **VARIANTI A**

### Lënda: Ekonomi bërthamë

**Udhëzime të përgjithshme**

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

***Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjespor që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

**Pyetjet me zgjedhje**

| Numri ipyetjes | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përgjigja e saktë | A | C | D | A | D | D | B | B | A | C |

**Pyetjet me zhvillim**

**Pyetja 11** **3 pikë**

a) Konsumatori (familja)
b) Bizneset (firmat)
c) Qeveria

**3 pikë** Nëse shkruan tre subjekte;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy subjekte;
**1 pikë** Nëse shkruan një subjekt;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.





**Pyetja 12** **3 pikë**

a) $P_e$=6 500
b) Për çmimet1 000/ 2500/ 4000
c) Për çmimin 10 000 njësi paraje ngelen 1 500 vende bosh

**3 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a), b) dhe c);
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë vetëm njërën nga kërkesat;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13** **3 pikë**

- ulja e çmimit të motorrave të ujit,
- rritja e çmimit të faktorëve të prodhimit për prodhimin e tyre,
- rritja e taksave nga qeveria,
- rritja e çmimit të biçikletave të ujit,
- teknologjia e vjetruar.

**3 pikë** Nëse shkruan tre faktorë;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy faktorë;
**1 pikë** Nëse shkruan një faktor;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 14** **3 pikë**

a) të ardhurat nga puna janë 215 000
b) të ardhurat nga pasuria janë 45 000 + 3000= 48 000
c) vlera totale e pasurisë është 13 600 000 (5 milion+ 8 milion+ 600 000 )

**3 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a), b) dhe c);
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë vetëm njërën nga kërkesat;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 15** **3 pikë**

a) TC=TFC+TVC=(AFC*Q)+(AVC*Q)=(10*240)+(12*240)=5280 lekë
b) Firma realizon fitim sepse: Fitimi (∏)= TR-TC =(P*Q)-(ATC*Q)= (24*240)-(22*240)=5760-5280=480
c) Kostoja totale kur Q=0 është 2400, sepse për Q=0, TC=TFC

**3 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a), b) dhe c);
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë vetëm njërën nga kërkesat;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.





**Pyetja 16** **3 pikë**
a)
- çmim kërkuese,
- ofrojnë produkte të diferencuara.

b)
- lehtësia e hyrje-daljes në treg për konkurrencën monopolistike/vështirësia e hyrje daljes në treg për oligopolin (pengesa ekonomike, ligjore, etj.)
- numri i madh i firmave në treg për konkurrencën monopolistike/numri i vogël i firmave në treg për oligopolin.
- fuqia e vogël e firmave të konkurrencës së plotë/fuqia e madhe e firmave në oligopol.

**3 pikë** Nëse identifikon dy tipare të përbashkëta dhe një dallim;
**OSE**
**2 pikë** Nëse identifikon një tipar të përbashkët dhe një dallim **OSE** dy tipare të përbashkëta;
**1 pikë** Nëse identifikon një tipar të përbashkët **OSE** një dallim;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 17** **3 pikë**

- Shumë njerëz nuk do të mund të paguanin çmimet e shërbimit privat;
- Nëse një pjesë mundet të paguajë, do të bënin më shumë shpenzime me përfitime afatshkurtra, por që ky shërbim ua sjell në periudhë afatgjatë;
- Nga shërbimi publik do të përfitojë e gjithë shoqëria, jo vetëm një pjesë e saj.

**3 pikë** Nëse shkruan tre arsye;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy arsye;
**1 pikë** Nëse shkruan një arsye;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 18** **3 pikë**

Model përgjigjeje:
a) Papunësi friksionale
b) Papunësi strukturore
c) Papunësi friksionale

**3 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a), b) dhe c);
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë vetëm njërën nga kërkesat;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.





**Pyetja 19** **3 pikë**

a) nuk përfshihet
b) nuk përfshihet
c) përfshihet

**3 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a), b) dhe c);
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë vetëm njërën nga kërkesat;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 20** **3 pikë**

Model përgjigjeje:
a) politikë fiskale zgjeruese
b) politikë zgjeruese
c) politikë shtrënguese

**3 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet respektivisht për të tria kërkesat a), b) dhe c);
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan saktë përgjigjet për dy nga kërkesat;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë vetëm njërën nga kërkesat;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018
## SESIONI I

**SKEMA E VLERËSIMIT** **VARIANTI A**

### Lënda: Gjuhë Angleze (Niveli B2)

### READING SECTION

*For the open-ended questions, answers may be brief or may be written in full sentences. Accept either provided the information in the key is included. Do not take marks off for incorrect grammar or spelling in a longer answer. Do not accept answers which are too long and contain irrelevant information.*

| Questions | Answers | Points |
|---|---|---|
| 1 | C | 1 |
| 2a | Because he caught dengue fever. | 1 |
| 2b | - It stands for the dog / Smoky.<br>- Smoky / the dog | 1 |
| 3a | - Smoky would pick up the large cut-out letters in her mouth as Wynne called them out to her.<br>- She would pick out cut-out letters as Wynne called them out to her. | 1 |
| 3b | - There was a complete change when Smokey would enter the room; they all smiled.<br>- They would smile. / They smiled. | 1 |
| 4a | - The dog had a remarkable effect on the patient, completely changing his mental outlook.<br>- It completely changed his mental outlook.<br>- It changed his mental outlook. | 1 |
| 4b | - By volunteering their pets to serve as hospital dogs.<br>- They volunteered their pets to serve as hospital dogs. | 1 |
| 5 | A | 1 |
| 6 | C | 1 |
| 7a | Narrative | 1 |
| 7b | Descriptive | 1 |
| 8a | Expository | 1 |
| 8b | Narrative | 1 |
| 9a | Persuasive | 1 |
| 9b | Expository | 1 |
| 10 | B | 1 |





### USE OF LANGUAGE SECTION

| Questions | Answers | Points |
|---|---|---|
| 11 | B | 1 |
| 12 | C | 1 |
| 13 | A | 1 |
| 14 | D | 1 |
| 15 | B | 1 |
| 16 | C | 1 |
| 17a | unavoidable | 1 |
| 17b | existence | 1 |
| 17c | availability | 1 |
| 18a | Kate wanted to know if I had been in the concert on Saturday. | 1 |
| 18b | Due to bad weather, the game has been called off by the football association. | 1 |
| 18c | If the student hadn't missed the deadline, she would have been able to register for her courses. | 1 |
| 19a | the | 1 |
| 19b | by | 1 |
| 19c | so | 1 |
| 19d | it | 1 |

### WRITING SECTION

The writing section is scored out of a total of eight points. There are four criteria, each of which receives two points.
Candidates whose writing ability for a criterion is considered to be *below the minimum acceptable standard for B2 Leve*l receive **0 points** for that criterion.
Candidates whose writing ability is judged to be *at the minimum standard for B2* Level receive **1 point** for that criterion.
Candidates whose ability for a criterion is considered to be *above the minimum level for B2* receive **2 points** for that criterion.
The number of points for each criterion is added together to give a total score out of eight.

A successful student at minimum B2 level:

- ✓ Can write an essay or report which develops an argument, giving reasons in support of or against a particular point of view and explaining the advantages and disadvantages of various options.
- ✓ Can write clear, detailed descriptions on a variety of subjects related to his/her field of interest.
- ✓ Can write a review of a film, book or play.





**Writing Descriptors**

| Points | Description | Topic Development | Organization | Range | Accuracy |
|---|---|---|---|---|---|
| *0* | ***Below*** *minimum B2 level* | *Text is often irrelevant to the task.*<br>*Text is much too short.*<br>*The topic is not sufficiently developed and little or no supporting detail is provided.* | *Ideas are inadequately organized, which may cause confusion for the reader.*<br>*Only very simple connectors are used, e.g. and, but*<br>*There is no introduction and conclusion or they are not relevant.* | *A limited range of grammar and vocabulary is usually used in attempting to fulfil the task.* | *Frequent errors occur in both simple and complex structures, and often impede communication.*<br>*Vocabulary is sometimes used inappropriately.* |
| *1* | ***At*** *minimum B2 level* | *Text is mostly relevant to the task.*<br>*The topic is sufficiently developed, but without much supporting detail.* | *Ideas are usually adequately organized.*<br>*Linking devices are used, often appropriately.*<br>*There is an introduction and conclusion, but they may not be completely relevant.* | *A sufficient range of grammar and vocabulary is used in order to fulfil the task.* | *Errors only occasionally occur in basic structures, but may sometimes occur in more complex structures.*<br>*Vocabulary resources are often used appropriately.* |
| *2* | ***Above*** *minimum B2 level* | *Text is fully relevant to the task.*<br>*The topic is fully developed and has appropriate supporting details.* | *Ideas are clearly organized.*<br>*Linking devices are mostly used appropriately and effectively.*<br>*The introduction and conclusion are relevant and effective.* | *A broad range of grammatical structures and vocabulary is mostly used.* | *Errors mostly do not occur in basic structures.*<br>*Errors in more complex structures do not usually impede communication.*<br>*Vocabulary resources are usually used appropriately.* |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

## PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018
## SESIONI I

**SKEMA E VLERËSIMIT** **VARIANTI A**

### Lënda: Sociologji

**Udhëzime të përgjithshme**

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

***Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjespor që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

***Pyetjet me zgjedhje***

| Numri i Pyetjes | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përgjigja e saktë | B | A | C | A | D | D | A | C | B | D |

***Pyetjet me zhvillim***

**Pyetja 11** **3 pikë**

Model përgjigjeje:
- efekti hauthorne/ ndikimin e studiuesit në ndryshimin e modeleve të sjelljes së njerëzve që studiohen;
- veprimtaritë njerëzore janë të ndërlikuara/delikate, ndaj nuk mund të studiohen nëpërmjet eksperimenteve sociologjike;
- nuk përsëritet me të njëjtët njerëz në të njëjtën kohë dhe në kohë të ndryshme;
  - shembull: është absurde të provokosh luftë/konflikte/etj., për efekte studimi/çdokush do të fyhej nëse do të përfshihej në zënkë me dikë(apo arrestohej) për arsye eksperimentale;

**3 pikë** Nëse shkruan dy kufizime dhe një shembull;
**2 pikë** Nëse shkruan një kufizim dhe një shembull;
**1 pikë** Nëse shkruan një kufizim; **OSE**
**1 pikë** Nëse shkruan një shembull;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.





**Pyetja 12** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- të rinjtë janë më të prirur të formojnë grupe kundërkulturore;
- përpjekje e të rinjve për të provuar një jetë tjetër, rrënjësisht të ndryshme nga ajo e traditës; "hipitë" amerikane kundër vlerave individualiste/konkurruese/materialiste, kishin prirje altruiste, vlerësonin sinqeritetin (shpirtdëlirësinë) më shumë se pasurinë/braktisën shtresat e mesme dhe të larta të shoqërisë;
- zhvillojnë folkuej të tyre të veçantë;
- mënyra të veçanta të veshjes, (xhinse, kur ishin simbol i punëve të rëndomta), etika e sjelljes, dëfrimit, shijet artistike muzikore;
- më pak të ndikuar nga opinioni, etj.

**3 pikë** Nëse shkruan dy prirje dhe një shembull; **OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy prirje; **OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan një prirje dhe një shembull;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë vetëm një prirje; **OSE**
**1 pikë** Nëse shkruan saktë vetëm një shembull;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Njerëzit duan dhe aftësohen për njohjen e ideve të njëri- tjetrit. Kjo ndodh kur ata përpiqen të njohin qëllimet e të tjerëve. Secili kupton se një person tjetër mund të reagojë ndaj tij, duke imagjinuar veten në rolin e tjetrit.
- Duke përdorur simbolet në ndërveprimin shoqëror, njerëzit përgjithësisht e shohin veten sikurse të tjerët i shohin ata. Mid e quan këtë "marrje e rolit të tjetrit", "vënie në rolin e tjetrit".
- Kulej e krahason shoqërinë me në pasqyrë, në të cilën ne jemi të aftë të përfytyrojmë veten sipas asaj se si të tjerët kundërpërgjigjen ndaj nesh. Ai përdorte shprehjen "pasqyrë e vetes", duke kuptuar veten si të përcaktuar nga reagimet e të tjerëve. Të tjerët shërbejnë si pasqyrë ku çdo individ sheh veten të vendosur në role të të tjerëve. Kjo ndodh në procesin ndërveprimit shoqëror.
- Kulej dhe Mid shprehen se aftësia për të marrë role të të tjerëve bazohet në përdorimin e simboleve dhe është themeli i vetes shoqërore dhe i përvojës shoqërore të çdo individi.

**3 pikë** Nëse shkruan tre faktorë ;
**2 pikë** Nëse shkruan dy faktorë;
**1 pikë** Nëse shkruan një faktor;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 14** **4 pikë**

Model përgjigjeje:

a) Kuptimi relativ i sjelljeve deviante ose jo, ka limite. Ata janë herë të dukshëm e herë të padukshëm. Sjelljet deviante ndikojnë në qartësimin e këtyre kufijve.
-shembull: lejimi me një masë të caktuar i pijeve alkoolike në lokal. Kur kalohet masa e përdorimit të tij, sjellja e individit bëhet deviante, duke shqetësuar të tjerët, të cilët kundërshtojnë në mënyra të ndryshme. Këto sjellje kundërshtuese u mësojnë anëtarëve të shoqërisë kufijtë e të moralshmes dhe të pamoralshmes në një kohë të caktuar.
b) Shumica përjetojnë ndjenja zemërate (njerëzit e vetëdijshëm të shoqërisë) për sjelljet deviante, sidomos ato të rënda duke u bërë gjithnjë e më të vetëdijshëm për normat dhe vlerat kulturore që i bashkojnë.

-shembull: Në shoqëritë me popullsi të përzier, për sjelljet deviante të njerëzve nga e njëjta kombësi emigrantët bashkohen për të përballur së bashku vështirësitë e jetës në vend të huaj. Rilindësit shqiptarë reagonin ndaj çdo veprimi të politikanëve që shmangej sadopak nga interesi i Lëvizjes Kombëtare, duke forcuar unitetin e të gjithë shqiptarëve.

**4 pikë** Nëse shkruan nga një tipar dhe nga shembull për secilin funksion;
**3 pikë** Nëse shkruan nga një tipar për secilin funksion dhe një shembull për tjetrin **OSE** nëse shkruan nga një shembull për secilin funksion dhe një tipar për tjetrin;
**2 pikë** Nëse shkruan nga një tipar për secilin funksion **OSE** nëse shkruan nga një shembull për secilin funksion;
**1 pikë** Nëse shkruan një tipar për njërin funksion **OSE** nëse shkruan një shembull për njërin funksion;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 15** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Deri para Luftës së Dytë Botërore ishte e lejuar.
- Ndodhte zakonisht në burrat e pasur.
- Nuk pritej mirë nga shumica e shoqërisë.
- Justifikohej me dëshirën për lindjen e shumë fëmijëve, sidomos djem./kjo sidomos në shoqëritë fshatare).
- Çdo familje matej e mbrohej me numrin e meshkujve.
- Në këtë "klimë" psikokulturore, gruaja që nuk lindte fëmijë, ishte e detyruar të divorcohej ose të pranonte gruan e dytë të burrit të saj./ Zakonisht kjo ndodhte, jo divorci.
- Më pas, gruaja e parë fitonte një status tjetër më të nderuar në familjen e burrit.
- Çlirohej nga disa punë të rëndomta, administronte punët e shtëpisë dhe edukimin e fëmijëve etj.

**3 pikë** Nëse shkruan tre aspekte;
**2 pikë** Nëse shkruan dy aspekte;
**OSE**
**1 pikë** Nëse shkruan një aspekt;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 16** **4 pikë**

Model përgjigjeje:

a)

- marrëdhëniet ndërmjet shtetit të shumicës së popullsisë dhe shtetit "amë" të pakicave kombëtare ose grupeve etnike.
- Këto marrëdhënie janë më vepruese, sidomos kur shtete të tilla, përgjithësisht të ndërlikuar, veprojnë në dy kahe. Nga njëra anë, ato veprojnë në marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave kombëtare ose etnike. Nga ana tjetër, mënyra e trajtimit të pakicave përcakton, në një masë të ndjeshme, marrëdhëniet ndërmjet shteteve të tilla. Shkalla dhe kahu i këtyre ndikimeve ndryshojnë dukshëm kohë pas kohe.

b)

- veçoritë e formimit psikokulturor të popullsisë që përbën shumicën etnike. Përgjithësisht, formimi psikokulturor i popujve ndryshon me ngadalësi. Ndaj, një faktor i tillë është ndoshta kryesor për ecurinë e marrëdhënieve ndërmjet grupimeve etnike në shumicë dhe pakicë.

**4 pikë** Nëse shpjegon nga dy elemente të secilit faktor;
**3 pikë** Nëse shpjegon një element nga njëri faktor dhe dy elemente nga tjetri;
**2 pikë** Nëse shpjegon një element nga njëri faktor dhe një element nga tjetri;
**1 pikë** Nëse shpjegon një element vetëm nga njëri faktor;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare





**Pyetja 17** **2 pikë**

Në Shqipëri procesi i shekullarizimit ka përshkruar të gjitha organizatat fetare, sidomos pas shpalljes së Pavarësisë. Regjimi i Ahmet Zogut i nxiti prirjet shekullarizuese si rrjedhojë e bashkërendimit të dy pikësynimeve kryesore:

a) masivizimi i vrullshëm i arsimit, përmirësimi i shpejtë i nivelit arsimor të masave popullore, rritja e numrit të specialistëve me arsim të lartë në strukturën e popullsisë. Nga përvoja e vendeve të Perëndimit, zhvillime të tilla nxitin proceset shekullarizuese.
b) masat e shumanshme e të përshkallëzuara të partisë-shtet e të organizatave të masave për të çrrënjosur besimet fetare, për të krijuar një shoqëri ateiste. Në vitin 1967 në Shqipëri u ndalua edhe nga organet shtetërore ushtrimi i besimeve dhe i praktikave fetare. Rrethana të tilla deri në vitin 1990 domosdoshmërish diktuan te shqiptarët, sidomos te rinia, një lloj "ateizmi" të detyruar.

Nxënësi fiton:

**2 pikë** Nëse shkruan dy prirje;
**1 pikë** Nëse shkruan një prirje;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 18** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Shumica e veprimtarive ekonomike regjistrohen dhe tatohen nga organet shtetërore përkatëse. Krahas këtyre, funksionon edhe ekonomia e paligjshme, e cila përfshin të gjitha veprimtaritë ekonomike që sigurojnë të ardhura, por që nuk janë të regjistruara në organet shtetërore të taksimit.
- Veprimtaritë ekonomike joligjore janë të shumta: shitja e lëngjeve/ paketa cigaresh/ banane, etj,. nga fëmijët para shtëpisë /deri te puna e pataksuar jashtë orarit e mjekut, e marangozit, rrobaqepësit, etj./ Të padeklaruara janë edhe të ardhurat nga bakshishi që marrin kamerierët ose ryshfeti që marrin nëpunësit, të ardhura nga vjedhja / tregtia e lëndëve narkotike, etj.
- Është e vështirë të përcaktohen "përmasat" e ekonomisë jo ligjore. Në ShBA llogaritej gati 10% e gjithë veprimtarisë së paligjshme në fund të shek. XX dhe në fillim të shekullit XXI.

- Për vendet që janë në periudhën kalimtare, siç është vendi ynë, pesha specifike e ekonomisë joligjore është përgjithësisht e lartë.
- Një nga shkaqet e kësaj gjendjeje është edhe prirja e shumë njerëzve për t'u pasuruar shpejt nëpërmjet rrugëve të kundërligjshme, nga mungesa e përvojës së organeve shtetërore për kontrollimin dhe taksimin e veprimtarive të ndryshme ekonomike, etj.

**3 pikë** Nëse shkruan tre tipare;
**2 pikë** Nëse shkruan dy tipare;
**1 pikë** Nëse shkruan një tipar;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 19** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Pas suksesit në plotësimin e qëllimeve të saj, ajo nuk ka arsye të vazhdojë.
- Mund të dështojë nga udhëheqja e paaftë e saj/nga përçarja dhe konfliktimi i pjesëmarrësve në të, si pasojë e ndryshimit të interesimit të tyre për lëvizjen në rrjedhën e zhvillimit të saj
- Nëse udhëheqësit korruptohen nga organet shtetërore në fuqi, të cilat mund t'u ofrojnë atyre shpërblime (para, poste, etj). Këta udhëheqës sigurojnë përfitime të shumanshme, kur braktisin qëllimet kryesore të lëvizjes.
- Trysnia e masave kufizuese dhe të dhunës që mund të ushtrojnë ndaj tyre organet shtetërore, të cilat mbrojnë interesat e klasës në fuqi. (Një pjesë humbin vrullin kundërshtues ndaj sistemit shoqëror në fuqi pasi plotësojnë një pjesë të kërkesave të rëndësishme.)

**3 pikë** Nëse shkruan tre arsye;
**2 pikë** Nëse shkruan dy arsye;
**1 pikë** Nëse shkruan një arsye;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.





**Pyetja 20** **2 pikë**

Model përgjigjeje:

- Modernizmi u premtoi njerëzve një jetë të çliruar nga mungesat.
- Shekulli i XX konsiderohet i pasuksesshëm në përpjekjet për zgjidhjen e problemeve shoqërore, si varfëria për një numër të madh njerëzish, mungesa e sigurimit financiar për shumë të tjerë, etj.

- shembull: Nga ana tjetër, ka vlerësim pozitiv për mosdështim të plotë të modernitetit. Në vende si SHBA dhe të tjerë me industri të zhvilluar, ka rritje të ndjeshme të nivelit të jetesës dhe jetëgjatësisë mesatare.

**2 pikë** Nëse shkruan një argument për dështim dhe një shembull për të kundërtën;
**1 pikë** Nëse shkruan një argument për dështim **OSE** nëse shkruan një shembull për të kundërtën;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.



MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 201**
**SESIONI I**

**SKEMA E VLERËSIMIT**

**Lënda: Filozofi**

**Udhëzime tëpërgjithshme**

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

***Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

***Pyetjet me zgjedhje***

| Numri i Pyetjes | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përgjigja e saktë | B | A | A | D | A | A | A | C | B | A |

***Pyetjet me zhvillim***

**Pyetja 11** **3 pikë**

- Ndryshe nga sofistët, Sokrati merret me thelbin e njeriut.
- Ky thelb është shpirti, ndërgjegjja dhe personaliteti intelektual dhe moral.
- Të kujdesesh për veten do të thotë të kujdesesh për shpirtin, ndaj virtyti i njeriut është ai që e bën shpirtin të mirë dhe të përsosur. /Për këtë qëllim shërben kërkimi, dija, shkenca dhe vetëm nëpërmjet tyre njeriu arrin të mirën.
- Nëse virtyti është dije, vesi është padije.
- Përfundimi i tezës sokratike është se njerëzit nuk bëjnë keq në mënyrë të vullnetshme, por nga padija, sepse nuk e njohin të mirën.
- Njohja e së vërtetës, pra e së mirës si synim dhe kuptim i jetës, është edhe kusht që njerëzit të sillen në përputhje me të, pra të jenë të virtytshëm.
- E mira është përmbajtja e atij virtyti themelor që e udhëheq njeriun drejt jetës së urtë, të mençur, të matur e të vetëdijshme.
- Ky kuptim mbi virtytin sillte një përmbysje të vlerave tradicionale të shoqërisë greke.
- Vlera të vërteta nuk janë ato të lidhura me gjëra të jashtme, si: fama, pasuria, bukuria, por vlerat e shpirtit, të përmbledhura te dija.





- Risi në filozofinë e Sokratit ishte lidhja e virtytit me të mirën; shtron për herë të parë raportin e të vërtetës dhe jetës, dijes dhe ekzistencës.
- Filozofia bëhet ushqim shpirtëror, e aftë të prodhojë sjellje të virtytshme.

**3 pikë** Nëse shkruan saktë tre shpjegime;
**2 pikë** Nëse shkruan saktë dy shpjegime;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë një shpjegim;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Epoka perandorake përfshin shek. I p.e.s deri në shek IV e. s. Nga shek. II p.e.s., me pushtimet romake në Mesdhe, procesi i përthithjes së kulturës greke në botën romake u bë i pakthyeshëm.
- Në 146 p.e.s. Greqia u kthye në një provincë romake. /Në Romë nisi të kultivohej filozofia greke, e cila gradualisht u shndërrua në një element të kulturës romake, duke iu përshtatur mendësisë romake e problematikës së kohës.
- Tipar kryesor i filozofisë së periudhës perandorake ishte qëllimi i saj praktik: propagandimi i një ideali jete që i shërben individit, ndaj interesi për etikën, "artin e të jetuarit", bëhet mbizotërues.
- I gjendur në hapësirën e stërmadhe të perandorisë, me lidhje të dobëta me shtetin dhe shoqërinë, individi mbyllet në brendësinë e ndërgjegjes së vet. /Aty kërkon përsosjen dhe shpëtimin.
- Idetë e stoicizmit të lindura në këtë periudhë, bëhen shprehëse të këtyre nevojave shpirtërore.
- Stoicizmi romak, që njihet edhe si neostoicizmi, pati shumë admirues.

**3 pikë** Nëse shkruan saktë tre veçori;
**2 pikë** Nëse shkruan saktë dy veçori;
**1 pikë** Nëse shkruan saktë një veçori;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Themelues i skepticizmit është Pirroni. Ai nuk la gjë të shkruar, por dëshmohet vetëm nëpërmjet të tjerëve.
- Sipas Pirronit, gjërat janë "të papërcaktueshme, të padallueshme e të pamatshme".
- Nuk ekzistojnë në mënyrë absolute gjëra të bukura apo të shëmtuara, të vërteta apo të rreme, të mira apo të këqija nga natyra e tyre, por janë zakonet, besimet, vendimet e njerëzve që i bëjnë ato të tilla.
- Përtej këtyre besimeve e marrëveshjeve lidhur me gjërat, të cilat shfaqen vazhdimisht të lëvizshme e të ndryshueshme, është i pamundur gjykimi apo vlerësimi.
- Derisa realiteti në vetvete rezulton i pakapshëm, i errët, i pakuptueshëm, i vetmi qëndrim i drejtë për njeriun, është heqja dorë nga çdo gjykim: *afasia, mungesa e të folurit, e të shprehurit.*
- Nuk ka asnjë kriter të vlefshëm, as nëpërmjet ndijimeve dhe as nëpërmjet intelektit, për të gjykuar mbi të mirën ose vlefshmërinë e një veprimi në krahasim me një tjetër. I urti e ka zemrën e paqme dhe arrin ataraksinë, mungesën e turbullimit dhe paqen e brendshme, pasi ka kuptuar se nuk ekziston.





- E Vërteta me germë të madhe, mbi thelbin e qenien e vërtetë të gjërave, nuk mund të thuhet me asnjë siguri. "I urti i sheh me kryelartësi, madje me njëfarë mëshire rivalët dogmatikë që ndeshen midis tyre me "luftë fjalësh" për çështje mbi të cilat, në fakt, nuk mund të japësh gjykim".

**3 pikë** Nëse shkruan nga dy elemente për njërin koncept dhe një element për tjetrin;
**2 pikë** Nëse shkruan dy elemente për njërin koncept;
**2 pikë** Nëse shkruan nga një element për secilin koncept;
**1 pikë** Nëse shkruan një element vetëm për njërin koncept;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 14** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

a) Rilindja iu kthye së kaluarës:

- për të rizbuluar vlerat kulturore të shkrimtarëve të lashtë. Ky kthim synonte kërkimin e dorëshkrimeve, rizbulimin e gjuhëve të harruara, por edhe zhvillimin e një fryme kritike ndaj këtyre teksteve. U shfaqën humanistët, që ishin profesorë të gramatikës të cilët mësonin dhe "letërsinë e bukur".
- humanisti ndjen se po sjell diçka të re./ Ai e sheh botën si një Adam i ri, me ëndrrën të jetë një Promete i ri, /pa paragjykime dhe i çliruar nga çdo autoritet. Me këtë liri shpirtërore rilindësit realizuan shqyrtimin kritik të sistemeve të mëdha teologjike dhe filozofike të Mesjetës, deri në vënien në diskutim të interpretimeve tradicionale për kozmosin nga Aristoteli.

b)

- Rilindësit e vlerësonin këtë në kuadrin e një perspektive të re: njeriun. /Ata synonin t'i bënin idetë e tyre sa më njerëzore. Këto ide duhet t'i shërbenin sa më shumë njeriut.
- Shpirti njerëzor nga rilindësit kuptohej si tipar i bashkimit të së fundmes me pafundësinë, /i së vërtetës me të përjetshmen. Në sajë të këtij shpirti, mikrokozmosi i trupit tonë hyn në lidhje harmonike me universin e madh që quhet " makrokozmos".
- Ajo që garanton dinjitetin njerëzor është ushtrimi i lirisë.
- Dinjiteti i njeriut qëndron në fuqinë krijuese të tij, që ka në vetvete mundësi të pafundme rigjallëruese.

**3 pikë** Nëse shkruan frymën kritike dhe dy ide;
**2 pikë** Nëse shkruan dy ide; OSE
**2 pikë** Nëse shkruan frymën kritike dhe një ide;
**1 pikë** Nëse shkruan frymën kritike; OSE
**1 pikë** Nëse shkruan një ide;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 15** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Duke pranuar ndarjen aristoteliane të intelektit të mundshëm dhe veprues,
- Intelekti veprues, duke pasur origjinë hyjnore, konsiderohet i njëjtë dhe i pavdekshëm për të gjithë njerëzit.
- Hedh idenë se edhe intelekti i mundshëm është i pavdekshëm dhe i njëjtë për të gjithë. Në bazë të tij njihen dhe formulohen idetë e përgjithshme, të njëjta për këdo,
- Intelekti i mundshëm nuk mund të jetë individual ( i lidhur me trupin e veçantë, si formë e tij).





- Problemi që shtrohet është kur themi se njohja është individuale dhe si arrin individi i veçantë të njohë.
- Për të shpjeguar individualitetin e njohjes, Averroesi thekson origjinën shqisore të procesit njohës njerëzor.
- Ky perceptim shqisor, prej ku njerëzit abstragojnë idetë e përgjithshme, duke qenë i lidhur me fantazinë dhe përfytyrimet, ndryshon nga njëri person te tjetri dhe kjo prodhon veçantinë e njohjes.
- Idetë e përgjithshme ekzistojnë si mundësi në intelektin e mundshëm.
- Detyra kryesore e pjesës tjetër të intelekti, atij veprues, është të realizojë abstragimin, t'i bëjë idetë e përgjithshme të njohshme dhe të kapshme. /Ashtu si drita e diellit ndriçon errësirën e bën të mundshëm shikimin, kështu edhe intelekti aktiv bën të njihen idetë e përgjithshme. /Pra, akti i të kuptuarit është individual për sa është i lidhur me fantazinë dhe përfytyrimet shqisore, por është edhe jo individual për sa idetë e përgjithshme janë të njëjta dhe të përbashkëta. /Ato nuk mund të jenë të ndryshme për çdo individ.
- Përderisa intelekti i mundshëm nuk është pjesë e shpirtit njerëzor, por vetëm i lidhur përkohësisht me të, atëherë i vdekshëm është individi i veçantë, jo ky realitet tej individual.
- Ky përfundim binte në kundërshtim me një nga çështjet kyç të fesë së krishterë: atë të pavdekësisë individuale. Danteja, duke e dënuar Averroesin për përfundimet e tij ( ndonëse e vlerësonte për rolin e rëndësishëm si komentator i Aristotelit), e rreshton në kategorinë e atyre që " bën të vdesë shpirti bashkë me trupin".

**3 pikë** Nëse shkruan tre elemente;
**2 pikë** Nëse shkruan dy elemente;
**1 pikë** Nëse shkruan një element;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 16** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Njeriu është njëkohësisht shpirt dhe trup, pra: substancë menduese dhe substancë e shtrirë që i bindet ligjeve të natyrës.
- Shpirti njeh më lehtë se trupi.
- Njohja shqisore është dytësore, prandaj për të njohur duhet të bazohemi te shpirti:/ p.sh., një copë dylli e ngurtë, kur ngrohet shkrin dhe mund të marrë forma të ndryshme. Shqisat e mia (perceptimi) më tregojnë se kjo copë dylli ka ndryshuar gjendje, ajo ka shkrirë. /Por shpirti im më tregon se materiali amorf është nga e njëjta copë dylli./ Shpirti im dhe jo shqisat më tregojnë përhershmërinë.

**3 pikë** Nëse përshkruan tre elemente për sistemin;
**2 pikë** Nëse përshkruan dy elemente për sistemin;
**1 pikë** Nëse përshkruan një element sistemin;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 17** **3 pikë**

Model përgjigjeje

a)

- Hobsi mendon se shteti del nga një kontratë shoqërore, përmes së cilës çdo njeri ia kalon të drejtën e tij natyrore shtetit, me qëllim që të garantojë paqen dhe sigurinë.
- Në këtë kontratë, çdo individ i kalon këto të drejta në mënyrë absolute, me kusht që edhe të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë.
- Përmes kësaj kontrate shoqërore, subjektet angazhohen ndaj njëri-tjetrit dhe bëhen një popull.





b)

- Te Hobsi, sovrani është absolut / sovrani qëndron mbi kontratën, /ai nuk i nënshtrohet asaj.
- Forca e pushtetit qëndron te bindja e subjekteve ndaj tij.
- Nëse populli nuk i bindet, atëherë bie qëllimi për të cilin është hartuar kontrata.

**3 pikë** Nëse shkruan dy ide për kontratën dhe një për sovranin; **OSE**
**3 pikë** Nëse shkruan dy ide për sovranin dhe një për kontratën;
**2 pikë** Nëse shkruan dy ide për kontratën; **OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy ide për sovranin;
**1 pikë** Nëse shkruan një ide për kontratën; **OSE**
**1 pikë** Nëse shkruan një ide për sovranin;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 18** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Nihilizmi i Niçes shfaqet edhe në idenë e tij për vdekjen e Zotit. Zoti ka vdekur, por ekziston akoma hija e tij që kërkon viktima. /Kjo shfaqet te punimi i tij "Kështu foli Zarathustra".
- Tek "Antikrishti" shprehet ideja tjetër, se të gjitha spekulimet metafizike dhe fetare mund të shpjegohen lehtas në mënyrë psikologjike, sepse kanë shërbyer për të përligjur një moral të caktuar.
- Niçja nuk e pranonte krishterimin, sepse, sipas tij, kishte një pjesë thelbësore që e prish njeriun dhe ishte bërë një relikte e pabesueshme dogmatike.
- Duke predikuar ndjenjën e mëshirës, krishterimi u imponohet të gjithë njerëzve pa përjashtim, aq sa të fortëve dhe të pasurve u vjen keq për shëndetin dhe pasurinë e tyre dhe fillojnë e kërkojnë arsye për shfajësime përse janë të tillë.
- Duket se kjo fe i pengon njerëzit të zhvillohen dhe se të fortët nuk duhet të jenë të tillë, por të bëhen të dobët. /Por kjo bie ndesh me vetë jetën dhe rritjen e saj, sipas Niçes.
- Meqë të gjitha perënditë kanë vdekur, tani duhet të jetojë e të besohet mbinjeriu. Niçja shprehet: Unë nuk jam ateist si rezultat i diçkaje dhe prej shtytjes për diçka. Ateizmi te unë vjen nga instikti. Unë jam tepër kureshtar dhe plot me pyetje për botën, për t'u kënaqur me gënjeshtra të trasha. Zoti është një gënjeshtër e tillë, një gjë aspak e hollë për mendimin tonë. Ai përmban vetëm një ndalim për ne që mendojmë, ai na thotë: "Ju s'duhet të mendoni".

**3 pikë** Nëse shkruan tre aspekte;
**OSE**
**2 pikë** Nëse shkruan dy aspekte;
**1 pikë** Nëse shkruan një aspekt;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 19** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Duke qenë besnik ndaj parimit utilitarist, Milli e konsideronte dobinë si kriterin e vlerave morale: /veprimi që kontribuon në lumturinë e një numri të madh njerëzish është i mirë dhe/ lumturia tregon kënaqësinë dhe mungesën e vuajtjes.





- Milli mendon ta vlerësojë kënaqësinë jo vetëm nga sasia e saj, por edhe cilësia e saj. /Sipas tij ka dy tipa kënaqësish: të larta dhe të ulëta.
- Kënaqësitë që burojnë nga aftësitë e larta të individit (aftësitë e shpirtit) janë cilësi të larta./ Kënaqësitë e trupi (mishtore), janë cilësi të ulëta. /Këto të fundit mjaftohen me një bazë kënaqësie, ndërsa kënaqësitë e cilësive të larta janë burim lumturie dhe i një jete të denjë.
- Nuk është interesi personal i çdo individi ai që duhet kërkuar më së pari, por interesi i përgjithshëm.
- Milli zhvillon një utilitarizëm altruist, që e konsideron përkushtimin e individit ndaj lumturisë së tjetrit si virtytin më të lartë.
- Ai shikon tek edukimi dhe shoqatat mënyrën më të mirë për të zhvilluar tek çdo njeri shqetësimin për drejtësi.
- Rregulli i artë i utilitarizmit të Millit mund të interpretohet si rregulli i artë i Jezuit: duaje tjetrin siç do veten tënde, po pa asnjë kontradiktë, përkundrazi, ky rregull përsos idealin e utilitarizmit.

**3 pikë** Nëse shkruan tre elemente;
**2 pikë** Nëse shkruan dy elemente;
**1 pikë** Nëse shkruan një elemente;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 20** **3 pikë**

Model përgjigjeje:

a) Teza themelore e Hegelit është: Çdo gjë reale është racionale dhe çdo gjë që është racionale është reale
b)
  - Racionalja te Hegeli është thelbi i vetë realitetit, parim i përhershëm për gjërat.
  - Realja nuk është irracionale, e paarsyeshme. /Kjo do të thotë se ne mund të njohim gjithçka.
  - Hegeli pranon se filozofia është arritja e së vërtetës në karakteterin e saj absolut.
  - E vërteta, absolutja, nuk është e pakapshme.
  - Ideja është ajo që realizohet te faktet, dhe jo diçka që u kundërvihet atyre, sikurse e mendonte tradita platonike që ndante botën e ideve nga bota shqisore, e dukjeve, e fenomeneve.

**3 pikë** Nëse shkruan tezën dhe dy shpjegime;
**2 pikë** Nëse shkruan dy shpjegime; OSE
**2 pikë** Nëse shkruan tezën dhe një shpjegim;
**1 pikë** Nëse shkruan një shpjegim; OSE
**1 pikë** Nëse shkruan tezën;
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.



MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

**PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018**
**SESIONI I**

**ZGJIDHJE**

**Lënda: Biologji bërthamë** **Varianti A**

- ***Pyetjet me zgjedhje***

| Numri i ushtrimit | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Alternativa e saktë | A | D | B | A | D | C | A | A | D | D |

- ***Pyetjet me kërkesa me zgjidhje dhe arsyetim***

**Ushtrimi 11**

**Kërkesa a**

CGA AAC AAT GAA ATG CCG

Vargu përplotësues është:

GCT TTG TTA CTT TAC GGC

**Kërkesa b**

Kemi 10 çifte A dhe T me nga 2 lidhje hidrogjenore, pra 10 x 2 = 20 lidhje hidrogjenore.

Kemi 8 çifte G dhe C me nga 3 lidhje hidrogjenore, pra 8 x 3 = 24 lidhje hidrogjenore.

Totali i lidhjeve hidrogjenore 20 + 24 = 44

**Ushtrimi 12**

**Kërkesa a**

Prodhuesit janë gjallesa autotrofe që e sintetizojnë vetë lëndën organike, me të cilën ushqehen vetë dhe gjallesat heterotrofe.

**Kërkesa b**

Rrjetat ushqimore formohen nga ndërthurja e zinxhirëve ushqimorë, gjë që tregon se disa gjallesa marrin pjesë njëkohësisht në më shumë se një zinxhir ushqimor.

©QSHA 1 20 qershor, 2018

Zgjidhje Biologji bërthamë Varianti A

**Ushtrimi 13**

**Mënyra e parë**

a) Prindërit: ♀ rrTt x ♂ Rrtt

b)

| ♀/♂ | rT | rt |
|---|---|---|
| Rt | **RrTt** | Rrtt |
| rt | rrTt | **rrtt** |

c) Mundësia e lindjes së pasardhësve fenotipikisht dominant është 1/4 ose 25%.

d) Mundësia e lindjes së pasardhësve reçesivë për të dy tiparet është 1/4 ose 25%.

**Mënyra e dytë**

P: ♀ rr x ♂ Rr

| ♀/♂ | r |
|---|---|
| R | **Rr** |
| r | **rr** |

P: ♀ Tt x ♂ tt

| ♀/♂ | T | t |
|---|---|---|
| t | **Tt** | **tt** |

Mundësia e lindjes së pasardhësve fenotipikisht dominantështë: 1/2 x 1/2= 1/4 ose 25%.

Mundësia e lindjes së pasardhësve reçesivë për të dy tiparet është1/2 x 1/2= 1/4 ose 25%.

**Ushtrimi 14**

Prindërit: ♀ $X^DX^d$ x ♂ $X^dY$

Rrjeta Pennet

| ♀/♂ | $X^D$ | $X^d$ |
|---|---|---|
| $X^d$ | **$X^DX^d$** | $X^dX^d$ |
| Y | **$X^DY$** | $X^dY$ |

Mundësia që nga ky çift të lindin fëmijë daltonikë është **50%** ose **1/2.**

Ose 50% (1/2) e vajzave dhe 50% (1/2) e djemve.

©QSHA 2 20 qershor, 2018

Zgjidhje Biologji bërthamë Varianti A

**Ushtrimi 15**

**Kërkesa a**

Përshtatjet e përkohshme te gjallesat shfaqen vetëm në rrethana të caktuara mjedisore, për t'u zhdukur më pas kur shkaqet që i kanë provokuar janë kapërcyer. Pra këto lloj përshtatjesh nuk janë të trashëgueshme.

**Kërkesa b**

Në lartësi të mëdha mbi nivelin e detit, sasia e ajrit dhe e oksigjenit zvogëlohet.Në këtë mjedis te individët shfaqet përshtatja e përkohshme, pra rritja e numrit të rruazave të kuqe të gjakut(rritet sasia e hemoglobinës që transporton oksigjenin).Fëmijët e një individi që ka jetuar disa vite në zonat malore nuk trashëgojnë një numur të madh të rruazave të kuqe të gjakut.

**Ushtrimi 16**

**Kërkesa a**

- Lëkura reagon ndaj të nxehtit duke zgjeruar enët e gjakut dhe duke aktivizuar gjendrat e djersës. Këto reagime të lëkurës shoqërohen me uljen e temperaturës së trupit.
- Lëkura reagon ndaj të ftohtit duke ngushtuar enët e gjakut për të reduktuar humbjen e nxehtësisë trupore. Gjithashtu të ftohtit nxit dhe dridhjen e muskujve, gjë që siguron energji.

**Kërkesa b**

Lëkura quhet organ ekskretimi sepse gjendrat e djersës sekretojnë djersën e cila përmban mbetje të metabolizmit (kripë, lëndë të azotuara etj).

**Ushtrimi 17**

**Kërkesa a**

Funksioni transportues i gjakut.

Me anën e gjakut transportohen lëndët ushqimore, gazet $O_2$ dhe $CO_2$, hormonet, nxehtësia etj.

Funksioni mbrojtës i gjakut.

Në sajë të fagocitozës dhe krijimit të kundërtrupave, rruazat e bardha krijojnë mbrojtje të fuqishme ndaj agjentëve mikrobikë dhe prodhimeve të tyre.

**Kërkesa b**

Muskulatura e barkushes së majtë është më e zhvilluar se muskulatura e barkushes së djathtë, sepse pompon gjakun me forcë më të madhe për një rrugë më të gjatë, për tu shpërndarë në të gjitha indet dhe organet e trupit.

©QSHA 3 20 qershor, 2018

Zgjidhje Biologji bërthamë Varianti A

**Ushtrimi 18**

**Kërkesa a**

Gjatë frymëmarrjes mushkërore oksigjeni kalon nga atmosfera në hojëzat (alveolat) e mushkërive me difuzion.

Ky oksigjen do të shkojë me anë të gjakut në të gjitha qelizat e trupit ku do të zhvillohet frymëmarrja qelizore (djegja e glukozës në prani të oksigjenit). Si rezultat do të çlirohet energji për kryerjen e proceseve jetësore.

**Kërkesa b**

Gjatë kalimit të ushqimi në faring, vetë pesha e ushqimit ul epiglotën gjatë gëlltitjes, gjë që çon në mbylljen e rrugëve të ajrit.

Nëse flasim kur jemi duke ngrënë ushqimin rrugët e ajrit janë të hapura dhe mund të kalojë ushqimi në to.

**Ushtrimi 19**

**Kërkesa a**

Ureteret janë gypa që transportojnë urinën nga veshkat te fshikëza urinare.

Uretra është gypi që transporton urinën nga fshikëza urinare në mjedis.

**Kërkesa b**

-Procesi që zhvillohet gjatë filtrimit të plazmës së gjakut quhet difuzion.

-Filtrimi bëhet në sajë të ndryshimit të trysnisë ndërmjet gjakut kapilar dhe ultrafiltratit të kapsulës së Baumanit.

Lëndët që ndodhen në plazmën e gjakut kalojnë nga përqëndrimi më i madh në glomerulë te përqëndrimi më i vogël në kapsulën e Baumanit.

**Ushtrimi 20**

**Kërkesa a**

Neuronet ndijore tejçojnë nxitjen nervore nga receptorët drejt sistemit nervor qendror.

**Kërkesa b**

Neuronet lëvizore tejçojnë nxitjen nervore nga sistemit nervor qendror drejt organeve vepruese, që mund të jenë muskujt ose gjendrat.

**Kërkesa c**

Sistemi nervor simpatik përshpejton punën e organeve, sistemi nervor parasimpatik ngadalëson punën e organeve.

©QSHA 4 20 qershor, 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2018

### SESIONI I

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT – ORIENTUESE

**Lënda: Letërsi e thelluar** **VARIANTI A**

## PJESA I

**Kadare** ***E penguara***

**Pyetja 1** **B** **1 pikë**
**Pyetja 2** **D** **1 pikë**
**Pyetja 3** **D** **1 pikë**
**Pyetja 4** **C** **1 pikë**
**Pyetja 5** **C** **1 pikë**

**Pyetja 6** **3 pikë**

- **Gjendja shpirtërore e Migenës:**
  - e tronditur, me ndjenjën e fajit;
  - e trishtuar për fatin e Lindës;
  - e habitur me fjalët e Lindës;
  - e prekur nga situata.
- **Figurat letrare:**
  **Epitete** Tango kaq ***e pafundme***
  **Epitete, inversion** E fundmja shpresë; të vetmin gëzim që kisha;
  **Metaforë**: pa e çliruar ndërgjegjen nga ndjesia e mëkatit;
  **Enumeracion/shkallëzim**: sqarimin e vështirë, atë që lidhej me ty, brengën që mund t'i shkaktoja, e pabesë

**1 pikë** Nëse gjen gjendjen shpirtërore që po përjeton Migena.

**DHE**

**2 pikë** Nëse identifikon dy figura letrare, bashkë me ilustrimet përkatëse.

**OSE**

© QSHA 1 20 qershor 2018

Skemë vlerësimi Letërsi e thelluar Varianti A

**1 pikë** Nëse identifikon një figurë letrare, bashkë me ilustrimin përkatës.

**0 pikë** Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

***Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

**Pyetja 7** **2 pikë**

- **Hapësirat:**
  - provinca
  - kryeqyteti

**2 pikë** Nëse identifikon dy hapësirat ku zhvillohen ngjarjet.

**OSE**

**1 pikë** Nëse identifikon vetëm një nga hapësirat.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 8** **3 pikë**

- **Simbolika**
  - Kryeqyteti vjen si mjedis i zhvillimit kulturor dhe si ëndërr e personazhit për t'u lidhur me të, përmes të gjitha formave.
  - Provinca nënkupton pengesën, mohimin. Është mjedisi i harrimit, ndrydhjes, veçimit prej të gjithëve. Këtej vjen edhe titulli i romanit.
- **Raporti**
  - Janë mjedise të kundërt me njëri – tjetrin; i pari i jep kuptim jetës së personazhit, i dyti e çon drejt vetmisë së detyruar.
  - Raportet janë të kundërshtisë.

**2 pikë** Nëse zbulon simbolikën e të dy hapësirave.

**OSE**

**1 pikë** Nëse zbulon simbolikën e një prej hapësirave.

**DHE**

**1 pikë** Nëse tregon raportin që ekziston midis tyre.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

© QSHA 2 20 qershor 2018

Skemë vlerësimi Letërsi e thelluar Varianti A

**Pyetja 9** **2 pikë**

- **Analiza:**
  - Dy vajzat kanë këmbyer vendet. Linda ka dashuruar shkrimtarin, por do ta ndiejë atë përmes përshkrimeve dhe raporteve të Migenës me të.
  - Migena vepron në emër të Lindës.
- **Shkaqet**
  - Ky dyzim ka ardhur për shkak të pengimit. Linda është rritur në internim dhe është privuar të shkelë në kryeqytet. Për këtë arsye, për të përmbushur sadopak ëndërrën e saj, ajo këmbehet me Migenën.

**2 pikë** Nëse analizon në mënyrë të plotë dyzimin midis dy personazheve.

**OSE**

**1 pikë** Nëse analizon në mënyrë të pjesshme dyzimin midis dy personazheve.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10** **2 pikë**

**Përgjigje e plotë**

- **Të përbashkëtat**
  - Linda, sikurse heroi i absurdit, është e huaj në mjedisin ku jeton. Ajo ndihet e papranuar në atë mjedis, prandaj ajo e përjeton si e huaj atë.
  - Të dy janë të huaj për mjedisin ku jetojnë.
- **Dallimet**
  - Linda B shfaqet fisnike, e ndryshme nga mjedisi. Asaj i mungon mjedisi i vet kryeqyteti dhe mbetet e pakuptuar, e mohuar e dënuar e penguar për një krim që s'e ka bërë.
    Ajo është e destinuar të vdesë për shkak të absurdit të sistemit diktatorial. Ajo ndryshe nga heroi i absurdit e ka kuptuar thelbin e kotësisë së ekzistencës, e ka ndierë qenien e saj pa peshë dhe si heronjtë e ekzistencializmit, në mungesë të lirisë, shkon me vullnet drejt vdekjes si shpëtim nga jeta. Ka këtu një mospërputhje që lidhet me paradoksin e sistemit të diktaturës komuniste.

**Përgjigje e pjesshme**

Nëse jep vetëm të përbashkëtat ose vetëm dallimet.

**2 pikë** Nëse krahason në **mënyrë të plotë** Linda B me heroin e absurdit.

**OSE**

**1 pikë** Nëse krahason në **mënyrë të pjesshme** Linda B me heroin e absurdit.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

***Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

© QSHA 3 20 qershor 2018

Skemë vlerësimi Letërsi e thelluar Varianti A

**Pyetja 11** **2 pikë**

- **Të dhënat dhe shpjegimi**
  - Ti ishe e ***fundmja*** shpresë - Theksimi i fjalës ***e fundmja,*** ndryshimi i pozicionit në fjali (inversioni), krijon ndjesinë e diçkaje që po shkon vrulltazi drejt një fundi të paralajmëruar.
  - ***Më sillje lajme prej botës*** kjo e dhënë krijon ndjesinë e dy botëve: asaj të të gjallëve dhe një tjetër, asaj të harrimit, ku Linda B ndodhet. Mënyra se si ajo shprehet, thekson një përhumbje të personazhit, një përkohshmëri të saj dhe një parandjenjë së diçka do të ndodhë së shpejti.
  - ***Sepse… ja ku po ta pohoj atë që isha e sigurt se do ta merrja me vete në varr*** - theksimi i fjalës ***varr,*** mbart një nëntekst paralajmërues, nxjerr më në pah gjendjen fataliste të heroinës.
  - ***Ishte i vetmi shans…që diçka…të dilte….prej meje…matanë***: përdorimi i retiçencave, fjala ***matanë***, krijojnë idenë e diçkaje paralajmëruese, që pritet të ndodhë dhe kjo nuk ka mundësi të jetë e mirë, përkundrazi. Ka shumë dëshpërim në fjalët e saj, shumë zhgënjim, përhumbje, fatalizëm.
  - ***…si njeriu që ndien fantazmën*** detaji i fantazmës, krijon analogji me diçka që i takon botës së përtejme. Është një detaj paralajmërues se fundi nuk mund të jetë ndryshe.

**1 pikë** Nëse identifikon një të dhënë paralajmëruese.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon se pse kjo e dhënë krijon te lexuesi idenë se personazhi do të kryejë aktin e vetëvrasjes.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

***Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban model përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

© QSHA 4 20 qershor 2018

Skemë vlerësimi Letërsi e thelluar Varianti A

## PJESA II

**Kongoli** ***Jetë në një kuti shkrepësesh***

**Pyetja 12** **B** **1 pikë**

**Pyetja 13** **D** **1 pikë**

**Pyetja 14** **C** **1 pikë**

**Pyetja 15** **A** **1 pikë**

**Pyetja 16** **B** **1 pikë**

**Pyetja 17** **2 pikë**

- **Nënteksti i titullit**
  - **Titulli është metaforë që zbulon hapësirat e ngushta të jetës.** Përmasat e mjedisit, hapësirës përcaktojnë edhe përmasën e lirisë dhe të zhvillimit të personalitetit. Apartamente të vegjël, njerëz të vegjël, botë meskine, e vogël, e mbyllur, e ndotur, pa ëndrra dhe pa ajër.
- **Momenti:**

*Edhe nëse më pas fati jua sjell të jetoni mes rehatisë, në hapësira të bollshme, ju siguroj, për këtë mund të flas me kompetencë, bota juaj ka mbetur përjetësisht e vogël, sa një kuti shkrepësesh. Prirja juaj është t'i zvogëloni përmasat, t'ia përshtasni metrit me të cilin jeni rritur. E keqja më e madhe:nocioni i kohës dhe hapësirës e humbasin kuptimin. Ditët rrjedhin monotone…*

**1 pikë** Nëse zbërthen nëntekstin e titullit.

**DHE**

**1 pikë** Nëse identifikon në fragmentin e dhënë një moment që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me titullin e romanit.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

***Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

© QSHA 5 20 qershor 2018

Skemë vlerësimi Letërsi e thelluar Varianti A

**Pyetja 18** **3 pikë**

- **Gjendja psikologjike**
  - Gjendja psikologjike e personazhit shfaqet e rënduar, për shkak të krimit të kryer. Ajo merr formë më konkrete në paragrafin e fundit të fragmentit.

*Jam peng i pavendosmërisë. qenkam burracak, një frikaman, përderisa duhet të zgjedh njërën nga të dyja dhe të tërhiqem zvarrë nga një dilemë gjoja hamletiane.*

- **Krahasimi**

**Përgjigje e plotë**

Dilema e Bledit është të vetëdorëzohet apo jo për krimin e kryer, një krim ordiner si dhe vetë personazhi, që nuk ka asgjë të ngjashme me heroin e idealeve të mëdha të Rilindjes.

Dilema e Hamletit lidhet me misionin e madh **të rrosh apo të mos rrosh* (mjedisi është i molepsur, por heroi është model i qëndresës kundërshtar i këtij mjedisi). Kurse Bledi është produkt i rrethanave, i dorëzuar tek ato dhe jo në luftë me to.

Hamleti është model i vetëflijimit në emër të virtytit, përkundër një heroi të degraduar e po aq i molepsur sa edhe mjedisi.
Në këto kushte analogjia me dilemën hamletiane e shtyn situatën drejt <u>groteskut.</u>

**Përgjigje e pjesshme**

- Hamleti kërkon të vetëflijohet në emër të virtytit, Bledi jo.
- Nuk ngjasojnë të dy, pavarësisht dilemave që mbartin.

**1 pikë** Nëse tregon gjendjen psikologjike që po përjeton personazhi..

**DHE**

**2 pikë** Nëse krahason në mënyrë të plotë dilemën e tij me atë të Hamletit.

**OSE**

**1 pikë** Nëse krahason në mënyrë të pjesshme dilemën e tij me atë të Hamletit.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

***Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban model përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

© QSHA 6 20 qershor 2018

### Stoltenberg: Maqedonia, ftesë për në NATO në samitin e 11 korrikut

# "Maqedonia e Veriut", Kuvendi e ratifikon me 69 vota pro

## *Zaev: Marrëveshja hap rrugën për në BE*

Pas më tepër se dy dekada mosmarrëveshje mes Greqisë dhe Maqedonisë, ditën e djeshme Kuvendi i kësaj të fundit ratifikoi marrëveshjen me Greqinë për emrin e ri "Republika e Maqedonisë së Veriut", me 69 vota pro dhe asnjë kundër. Në seancë nuk morën pjesë deputetët e partisë opozitare VMRO-DPMNE. Kryeministri Zoran Zaev në fjalimin e tij në seancën kuvendore për ratifikimin e marrëveshjes me Greqinë tha se qytetarët do ta sjellin vendimin përfundimtar për çështjen e emrit. "Para tri ditëve nënshkruam dokument për t'i dhënë fund çështjes tredekadëshe. Kemi nënshkruar fillimin e fundit të paqartësive. Zgjidhje me dinjitet për të dyja palët. Gjuha dhe identiteti nuk do të shkelen nga marrëveshja", deklaroi kryeministri Zoran Zaev. Gjatë ditës së djeshme edhe Komisioni për Çështje Evropiane i dha dritë jeshile marrëveshjes dhe pas kësaj, dokumenti do të dërgohet tek presidenti Gjorge Ivanov, i cili ka një afat prej shtatë ditësh për ta nënshkruar. Sekretari gjeneral i NATO-s, Jens Stoltenberg shpreson se do të mund të dërgohet ftesë për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO në Samitin e 11 dhe 12 korrikut që do të mbahet në Bruksel, pasi Shkupi dhe Athina arritën marrëveshje për kontestin rreth emrit. "Shpresoj se do të ketë përparim me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, sepse arriti marrëveshje me Greqinë për problemin rreth çështjes së emrit. Në rast se ajo marrëveshje do të finalizohet dhe zbatohet, atëherë emri i ri do të jetë Republika e Maqedonisë së Veriut dhe mund të nisemi drejt anëtarësimit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në NATO", deklaroi Stolltenberg për televizionin francez "Frans 24". "Nuk dhamë as edhe një gjë në këmbim të diçkaje tjetër, ne bëmë marrëveshjen më të mirë për vendin", deklaroi ministri grek i Punëve të Jashtme, Nikos Kotzias, në një intervistë për televizionin grek 'ANT1' në lidhje me marrëveshjen mes Athinës dhe Shkupit për të zgjidhur çështjen e emrit. "Shumica e njerëzve e kuptojnë se është zgjidhur një problem me Shkupin", theksoi ai. "Megjithatë, disa janë të hutuar në lidhje me historinë e Greqisë antike dhe gjeografinë e Maqedonisë", tha Kotzias. "Për herë të parë Athina dhe Shkupi arritën një marrëveshje përfundimtare dhe të pakthyeshme, që ka ndarë civilizimin antik grek. Kjo marrëveshje do të votohet në Parlamentin grek", vazhdoi ai. "Pas marrëveshjes për fqinjësi të mirë me Bullgarinë, është arritur marrëveshja dinjitoze edhe me Greqinë, me çka është mbyllur edhe çështja e fundit që pengonte rrugën e Maqedonisë në aspiratat euroatlantike", theksoi kryeministri Zoran Zaev në takimin me delegacionin e Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës për dialog postmonitorues me Republikën e Maqedonisë, të udhëhequr nga bashkëraportuesit Liza Kristoferesn dhe Valeriu Gileçi. "Qytetarët do të shprehin fjalën e fundit në referendumin për marrëveshjen me Greqinë, por ne duhet të mbështesim zhvillimin e Maqedonisë dhe të vazhdojmë të ecim përpara", theksoi kryeministri maqedonas. Sipas tij, marrja e datës për fillimin e negociatave me BE-në do të jetë një motiv më shumë në qasjen energjike reformuese të qeverisë, e cila në këtë proces i përfshin aktivistët të gjithë faktorët tjerë shoqërorë dhe politikë.



Kuvendi i Maqedonisë

**ZORAN ZAEV**
"Qytetarët do të shprehin fjalën e fundit në referendumin për marrëveshjen me Greqinë, por ne duhet të mbështesim zhvillimin e Maqedonisë dhe të vazhdojmë të ecim përpara", theksoi kryeministri maqedonas.

**NIKOS KOTZIAS**
"Nuk dhamë asnjë gjë në këmbim të diçkaje tjetër, ne bëmë marrëveshjen më të mirë për vendin. Shumica e njerëzve e kuptojnë se është zgjidhur një problem me Shkupin", deklaroi ministri grek i Punëve të Jashtme, Nikos Kotzias.

**JENS STOLTENBERG**
"Në rast se ajo marrëveshje do të finalizohet dhe zbatohet, atëherë emir i ri do të jetë Republika e Maqedonisë së Veriut dhe mund të nisemi drejt anëtarësimit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në NATO", deklaroi Stolltenberg.

## SHKURT

### Samiti Trump-Kim, kryhen 40 mijë sulme kibernetike

Gjatë samitit mes presidentit amerikan, Donald Trump dhe liderit të Koresë së Veriut, Kim Jong-un në Singapor janë kryer 40 mijë sulme kibernetike. Të dhënat i ka publikuar kompania teknologjike me seli në SHBA, "F5 Networks" dhe partneri i saj për të dhënat "Loryka", raporton 'ATSH'. Mësohet se 88% e sulmeve janë me bazë në Rusi, 8% në Brazil dhe 2% në Gjermani. Kurse 2% e sulmeve kanë buruar nga shtetet e tjera, në mesin e të cilëve ndodhen edhe SHBA-të dhe Kanadaja. Agjencia e Sigurisë Kibernetike të Singaporit (CSA) në një deklaratë lidhur me këtë çështje është shprehur se gjatë samitit nuk është zbuluar ndonjë sulm i kryer me sukses.

### Kanadaja legalizon marijuanën, Trudeau: Premtim i mbajtur

Ditën e djeshme parlamenti i Kanadasë ka miratuar ligjin që legalizon marijuanën në të gjithë vendin. Akti "Kanabis" kaloi me 52 vota pro dhe 29 vota kundër ditën e martë. Por, ligji kontrollon dhe rregullon edhe mënyrën se si kjo drogë mund të kultivohet, shpërndahet dhe shitet. Qytetarët në Kanada mund të blejnë dhe përdorin kanabis ligjërisht duke nisur nga muaji shtator. Pas Uruguait në vitin 2013, Kanadaja bëhet vendi i dytë në botë që ligjëron kanabisin. Posedimi i kanabisit u konsiderua krim për herë të parë në Kanada në vitin 1923, por që nga viti 2001 lejohet përdorimi mjekësor i marijuanës. Në vitin 2015 mendohet se kanadezët kanë shpenzuar 6 miliardë dollarë kanadezë (4,5 miliardë dollarë amerikanë) për kanabis, pothuajse aq sa kanë shpenzuar edhe për verë.

### Indonezi, 180 të zhdukur pas mbytjes së anijes në liqenin Toba

Ditën e djeshme në Indonezi kanë rezultuar rreth 180 pasagjerë të zhdukur pas mbytjes së një anijeje në një liqen vullkanik indonezian, sipas bilancit të ri të njoftuar nga policia, që rishikon në rritje numrin e viktimave. Forcat e shpëtimit nënvizuan se nuk dihet numri i personave të ndodhur në bordin e varkës prej druri, që u mbyt në liqenin Toba, në veri-perëndim të Indonezisë. Sipas policisë, që bazohet nga informacione të ndryshme, bëhet fjalë për 178 të vdekur. Nëse ky bilanc konfirmohet, bëhet fjalë për një prej katastrofave më të rënda detare të historisë së arkipelagut prej 1 700 ishujsh. Sipas një bilanci paraprak, bëhet fjalë për 80 të zhdukur.

### Mediat serbe: Liberia ka tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës

## Thaçi: Kufiri me Serbinë do jetë në tavolinë, s'lejojmë të cenohet asnjë milimetër

Ditën e djeshme mediat serbe shkruan se shteti i Liberisë ka tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës, sipas "Zëri.info". Ministri i Jashtëm i Liberisë, Gbezongar Milton Findlej i ka dorëzuar homologut të tij serb, Ivica Daçiç, tërheqjen e njohjes së Kosovës derisa të vazhdojë dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit. Në dokumentin e publikuar nga mediet serbe thuhet se Liberia e ka pranuar pavarësinë në kuadër të marrëveshjes që Beogradi nuk është i gatshëm të bisedoj për "krahinën jugore-Kosovën". Liberia e ka njohur pavarësinë e Kosovës më 30 maj 2008. Ndërkohë, që përsa i përket dialogut me Serbinë, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, dje ka mbajtur konferencë për media, lidhur me takimin që do të mbahet të dielën në Bruksel. Duke folur rreth procesit të dialogut me Serbinë, Thaçi theksoi se beteja zhvillohet në tavolinë e jo duke shikuar nga jashtë. Ai gjithashtu ka theksuar se çështja e kufirit me Serbinë do të jetë në tavolinën e diskutimeve. "Çështja e kufirit me Serbinë do të jetë në tavolinë dhe aty zhvillohet beteja e jo duke shikuar nga jashtë. Nuk do të lejojmë të cenohet asnjë milimetër e territorit", ka deklaruar Thaçi. Gjithashtu, presidenti ka folur për demarkacionin me Serbinë, për rreth 400 km tokë. Ai ka thënë se Kosova duhet të jetë e bashkuar për këtë çështje. "Ne do të kemi çështjen me demarkacionin me Serbinë rreth 400 km, ju e dini se çfarë situate kemi kaluar me Malin e Zi, tri vite pritje. Prandaj, ne duhet të bëjmë të gjithë së bashku ekipin që do të punojë për demarkacion me Serbinë. Nuk lejojmë të cenohet asnjë centimetër i territorit të Kosovës", është shprehur ai. Teksa pritet vazhdimi i dialogut në Bruksel, Gjermania ka propozimin që në vend të shefes së diplomacisë së BE-së, Federica Mogherini, negociatat t'i udhëheqë përfaqësuesi special i Unionit. Kështu shkruan gazeta e Beogradit "Blic", siç thotë duke u referuar në burimet e saj. Duke komentuar zhvillimet rreth dialogut, drejtori i Forumit për Marrëdhënie Etnike, Dushan Janjiç ka thënë se në periudhën e ardhshme, në dialog me siguri do të përfshihen SHBA-të dhe Gjermania.

**HASHIM THAÇI**
"Çështja e kufirit me Serbinë do të jetë në tavolinë dhe aty zhvillohet beteja e jo duke shikuar nga jashtë. Nuk do të lejojmë të cenohet asnjë milimetër i territorit", ka deklaruar presidenti kosovar, Hashim Thaçi.



Hashim Thaçi

DEBATI

# Ben Derhemi: Teatri nuk është kapanon, do hyjmë në grevë të mos i vini flakën

Fatmira Nikolli

Kisha një kërkesë si një njeri që jam marrë me lëvizjen për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar. Gjithë këto ditë këdo që kam takuar më pyesin e janë të interesuar të dinë çdo bëhet me këtë truall. Më thonë që me zemër janë me ne. Por unë sot, do iu kërkoj të gjithëve që të jenë me ne fizikisht. Me zemër janë të tërë me ne, por ky teatër mbrohet vetëm fizikisht. Vetëm fizikisht këta njerëz tremben". Ka qenë kjo kërkesa që ka bërë dje aktori Ben Derhemi në protestën e përnatshme për mbrojtjen e truallit të teatrit. Ai shtoi se "çdo gjë që bëjmë ne këtu në sheshin e teatrit përgjohet e spiunohet. Çdo ditë. Por duhet të dini se do të vijmë shpejt të futemi në grevë urie. Të mos mendojnë se mund ta prekin, as të vënë dorë në të",- tha aktori.

"Dikush shkruante më 'Facebook': Kjo verë do të jetë e nxehtë. Më erdhi keq. Por ta dini, unë po ju them se mos guxoni të vini dorën këtu. Mos guxoni të fusni flakën as t'i vini shkrepësen teatrit. Edhe si material kjo godinë nuk merr flakë. Mos guxoni t'i afroheni Teatrit Kombëtar. Ky nuk merr flakë",- tha Derhemi.

Më herët, ai tha se e mbështet kauzën e teatrit se është kauzë e drejtë. "Nuk kemi asnjë interes. Kemi dashuri për këtë kapanon. Nuk është kapanon është shpirt. Në atë sallë kanë interpretuar njerëz që ju kanë dhënë shpirt ju, ne na kanë mësuar". Derhemi interpretoi pjesë nga shfaqja e tij bazuar në veprën e At Zef Pllumit, "Rrno për me tregue".Në takimin e djeshëm veç Derhemit folën edhe Taulanta Jupi, producentja Sabina Kodra, Arbër Çepani dhe juristi Çlirim Gjata.

Kodra kërkoi që kjo të jetë rezistencë popullore dhe që artistët të mos tërhiqen. "Unë e kam ndjekur protestën nga afër, sepse Bert Budina ka kohë që jeton me protestën dhe nuk dua që të përfshihemi e të bëhemi protagonistë e gjithë familja. Mos u dorëzoni!", tha ajo



Në foto: Protesta për mbrojten e teatrit



Në foto: Arben Derhemi



Në foto: Robert Ndrenika

**REAGIMI I NDRENIKËS**

Aktori i madh i skenës, Robert Ndrenika, i ka shkruar një letër presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta. Nisur nga ajo çfarë ndodhi dje në Komisionin e Medias, ku u përplasën Albana Vokshi dhe kryebashkiaku, Erion Veliaj, Ndrenika thekson se partitë politike nuk duhet të trazohen në punët e teatrit, që është kthyer në një temë të nxehtë dhe të mbushur me debate. "Deputetët dhe politikanët në këtë rast, janë qytetarë dhe më së shumti, spektatorë", - shkruan ndër të tjera, Ndrenika. "Gazeta Shqiptare" ka siguruar ekskluzivisht letrën që i ka shkruar kolosi i skenës shqiptare, Robert Ndrenika, Ilir Metës dhe që po ua sjellim më poshtë.

*Aktorët sërish në protestë, "Nuk ju lëmë t'i vini flakën godinës"*

**LETRA E PLOTË**

I nderuar president i Republikës Ilir Meta!

Duke parë në TV atë që ndodhi dje në komisionin e medias m'u forcua bindja, se partitë politike, nuk duhet të trazohen në punët e teatrit.

Kam mendimin se kjo çështje, zgjidhet me bisedime midis komunitetit teatror dhe specialistëve. Deputetët dhe politikanët në këtë rast, janë qytetarë dhe më së shumti, spektatorë. Ndërsa qeveria "pa zhurmë dhe pa fjalë", është e detyruar të fusë duart në qese dhe të nxjerrë paratë!!!

Me plot respekt

Robert Ndrenika

AKTORJA

## MARJANA KONDI: DUA TEATËR TË RI PA PREKUR ASNJË MILIMETËR TRUALL

*Aktorja Marjana Kondi ka reaguar për çështjen e Teatrit Kombëtar. Përmes një postimi në profilin e saj, Kondi del në krah të kolegëve të saj, që prej 4 muajsh po mbrojnë truallin e teatrit.*



Në foto: Mariana Kondi

**POSTIMI**

E kuqja e teatrit, një ngjyrë, gjendje shpirtërore dhe një kujtim...

Kujtimet mbeten. Impresionin e parë si aktore ajo sallë ma transmetoi nëpërmjet së kuqes, lozhave, poltronave dhe perdes kadife. Nuk shihja për herë të parë teatër të këtij stili, por ndjesia ishte e tillë. Atyre viteve unë isha nismëtare e një kauze për mbrojtjen e "Estradës së Shtetit" së bashku me kolegë të mi. Sot nuk dua që historia të përsëritet, por si artiste e skenës nuk mund të jem indiferente ndaj kauzës së prishjes dhe rindërtimit të Teatrit Kombëtar dhe zgjedh të jem faktor në krah të kolegëve. Gjithmonë realiste, në mbrojtje të artit dhe institucioneve kulturore. Perdja e kuqe e Teatrit Kombëtar, e cila më impresionoi aq shumë, nuk arriti të më zërë sytë dhe la zbuluar teatrin përpara meje. Përtej së kuqes, lozhave, poltronave dhe perdes kadife, lëngonte një teatër i amortizuar e i braktisur nga instancat shtetërore. E kuqja e sallës ishte skuqja nga turpi i këtij shpirti që vuante. Të tillë për fatin e keq e gjej dhe sot. Kjo gjendje shton nevojën për të kërkuar një teatër të ri, të mirëmbajtur, me të gjithë elementët teknikë si hapësira skenike, akustika, numri i sallave, elementët audio dhe ndriçim, kapacitet të lartë të vendeve për publikun, ambiente bashkëkohore pune për aktorët. Dhe këtë s'e kërkoj për vete, por për gjeneratat që do vijnë. Kërkesa për një teatër të tillë (pa cenuar asnjë centimetër nga territori ekzistues). Jam e dëshiruar të luaj në një skenë të tillë. Një skenë, e cila i përgjigjet më së miri nivelit artistik të kolegëve të mi. Një teatër, i cili lejon të prehen të qetë shpirtrat e emrave të mëdhenj që kanë dhënë aq shumë për artin shqiptar. Unë si person nuk pushtohem nga nostalgjia. Më pëlqen e reja, modernia, e ardhmja...

Ndaj mbështes çdo iniciativë që kërkon t'i japë kombit, qytetit, publikut, aktorëve, regjisorëve një teatër që kemi dashur, por pa gjymtuar shtratin e sotshëm të teatrit. E cilësoj, pa cenuar shtratin e sotshëm të teatrit.Thyhem kur flitet për teatrin, sepse i kam një, teatër e shpirt. Ne duhet të shtrëngojmë në zemër të kaluarën dhe të drejtojmë shikimin nga e ardhmja. Me shpresën që të bëhet më e mira për të gjithë ne.

Marjana Kondi

EKSPOZITA

# ANGJELIN NENSHATI

# Dëshmitar mes dy kohëve, fotografi që dokumentoi rënien e regjimit

*Ekspozita që çelet në Shkodër, arkivi me 228 mijë imazhe të shkrepura*

Nga Luçjan Bedeni

Angjeli Nenshati (Shkodër 1929 - 2008) ndjek studimet e para në Kolegjin Saverian e mbas mbylljes së tij, në gjimnazin "28 Nëntori" në Shkodër. Formimi i tij zë fill në mënyrë autodidakte. Impakti me fotografinë erdhi nga rasti fatlum i të rënit në dorë që herët i një aparati fotografik, me të cilin bëri shkrepjet e para në kontekstin e një qyteti me traditë në këtë fushë.

Me vendosjen e regjimit komunist, për t'iu shmangur disi persekutimit për prirjet e tij demokratike e fetare, nga viti 1948 kur vendoset në Pukë e deri në 1957, është arsimtar pranë shkollave të ndryshme, por kjo nuk e pengon të punojë edhe në fushën e fotografisë. Që herët, edhe falë lidhjeve familjare, ai qëndron pranë fotografit të njohur në Shkodër, Pjetër Rraboshta, gjë që e plotësoi formimin e tij në drejtim të proceseve të laboratorit. Në vitin 1958 hyn në kooperativën shtetërore ku punon si fotograf. Në vitet '70 i bashkohet Gegë Marubit në aktin e dhurimit të fondit fotografik personal. Ky fond i ruajtur në Fototekën 'Marubi' dhe i pasuruar më tej prej tij, numëron mbi 228.000 imazhe të shkrepura në film rul 24x36mm. Ishte fotografi që ndiqte eventet social-kulturore të vendit, por edhe familjet qytetare në ritualet e ndryshme të jetës së tyre. Aktiviteti i tij u realizua më shumë jashtë studios se brenda saj.

Punon në repartin e fotografëve deri sa arrin moshën e pensionit në vitin 1989. Realizon fotografi të zhanreve të ndryshme, por është shumë afër atij të reportazhit.

Krahas fondit të tij në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi", familja zotëron një fond të pasur me fotografi, kryesisht me ngjyra.

Nenshati është autori që ndjek nga afër ngjarjet më të rëndësishme të qytetit, lëvizjet e ndryshme demokratike të viteve '90, momentet e kthesave të rëndësishme, rifillimin e kremtimeve fetare, rihapjen e kishave të xhamive.

Më 1993 fotografon vizitën e Papa Gjon Palit II dhe Nënë Terezës së Kalkutës në Shqipëri. Më 1996 bashkë me djemtë e tij hap studion fotografike "Nenshati".

Krijimtaria artistike në Shqipëri, ashtu si edhe në vendet tjera të ish-Bllokut komunist lindor, ndiqte rrymën ideologjike të realizmit socialist, e cila trajtohej si e vetmja e denjë për regjimin komunist në lëmin e letërsisë dhe të arteve në përgjithësi. "Filli i kuq" i frymës ideologjike të kohës përshkonte tejembanë formën estetike, duke e shndërruar veprën artistike në një instrument propagandistik për të përhapur idealet komuniste revolucionare dhe optimizmin për botën që ato ideale mëtonin të krijonin.

E gjithë kjo realizohej nëpërmjet transformimit ideologjik të realitetit në artin e kohës, ku përmes linjës politike të një partie të vetme ekzistuese, i ashtuquajturi "njeriu i ri" paraqitej si fryt i fitoreve revolucionare dhe i triumfit të betejave për transformimin e botës. Ai njeri nuk përfaqësonte aspak realitetin kontradiktor, subjektivitetin e qenies njerëzore dhe nuk kishte asnjë lloj natyrshmërie.

Kemi të bëjmë me një lloj "laboratori të formësimit të prototipit" - siç e ka përkufizuar studiuesi Gëzim Qendro - që përtej vullnetit për ta shfaqur modelin e njeriut të ri në çdo aspekt artistik dhe kulturor, në të vërtetë e mbatjën atë "të fshehur nga fotografia, të fshehur nga kinematografia, të fshehur nga piktura, nga skulptura, nga gjithçka".

Ekspozita kushtuar Angjelin Nenshatit, fotografit të shndërrimeve historike të vendit, orientohet në dy drejtime: në periudhën e diktaturës komuniste dhe në atë të tranzicionit të viteve '90. Në qoftë se vitet '60, e miqësisë vëllazërore me Bashkimin Sovjetik, na paraqisnin frymën triumfuese të regjimit të asaj kohe sipas klishesë "njeriu dhe lufta", vitet '70-të cilave i përkasin edhe shumica e fotografive të kësaj ekspozite - kanë në fokus temën "njeriu dhe puna" dhe eksperimentin e revolucionit kulturor me frymëzim kinez në shoqërinë shqiptare.

Këto dekada karakterizohen nga dy momente të rëndësishme të trysnisë ideologjike. Nga njëra anë zhvillohet lufta kundër besimit fetar dhe zakoneve prapanike, që do të çonte në shpalljen e Shqipërisë si i pari vend ateist në botë me Kushtetutën e vitit 1976. Ky aspekt tragjik i revolucionit kulturor bëri që objektet e kultit të shndërroheshin në vende të propagandës së ideologjisë komuniste. Një pjesë e tyre u transformuan në pallate sporti, kinema, shtëpi kulture, magazina e të tjera u shembën me themel. Të gjitha masa përmbyllnin fushatën e persekutimit të klerit që kishte zënë fill në vitin 1944.

Regjimi diktatorial i Enver Hoxhës, pas viteve '70 u karakterizua nga ndjekja besnike e ideologjisë komuniste, që interpretohej në një këndvështrim të rreptë antirevizionist. Plenumi IV (1973) ishte edhe momenti më kulminant i politikës agresive kundrejt artit. Shembujt kryesorë të kësaj lufte qenë goditja kulturore e artistëve të ekspozitës "Pranvera" (1972) dhe Festivali XI i Këngës në Radio Televizion (1972).

E parë në këndvështrimin e ndryshimeve, ekspozita e Angjelin Nenshatit ndërtohet në një rend kronologjik të orientuar nga tri imazhe kryesore. Në plan të parë qëndron shfaqja e një gjimnasteje e kapur në unazat e vendosura në altarin e një kishe të transformuar në klub rinie (1967). Në kontrast me të, njëzet e katër vite më pas, autori dokumenton aktin e "rimarrjes" së Katedrales, ku ikona e Zojës së Shkodrës, megjithëse në plan të dytë, qëndron mbi shkallët e tribunës së Pallatit të Sportit ndërkohë që njërëzit heqin tabelën e basketbollit (1991). Krahas dokumentimit të momenteve të hapjes së kulteve, vetëm pak ditë më pas, fotografi dëshmon djegien e Komitetit të Partisë më 2 prill 1991 në Shkodër, e cila konsiderohet si ngjarja përfundimtare e përmbysjes së diktaturës në Shqipëri. Në të dyja këto periudha, në thelbin e fotografisë së tij, mbetet ngjarja të cilën ai e ndjek me interesin dhe me syrin e reporterit të mirëfilltë dhe të vëmendshëm. Për asnjë moment tek ai nuk ndihet vlerësimi i autorit ndaj asaj që po pasqyron - qofshin ato momente që i përkasin manifestimeve rinore, aksioneve vullnetare, propagandës së kohës, apo thjesht çastet e jetës së përditshme.

Këtë pozicion të disiplinuar në marrëdhënie me momentin e pranishëm e perceptojmë gjithashtu edhe në ndryshimet e mëdha politike të vendit në vitet '90, ku përmbysjet social-politike të lartpërmendura e transformojnë totalisht natyrën gjithnjë e më dramatike që merr ngjarja e çliruar nga inskenimi.

***Ekspozita është kuruar nga Luçjan Bedeni dhe Lek M.Gjeloshi. Teksti u përgatit nga Bedeni, drejtor i Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi"**








Shëndetësi

Mbrojtja e parë që ka organizmi ndaj shumë agjentëve dëmtues është lëkura e përbërë nga shtresa me trashësi të ndryshme. Rrezet UVB nuk mund të depërtojnë më thellë se shtresa e parë e lëkurës. Mbrojtja e dytë është prodhimi i pigmentit ngjyrues, melaninës, i cili ngjyros lëkurën dhe kështu nuk digjemi apo dëmtohemi njësoj si një individ me lëkurë të bardhë. **Pigmenti i shton trashësinë lëkurës dhe e bën akoma më të vështirë për diellin që të depërtojnë më thellë e të dëmtojë lëkurën.**




Mjeku popullor: Kujdes nga rrezet UBV, dëmtojnë AND-në dhe shkaktojnë kancer

# YLLI MERJA: Djegiet nga dielli, si të përgatisni kura natyrale

## "Çajrat bimorë që do të qetësojnë lëkurën"

Voltiza Duro

Djegia nga dielli shkakton dëmtim dhe vdekje të qelizave të epidermës. Janë rrezet UVB që prekin vetëm sipërfaqen e lëkurës, të cilat e shkaktojnë ngjyrosjen e saj, por edhe njollat kafe. Në rastet kur djegia është më e fortë dhe prek shtresën e dytë të lëkurës, ku gjenden enët e gjakut, atëherë fillon të çlirohet në sipërfaqen midis, dhe kështu formohen flluskat e ujit. Kjo lloj djegie duhet mjekuar pasi mund të formojë edhe infeksione, sidomos nëse flluskat çahen në det e futen bakterie që mund të bllokohen nën lëkurë. E duke qenë se enët e gjakut janë përreth mund të krijojë infeksione shumë lehtë. Djegia nga dielli varet nga lëkura e individit, dhe vendi ku jeton. Njerëzit që jetojnë në vende malore dhe janë shumë pak të ekspozuar ndaj diellit gjatë gjithë kohës, kanë lëkurë të bardhë dhe kështu digjen shumë shpejt nga dielli nëse nuk përdorin mbrojtjen e duhur. Ndërsa njerëzit që jetojnë në zonat afër detit, ose në vende me të ngrohta ekspozohen më shumë ndaj diellit dhe lëkura e tyre është 'e mësuar' me rrezatimin diellor. Këta individë kanë ngjyrë më të errët të lëkurës, dhe, gjithashtu, marrin ngjyrë shumë shpejt.

**SI E MBRON ORGANIZMI VETVETEN?**

Mbrojtja e parë që ka organizmi ndaj shumë agjentëve dëmtues është lëkura e përbërë nga shtresa me trashësi të ndryshme. Rrezet UVB nuk mund të depërtojnë më thellë se shtresa e parë e lëkurës. Mbrojtja e dytë është prodhimi i pigmentit ngjyrues, melaninës, i cili ngjyros lëkurën dhe kështu nuk digjemi apo dëmtohemi njësoj si një individ me lëkurë të bardhë. Pigmenti i shton trashësinë lëkurës dhe e bën akoma më të vështirë për diellin që të depërtojnë më thellë e të dëmtojë lëkurën. Mbrojtja e tretë është mbrojtje më specifike dhe shumë e saktë. Në bërthamën e qelizave ndodhen mekanzimat mbrojtëse të AND-së. Por rrezet e diellit prishin ADN kur janë shumë të forta, dhe mekanizmat mbrojtëse e rregullojnë prishjen e saj. Kur këto dëmtime në ADN janë shumë të mëdha dhe nuk rregullohen dot, krijohen sëmundjet e lëkurës si kanceri i lëkurës. Prandaj është shumë e rëndësishme të mbrohemi ndaj rrezeve të diellit.



Mjeku popullor Ylli Merja

**TRAJTIMI PAS DJEGIES**

Hapi i parë i mbrojtjes, nëse jeni skuqur shumë, është të largoheni menjëherë nga rrezet e diellit. Një dush me ujë të ftohtë ndihmon që të ndalohet vazhdimi i djegies së lëkurës në thellësi. Pas kësaj lyhet lëkura me një xhel aloe vera të përgatitur kështu: Merren 2 lugë gjelle aloe vera, 10 pika vaj rozmarine; 10 pika vaj sherbele; 1 lugë gjelle vaj basani si dhe 2 kapsula me vitaminë E. Përzierja hidhet në një kuti të vogël dhe tundet për 2-3 minuta. Ngjyra e përzierjes do të bëhet e bardhë, e atëherë është gati për t'u përdorur. Lyhet pjesa e djegur me këtë maskë 3-4 herë në ditë. Ndërkohë në mungesë të xhelit të aloe verës mund të përdorni vazelinë. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe këshillohet të pini çaj jeshil, i cili ndihmon në rigjenerimin e lëkurës. Konsumimi i ujit është i rëndësishëm për të zëvendësuar humbjen e ujit në organizëm. Përdorni krem mbrojtës SPF 60-70 gjatë gjithë kohës kur dilni nga shtëpia për të mos e vazhduar djegien në shtresat e tjera të lëkurës. Nëse keni djegie të thellë që krijon temperaturë dhe marrje mendsh mund të përdoren edhe bimë të tjera medicinale. Përgatitni dy çajra të veçantë: një do të përdoret për shpëlarjen e trupit dhe tjetri do të përdoret për t'u pirë.

Çaji për t'u pirë: Hidhen 1.5 litra ujë në një tenxhere, e kur fillon të valojë uji, hidhet 1 lugë gjelle çaj i gjelbër dhe 3 lugë gjelle çaj me fruta pylli. Lihet të valojë për 2-3 minuta, mbulohet çaji me kapak derisa të ftohet, kullohet dhe ruhet në frigorifer. Konsumohen 3 herë nga 1 gotë në ditë para ose pas ushqimi, e mund të ëmbëlsohet sipas dëshirës.

Çaji për shpëlarje të trupit në raste djegie të shkallës së tretë: Hidhen 2 litra ujë në një tenxhere, e kur të valojë shtohet 1 dorë me lëvore vidhi dhe një dorë me lëvore mimoze, lihet të ziejë 7-8 minuta. Kullohet pas 20 minutash, e në këtë kohë përzierja bëhet kremoze. Me çajin bëhet shpëlarja e trupit 2 herë në ditë. Ndërkohë edhe kremi antirrudhë ka veti të fuqishme rigjeneruese nga prania e tujonit dhe e përbërësve të tjerë kimikë, kështu që rekomandohet ta përdorni mbi lëkurën e djegur.



Dje në "Deutsche Welle"

# Harta politike e ndryshuar e Europës

Nga Bernd Riegert

*(vijon nga faqja 1)*

... migrantë në radhë të gjata, që, ose paraqesin një kërkesë për azil, ose duan të udhëtojnë sa më shpejt që të jetë e mundur përmes Francës për në Britaninë e Madhe. Shumë nga afrikanët që sheh atje, sipas të dhënave të tyre kanë ardhur në Bruksel nga Italia, ose kanë ardhur me autobus, veturë ose tren përmes Austrisë, Gjermanisë ose Francës - në kundërshtim me të gjitha rregullat e Dublinit. Në thelb sipas rregullave evropiane ata duhet ta kishin paraqitur në Itali kërkesën e tyre për azil. Sistemi që është përpjekur të reformojë deri tani BE nuk funksionon.

Këtë e ka pranuar prej kohësh edhe ministri i Brendshëm belg Jan Jambon i partisë nacionalkonservatore N-VA. Ai kërkon të veprojë më me forcë kundër migrantëve me qëndrim të paligjshëm në Belgjikë. Në zgjedhjet e fundit në 2014, N-VA, të cilën mund ta quash parti populiste, mori shumë vota dhe u bë për herë të parë pjesë e koalicionit qeveritar.



**PARTITË KRITIKE NDAJ MIGRIMIT NË SHUMË SHTETE TË BE**

Belgjika përfaqëson një tendencë në Europë. "Kriza e refugjatëve ose e migrimit" ka bërë në shumë shtete të BE që të përballemi me parti të forta populiste të djathta, si në Francë, në Holandë, në Danimarkë, në Suedi ose në Gjermani. Në disa shtete, populistët e djathtë janë në qeveri, si në Belgjikë, në Finlandë, në Austri e në Greqi. Në një sërë shtetesh të BE partitë populiste janë e gjithë qeveria, si në Poloni, në Hungari, në Çeki ose së fundi në Itali. Për Stefan Lehne-n, ekspert për Europën në Fondacionin Carnegie në Bruksel, është e qartë se kriza e migrimit bën pjesë në modelin e biznesit të partive populiste.

"Ata kanë gjetur këtu një temë, e cila shkakton emocione të forta, që shkakton një polarizim të fortë dhe ato nuk shkëputen nga tema", thotë Stefan Lehne në bisedë me DW.

Shefi i Grupit Parlamentar të Populistëve të djathtë në Gjermani, Alexander Gauland (Alternativa për Gjermaninë) e quajti rrymën e refugjatëve, e cila kulmin e saj e kishte në 2015, si "dhuratë" për partinë e tij. Ajo është partia më e madhe opozitare në Bundestagun Gjerman dhe në disa rajone gjermano-lindore në sondazhe është në vend të parë.

**"BE PARA HUMNERËS"**

Zëvendëspresidenti i Komisionit Europian në Bruksel, Frans Timmermans, është i shqetësuar që fuqia e populistëve dhe çështja e pazgjidhur e migrantëve mund të çojë jo vetëm në një krizë qeveritare në Gjermani, por se mund të rrezikojë edhe kohezionin e BE. "Po të vështrosh vitet e fundit, atëherë sheh se ishte tema e migrimit ajo që e ka çuar deri në buzë të humnerës BE. Migrimi luan një rol kyç në çdo shtet anëtar, pavarësisht se në secilin", tha Timmermans të enjten e kaluar në Parlamentin Europian. Ai natyrisht që kërkon që interesat e shteteve nacionale të spostohen në radhë të dytë dhe që të ushtrohet solidaritet. "Vetëm në nivelin europian mund të kemi një zgjidhje të gjithëpërfshirëse, funksionuese".

Këtë nuk e shohin më kështu shumë prej qeverive të ndikuara nga populistët e djathtë, beson eksperti i politikës dhe ish-diplomati Stefan Lehne nga Fondacioni Carnegie: "Paaftësia e fillimit e BE për ta vënë nën kontroll këtë temë ka çuar në një rinacionalizim. Shumica e populistëve, shumica e partive, të cilët janë pozicionuar kundër migrantëve, janë të pozicionuar edhe kundër BE. Prandaj kemi gjithnjë e më shumë kthim drejt masave nacionale, te kontrollet e kufirit, ndërtimi i gardheve dhe kufijtë e sipërm." Ndoshta edhe shpresa e Kancelares gjermane për të negociuar një zgjidhje në këtë drejtim deri në fund të qershorit është iluzore.

**PËRPJEKJA E MERKELIT**

Angela Merkel ngul këmbë për një mënyrë veprimi të koordinuar, për marrëveshje bilaterale të shteteve të BE me njëra-tjetrën dhe në fund për një autoritet europian të vlerësimit të kërkesave për azil, i cili do të vendosë në kufijtë e jashtëm të BE. Me gjithë tendencat e forta populiste, BE duhet t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve, mendon Kancelarja: "A jemi sa duhet të fortë që të kujdesemi për zhvillim atje ku vijnë njerëzit, pra në kontinentin afrikan? A do të jemi më mirë se deri tani në gjendje që t'i japim fund luftës civile në Siri, ku miliona vetë vazhdojnë të jenë në arrati? Asnjë njeri nuk e braktis me mendjelehtësi atdheun. A jemi ne në gjendje që të zbatojmë në mbarë Europën të njëjtat procedura?"

**NJË PROBLEM I SË DJESHMES?**

Që prej vitit 2015, numri i refugjatëve që vijnë në Greqi, Itali dhe Gjermani ka rënë fort, me rreth 75 përqind. Politika e migrimit ka ndryshuar, gjithashtu, megjithatë partitë populiste dhe qeveritë ushqejnë përshtypjen se kufijtë po përmbyten nga migrantët. Me sa ka të bëjë kjo? Stefan Lehne nga Fondacioni Carnegie e shpjegon këtë kështu: "Me sa duket duhet të kalojë një kohë e caktuar, deri sa një shok traumatik si ai i vitit 2015 të bëjë efekt politik. Me sa duket efekti i tij është pas disa muajsh e vitesh. Pasiguria që shkaktoi në këtë mënyrë dhe që shfrytëzohet pastaj nga grupet e interesuara vazhdon."

Shumë nga afrikanët që sheh atje, sipas të dhënave të tyre kanë ardhur në Bruksel nga Italia, ose kanë ardhur me autobus, veturë ose tren përmes Austrisë, Gjermanisë ose Francës - në kundërshtim me të gjitha rregullat e Dublinit. Në thelb sipas rregullave evropiane ata duhet ta kishin paraqitur në Itali kërkesën e tyre për azil. Sistemi që është përpjekur të reformojë deri tani BE nuk funksionon.

## HOROSKOPI

**DASHI**

Këtë ditë, humori juaj është i lidhur me melankolinë e kësaj ditës, me planetët që nuk i keni shumë në favor. Do të keni apati dhe mungesë motivimi për të punuar. Për t'ju ngushëlluar, do të keni shumë miq të sinqertë që ju mbështesin.

**DEMI**

Kjo ditë do të shërbejë për të çimentuar një lidhje të konsoliduar, ose të shkrijë ndrojtjen në një marrëdhënie të porsalindur. Do t'ju duhet të pranoni disa kompromise. Solidariteti është i barasvlershëm me suksesin e ndërmarrjeve.

**BINJAKET**

Në përgjithësi jeni të përkushtuar, por vullneti i personit që keni në krah ndërhyn për të ndryshuar gjerat, duke bërë që t'ju ndryshojë programin. Do të keni edhe zënka në çift, me grindje të lodhshme për të përcaktuar se kush do të imponojë vullnetin e vet.

**GAFORJA**

Me mbështetjen e shumë planetëve në harmoni, dita fillon me mbarësi. Të arrini objektivat do të jetë një lojë fëmijësh. Një takim i papritur me një mik të vjetër do të bëjë që të ndryshoni planet për mbrëmjen.

**LUANI**

Të kapur nga doza të vogla dembelizmi është një "luks i nevojshëm", por nëse e teproni mund të humbni të gjithë ditë dhe mund të pendoheni shumë të nesërmen. Plutoni, i cili ju mbështet prej shumë vitesh, do të vazhdojë të jetë një mik i vetëm dhe i vërtetë. Ndërkaq, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për yjet e tjera.

**VIRGJERESHA**

Ditë me fat. Të ndihmuar nga bashkëpunimi i Hënës, Venusit, Marsit dhe Uranit jeni në një pozicion mbarësie! Do të ketë një shans edhe për ata që nuk pëlqejnë vetminë. Ndoshta nuk do të gjeni shpirtin binjak, por dikë që është pak a shumë ashtu.

**PESHORJA**

Kjo është dita ideale për të lënë mënjanë gjërat që nuk shkojnë në fushën profesionale dhe të përgatiteni për një ndryshim të qenësishëm të strategjisë ose objektivave. Ndërkohë, shmangni të menduarit e gjërave shumë të mëdha dhe matini mirë mjetet dhe burimet që keni në dispozicion.

**AKREPI**

Ditë për t'u mbajtur mend, ku të gjithë do të jenë kundër njëri-tjetrit: ju, partneri, fëmijët, kunetërit dhe prindërit. Dhe kështu do të ketë një mori hatërmbetjesh dhe bashkëbisedime ironike. Edhe një marrëveshje ndër aksionarë mund të prishet. Ju shkaktoni polemika, ndërsa të tjerët reagojnë keq.

**SHIGJETARI**

Më mirë t'i lini gjërat ashtu siç janë, sot që planetët nuk janë shumë të favorshëm dhe ju provokojnë hapur, duke bërë që të humbisni kohë të çmuar. Është e vërtetë që jeni jashtëzakonisht të duruar, por çdo gjë ka një kufi. Po u mbush plot kupa, derdhet.

**BRICJAPI**

Nuk jeni nga ata që lini t'ju ikë një mundësi për të dëfryer, sidomos kur një Hënë e zjarrtë dhe e hareshme ju thërret të argëtoheni. Kështu, pavarësisht nga barra e angazhimeve të ditës që keni, do të bëni gjithçka për të pranuar ftesën e saj.

**UJORI**

Sot do t'ju duhet të përshpejtoni gjërat, sidomos nëse fitimi vjen menjëherë. Bëni kujdes me shpenzimet, pasi do të keni dëshirë të kryeni shumë blerje sot. Megjithatë, nëse vendosni të bëni blerje të mëdha, tregohuni të zgjuar në zgjedhje.

**PESHQIT**

Do të jetë një ditë emocionuese dhe me shumë zhvillime. Yjet ju shtyjnë që të dilni, të takoni njerëz të rinj, të argëtoheni dhe të zbuloni botën e kulturës. Është ditë ideale për të organizuar një udhëtim, qoftë për punë, qoftë për kënaqësi.

## Arabia si Egjipti, jashtë botërorit

# Uruguai i bashkohet Rusisë, kalon në 1/8-at



Uruguai nuk fal ndaj Arabisë Saudite dhe i bashkohet Rusisë duke u bërë skuadra e dytë që kualifikohet për fazën me eliminim direkt të kampionatit botëror. Një gol i Luis Suarezit u ka mjaftuar të besuarve të Oskar Tabarezit që të sigurojnë trepikëshin e radhës dhe të presin biletën për në 1/8-at. Në Rostov Arena, ndryshe nga sa pritej, takimi ka qenë i ekuilibruar dhe kjo për meritë të skuadrës së Pizit, që luftoi fort për të marrë një rezultat pozitiv ndaj amerikanojugorëve. Arabia e nis ndeshjen më mirë, por ngadalë Uruguai futet në ritëm dhe në minutën e 23-të do të shënojë golin e epërsisë, kur Suarez përfiton nga mefshtësia e mbrojtjes arabe dhe shtyn topin në rrjetë. Më pas uruguaianët do të përpiqen që ta mbyllin takimin që në pjesën e parë, por nuk do të arrijnë ta bëjnë diçka të tillë, duke shkuar në pushim me avantazhin minimal 1-0. Pjesa e dytë do të nisë sërish nën diktatin e të besuarve të Tabarezit, që vijojnë të kërkojnë golin e dytë, por pa arritur dot të kërcënojnë seriozisht kuadratin e Al Ouais, ndërsa në të 73-ën, do të pretendojnë për një 11-metërsh, por do të vijojë lojën gjyqtari francez Klement Turpin. Në fundin e ndeshjes do të jenë saudidët ata që do të përpiqen të ndryshojnë diçka në fatet e tyre në këtë botëror, por nuk do të arrijnë ta mposhtin Muslerën as në minutën e 92-të, kur gjuajta e Jasit Al Shahranit u devijua dhe portieri uruguaian bllokoi i qetë. Përfundimisht 1-0 për amerikano latinët, të cilët i bashkohen Rusisë në fazën e 1/8-ave, ndërsa Arabia ka fatin e Egjiptit, duke u bërë e eliminuara e radhës nga veprimtaria.

Portugezët arrijnë të fitojnë me vështirësi ndaj afrikanëve, sikundër spanjollët ndaj persëve

# Portugalia e Spanja bëjnë adetin, ikën Maroku

## *Irani ka dhe një shans të fundit kundër luzitanëve*





Jeton Selimi

Në ditën ku Ronaldo ishte në kërkim të rekordeve personale, Maroku zhvillon një 90 minutash fantastik, vetëm fati dhe portieri Rui Patriso u kthyen në pengesë. Mes lotësh afrikanët mbyllin përpara kohe aventurën e tyre në Rusi, fundja fati i tyre ishte i shkruar që në momentin kur shorti i vendosi në një grup me Portugalinë dhe Spanjën. Ronaldo arrin të thyej rekordin e Ferenc Pushkash me vetëm një goditje në kuadrat

Është e pa besueshme se çfarë impakti ka Ronaldo në përfaqësuesen portugeze, rasti i parë goditja e parë dhe ylli i Real Madrid e dërgon menjëherë në kuadrat. Goli i 4-ët në këtë Botëror, i 85-ti me fanellën e përfaqësueses luzitane duke u shndërruar në golashënuesin më të mirë të të gjithë kohërave në kontinentin europian. Sa herë Ronaldo prek topin, kthehet në një kërcënim në portën e Marokut, 4 minuta më pas me një goditje rrafsh me tokën, CR7 i shkon shumë pranë golit të dytë. Benatia me kokë përpiqet të kthejë Marokut me lojë, arrin ta ulë topin në kuadrat, por goditja e kapitenit ishte e lehtë. Afrikanët detyrojnë Portugalinë të spostohet në gjysmëfushën e tyre, zhvillojnë një presion asfiksues duke pretenduar në dy momente 11-metërsh. Në një zbritje të shpejtë, Gonzalo Guedes i shkon shumë pranë dyfishimit, por Munir në mënyrë instiktive shmang një gol të sigurt. Maroku as që ka ndërmend të dorëzohet përballë Portugalisë, përkundrazi në çdo dalje të tyre përpara dhe në çdo goditje standarde janë të rrezikshëm duke i shkuar shumë pranë golit të barazimit. Pesë minuta lojë nga fillimi i pjesën e dytë dhe Ronaldos iu krijua një rast i pastër për të shënuar dygolëshin e tij personal, goditja e tij ishte e forte, por jo në kuadrat. Rui Patrisio bën mrekullinë në minutën e 56-të duke devijuar një goditje me kokë thuajse të pamundur, një pritje spektakolare që ka po aq vlerë sa goli i Ronaldo-s. Mes pretendimeve për 11-metërsh dhe rasteve në zonën e Portugalisë, Maroku i jep fund këtij Botërori në sulm, por nuk ishte e thënë që të shënonin qoftë dhe një gol për të shpresuar deri në fund në një mrekulli.

Pas fitores së Portugalisë, Spanja kishte detyrën për të marrë tre pikët ndaj Iranit. Në letër, duhej të ishte një punë jo shumë e vështirë, por persët të drejtuar nga Karlos Keiroz, edhe njëherë dëshmuan se janë një ekip i qëndrueshëm në fushë dhe i koordinuar. Në minutën e 48-të Pike gjuan me kokë pas topit të ardhur nga këndorja, por topi largohet pa kaluar vijën fatale. "Furia Roha" është një furi e vërtetë dhe pak sekonda më vonë Buskets dhe Vaskez detyrojnë Beiravand të bëjë një mrekulli të dyfishtë. Por pas Irani lëshon një shkreptimë në zonën e De Geas, por topi tund vetëm rrjetën e jashtme. E nëse te De Gea u tund rrjeta e jashtme, te porta e Beravand Diego Kosta shënon, me shumë fat, por realizon golin e epërsisë iberike dhe rrjetën e dytë në këtë kupë bote për të. Goli i Spanjës ndez reagimin e Iranit dhe skuadra e Keirozit meriton përgëzime (60). Irani këmbëngul të shënojë dhe do ta bëjë në minutën e 63-të me Taremi, por kryesori nga Uruguai do ta anulojë pas ndërhyrjes së VAR-it. Injesta do të mrekullojë me depërtimin e tij në zonë, por Haxhi Safi arrin të largojë në këndore, ndërsa Irani kërcënon me një kundërsulm, por asnjë nga sulmuesit nuk e arrin topin. Irani është dhe kërcënon. Amiri vallëzon në krah, driblon Pikenë dhe harkon në zonë, aty ku Mehdi Taremi gjuan me kokë, por nuk arrin ta ulë topin në kuadrat. Pavarësisht përpjekjeve, Irani nuk arrin të barazojë, ndërsa Spanja merr 3 pikë dhe barazon Portugalinë me 4 pikë në krye të tabelës. Irani me 3 pikë është në vend të tretë, ndërsa kualifikimin do ta ndajë me luzitanët në ndeshjen e fundit

**BOTERORI RUSI 2018**

**Grupi B**

| | |
|---|---|
| Portugali - Marok | 1-0 |
| Iran - Spanjë | 0-1 |

**Renditja**

| Skuadra | N | P |
|---|---|---|
| Portugalia | 2 | 4 |
| Spanja | 2 | 4 |
| Irani | 2 | 3 |
| Maroku | 2 | 0 |

## ARGJENTINA



### Sampaoli vlerëson Kroacinë, edhe Daliç po ashtu

Horge Sampaoli ka një sfidë delikate me Kroacinë dhe Argjentina e tij ka nevojë për tre pikë. "E dinim më herët që duhet të ndërrojmë lojtarë dhe skemë lojë për këtë ndeshje. Do të përpiqemi të mbulojmë gjatësinë e fushës dhe të rikuperojmë topin për të thyer aksionet e kundërshtarit. Kroacia do të luajë ndryshe nga ç'bëri me sfidën ndaj Nigerisë dhe do të na shqetësojë me kundërsulmin. Kam respekt të madh për këtë gjeneratë lojtarësh".

Zlatko Daliç është krenar. Kroacia e tij ka në përbërje lojtarë si Modriç, Kovaçi e Lovren, të cilët luajtën finale e Champions League, ndërsa kjo do t'i shërbejë edhe në botëror. "Dua t'i përgëzoj të tre. Është fantastike t'i kem në kombëtaren kroate tre finalistë të Ligës së Kampioneve. Kjo do të na shërbejë shumë dhe psikologjikisht. Argjentina është një ekip mjaft i mirë, por ne kërkojmë suksesin".

## NDESHJET E DITËS

### Danimarka do të mbyllë hesapet, Australia do pikë

Age Harejde, trajneri i Danimarkës, ka folur në sajtin zyrtar të FIFA-s për rëndësinë e takimit kundër Australisë, rezultati pozitiv ndaj të cilës do ta kualifikonte direkt për në fazën me eliminim. "E kemi studiuar Australinë që në çastin e shortit. Kanë ndërruar trajnerin, tani është Van Marvijk, që Tomanson e njeh mjaft mirë. Janë bërë më të organizuar dhe luajtën mirë kundër Francës. Ne kemi disa lojtarë cilësisht më lart, por do të jetë një ndeshje e ekuilibruar". Ndërkohë trajneri i Australisë, Bert Van Marvijk, ka nënvizuar se ndaj Danimarkës, skuadra e tij duhet të krijojë më shumë raste sesa kundër Francës. "E pashë ndeshjen Peru-Danimarkë dhe peruanët patën shumë raste. Kjo do të na ndihmojë që të krijojmë edhe ne rastet tona për të shënuar pasi ndaj Francës nuk patëm shumë. Danimarka është një ekip i fortë dhe besoj se është më skuadër sesa Franca".

## FRANCA

### Deshamp do tri pikët, por Peruja nuk i trembet

Franca luan ndaj Perusë dhe në mes është kualifikimi. Didie Deshamp e di këtë, ndaj ka deklaruar se skuadra është përgatitur fort. "Që të hënën jemi impenjuar në stërvitjen për këtë ndeshje, sepse është shans i mirë. Nga ajo që konstatoj, kemi të bëjmë me një ndeshje të fortë, prandaj na duhet të rregullojmë fazën ofensive. Peruja është një skuadër e vështirë dhe ne duhet të konkretizojmë më shumë".

Nga ana tjetër, Rikardo Gareka, nuk i druhet Francës. "Jam në krye të ekipit që prej 3 vitesh e gjysmë dhe që prej asaj kohe ne futemi në fushë për të fituar ndeshjen. Ne e respektojmë Francën, që është kandidate jo vetëm për të kaluar grupin, por edhe për të fituar Kupën e Botës, por ne jemi mësuar të jetojmë në situata të tilla. Mendoj se ne jemi të aftë të mposhtim cilëndo përfaqësuese".


www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
GSH.AL
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GSH
www.gsh.al
Tashmë edhe lundroni!
GAZETA SHQIPTARE
KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA
Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon
Sherri për kafshët, Roza Lati: Do t'i jap kastravecë
BLUE TOOTH
GAZETA SHQIPTARE
500 NUMRA, NJE HISTORI SUKSESI
SUMMER
DORINA GEGIÇI
Çdo profesion ka nevojë për talent, jo sponsor
A e meriton Shën Tereza një muze në Shqipëri?!